

PROGRAMI KOMBËTAR I STATISTIKAVE ZYRTARE për periudhën 2012-2016

Pasqyra e Lëndës

Lista e Akronimeve.....	5
HYRJE.....	7
I. ECURIA E PROGRAMIT TË STATISTIKAVE ZYRTARE 2007-2011.....	8
1.1 Statistikat Demografike dhe Sociale.....	8
1.1.1 Statistikat e popullsisë	
1.1.2 Statistikat e Arsimit	
1.1.3 Statistikat e Nivelit të Jetesës dhe Buxhetit të Familjes	
1.1.4 Statistikat e Punësimit	
1.2 Statistikat makroekonomike.....	9
1.3 Statistikat e ndërmarrjeve.....	10
1.4 Statistikat e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit.....	11
1.5 Statistikat multi-domain (mjedisit, shkencës dhe teknologjisë, informacionit).....	12
1.6 Mbështetja për prodhimin statistikor (Regjistrat statistikorë dhe Klasifikimet).....	12
1.6.1 Regjistrat statistikorë	
1.6.2 Klasifikimet	
II. KUADRI LIGJOR I AKTIVITETEVE STATISTIKORE QË DO TË KRYHEN PËR PERIUdhËN 2012-2016.....	13
III. OBJEKTIVAT KRYESORË TË PROGRAMIT DHE RISITË.....	14
IV. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT.....	19
4.1 Procedura e ndjekur për hartimin e Programit.....	19
4.2 Analiza SWOT (Fuqitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Kërcënimet).....	21
4.3 Sistemi i Integruar i Teknologjisë së Informacionit.....	24
V. AGJENCITË STATISTIKORE.....	26
VI. PLANIFIKIMI I KOSTOS SË NEVOJSHME PËR KRYERJEN E OPERACIONEVE STATISTIKORE 2012-2016.....	26
VII. MONITORIMI I ECURISË SË PROGRAMIT.....	28
FUSHA 1	STATISTIKAT DEMOGRAFIKE DHE SOCIALE.....
	29
Tema 1.01	Popullsia.....
	29
Moduli 1.01.01	Demografia, censuset dhe projeksionet.....
	30
1.01.01.01	Demografia.....
	30
1.01.01.02	Censuset.....
	32
1.01.01.03	Projeksionet.....
	34
1.01.02	Migracioni dhe Azilkërkuesit.....
	36
Tema 1.02	Tregu i Punës.....
	38
Moduli 1.02.01	Punësimi dhe papunësia.....
	39
1.02.02	Pagat dhe kostot e punës.....
	43
1.02.04	Përdorimi i kohës dhe balanca e punës me jetën familjare.....
	45

Tema 1.03	Arsimi dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.....	46
Moduli 1.03.01	Statistikat e arsimit.....	47
1.03.02	Statistikat e trajnimit profesional.....	48
Tema 1.04	Kultura.....	49
Moduli 1.04.01	Statistikat e kulturës.....	49
Tema 1.05	Shëndeti dhe Siguria.....	50
Moduli 1.05.01	Statistikat e Shëndetit Publik.....	51
Tema 1.06	Shpërndarja e të ardhurave dhe niveli i jetesës.....	53
1.06.01	Anketa e Buxhetit të Familjes.....	54
1.06.02	Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës.....	56
Tema 1.07	Mbrojtja sociale.....	58
Moduli 1.07.01	Mbrojtja sociale.....	58
Tema 1.10	Statistikat juridike.....	60
Moduli 1.10.01	Të dhënat administrative mbi krimet dhe zbulimi i tyre.....	61
Tema 1.12	Statistika të tjera në fushën demografike dhe sociale.....	62
Moduli 1.12.02	Statistikat gjinore.....	62
FUSHA 2	STATISTIKAT MAKROEKONOMIKE.....	65
Tema 2.01	Llogaritë Ekonomike Vjetore.....	65
Moduli 2.01.01	Sistemi Evropian i Llogarive.....	66
2.01.02	Llogaritë kombëtare (treguesit)	
	<i>A. Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) me metodën e Prodhimi.....</i>	<i>66</i>
	<i>B. Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) me metodën e Shpenzimeve.....</i>	<i>68</i>
2.01.03	Llogaritë Vjetore të Sektorëve Institucionalë.....	71
2.01.03.01	Administrata Publike.....	73
2.01.04	Tabelat burime-përdorime dhe tabelat <i>input-output</i>	75
2.01.06	Llogaritë rajonale.....	77
Tema 2.02	Llogaritë Kombëtare tremujore.....	79
Moduli 2.02.01	Llogaritë kombëtare tremujore.....	80
Tema 2.03	Statistikat monetare dhe financiare.....	82
Moduli 2.03.01	Llogaritë financiare – Metodologjia.....	83
2.03.02	Llogaritë financiare – Prodhimi i të dhënave.....	84
2.03.03	Treguesit monetarë dhe financiarë.....	84
Tema 2.04	Statistikat financiare të qeverisë.....	87
Moduli 2.04.01	Statistikat financiare të qeverisë – Metodologjia.....	86
2.04.02	Statistikat financiare të Qeverisë – Përgatitja e të dhënave.....	88
2.04.03	Statistikat mbi deficitin dhe borxhin publik.....	89
Tema 2.06	Statistikat e Çmimeve të Konsumit dhe Matja e fuqisë Blerëse.....	91
Moduli 2.06.01.01	Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK).....	93
2.06.01.02	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (HIÇP).....	94
2.06.02	Matja e Fuqisë Blerëse (PPP).....	95
2.06.02.01	Shitjet e ndërmarrjeve që paguajnë Taksën e Vlerës së Shtuar (TVSH).....	97
Tema 2.07	Tregtia e mallrave.....	98
Moduli 2.07.04.01	Tregtia e mallrave – Prodhimi i të dhënave.....	99
2.07.04.02	Indekset e Vlerës Njësi.....	101

Tema	2.08	Statistikat e bilancit të pagesave dhe tregtia ndërkombëtare e shërbimeve.....	102
Moduli	2.08.02	Bilanci i pagesave.....	103
	2.08.03	Investimet e huaja direkte (fluks dhe stok).....	105
	2.08.04	Tregtia ndërkombëtare e shërbimeve.....	106
	2.08.06	Statistika të FATS.....	107
FUSHA	3	STATISTIKAT E NDËRMARRJEVE.....	109
Tema	3.01	Statistikat Vjetore të e Ndërmarrjeve.....	109
Moduli	3.01.01	Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve.....	109
	3.01.03	Lista e Produkteve dhe shërbimeve (PRODCOM).....	111
Tema	3.02	Statistikat afatshkurtra.....	112
Moduli	3.02.01.01	Statistikat afatshkurtra tremujore.....	113
	3.02.01.02	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (IÇP).....	115
	3.02.01.03	Indeksi i Çmimeve të Importit (IÇI).....	116
	3.02.01.04	Indeksi i Kushtimit në Ndërtim, Gjithsej.....	117
	3.02.01.05	Indeksi i Kushtimit në Ndërtim, Ndërtesat.....	118
	3.02.01.06	Indeksi i Kushtimit në Ndërtim, Punimet inxhinierike.....	120
	3.02.01.07	Lejet e ndërtimit të miratuara.....	121
Tema	3.03	Energjia.....	122
Moduli	3.03.01.01	Statistikat strukturore të energjisë elektrike.....	123
	3.03.01.02	Statistikat strukturore të energjisë.....	123
	3.03.02	Statistikat afatshkurtra të energjisë.....	124
Tema	3.04	Transporti.....	125
Moduli	3.04.01.01	Sistemi i informacionit mbi statistikat e transportit.....	126
	3.04.01.02	Aksidentet.....	127
	3.04.02	Statistika mbi transportin rrugor të pasagjerëve.....	128
	3.04.03	Statistikat e transportit rrugor të mallrave.....	128
	3.04.04	Statistikat e transportit hekurudhor.....	128
	3.04.05	Statistikat e transportit detar.....	129
	3.04.06	Statistikat e transportit ajror.....	130
Tema	3.05	Turizmi.....	131
Moduli	3.05.01	Turizëm.....	131
Tema	3.06	Regjistrat e Ndërmarrjeve.....	133
Moduli	3.06.01	Regjistrat e Ndërmarrjeve.....	133
FUSHA	4	STATISTIKAT E BUJQËSISË, PYJEVE DHE PESHKIMIT.....	136
Tema	4.01	Statistikat bujqësore.....	136
Moduli	4.01.01	Statistikat e produkteve bimore.....	137
	4.01.02	Statistika të blegtorisë, mishit dhe vezëve.....	139
	4.01.03	Statistikat e qumështit dhe të produkteve të qumështit.....	140
Tema	4.02	Strukturat bujqësore.....	141
Moduli	4.02.01	Vrojtimit mbi strukturën e fermës.....	142
Tema	4.03	Përdorimi dhe mbulimi i tokës.....	143

Moduli 4.03.01	Statistikat e përdorimit dhe mbulimit të tokës.....	143
Tema 4.04	Llogaritë e bujqësisë dhe çmimet.....	144
Moduli 4.04.01	Llogaritë ekonomike bujqësore dhe çmimet.....	145
Tema 4.05	Statistikat e Pylltarisë.....	146
Moduli 4.05.01	Statistikat te pylltarisë, gjuetisë dhe produkteve nga pyjet.....	147
Tema 4.06	Statistikat e peshkimit.....	149
Moduli 4.06.01	Peshkimi.....	149
Tema 4.07	Statistikat agromjedisore.....	150
Moduli 4.07.01	Statistikat agromjedisore.....	151
FUSHA 5	STATISTIKAT MULTI-DOMAIN.....	152
Tema 5.03	Statistikat te Mjedisit.....	152
Moduli 5.03.02	Statistika mbi mbetjet dhe substancat e rrezikshme.....	153
5.03.03	Statistikat mbi ujin.....	154
Tema 5.06	Shkenca, teknologjia dhe inovacioni.....	155
Moduli 5.06.01	Statistikat mbi shkencën dhe teknikën.....	155
5.06.02	Inovacioni.....	156
Tema 5.07	Shoqëria e informacionit.....	157
Moduli 5.07.01	Statistikat e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK).....	157
5.07.01.02	Statistikat e Komunikacionit.....	158
5.07.02	Statistikat e shërbimit postar.....	159
Tema 5.09	Llogaritë ekonomike në mjedis dhe ndryshimi i klimës.....	160
Moduli 5.09.01	Llogaritë monetare në mjedis.....	160
5.09.02	Llogaritë fizike dhe hibride për mjedisin.....	161
FUSHA 6	MBËSHTETJA E PRODHIMIT STATISTIKOR.....	162
Tema 6.01	Cilësia, vlerësimi, koordinimi statistikor dhe klasifikimet.....	162
Moduli 6.01.02 .01	Klasifikimi aktiviteteve.....	162
6.01.02 .02	Klasifikimi produkteve.....	164
6.01.03	Klasifikimet për tregtinë e mallrave (Dogana).....	164
Tema 6.11	Siguria e të dhënave dhe konfidencialiteti.....	165
Moduli 6.11.01	Siguria dhe mbrojtja e të dhënave.....	166
6.11.02	Koordinimi për konfidencialitetin statistikor.....	167
FUSHA 8	POLITIKA STRATEGJIKE DHE KOORDINIMI.....	169
Tema 8.04	Menaxhimi i bazës ligjore.....	169
Moduli 8.04.02	Aspektet ligjore të konfidencialitetit.....	169
ANEKSI I.....		172
ANEKSI II.....		175

Lista e Akronimeve

ABF	Anketa e Buxhetit të Familjes
SDShSh (angl. ADHS)	Studimi Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri (angl. <i>Albanian Demographic and Health Survey</i>)
AFP	Anketa e Forcës së Punës
AMF	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
AMNJ	Anketa e Matjes së Nivelit të jetesës
ANR	Anketa e Ndërmarrjeve të Reja
APK	Anketa e Përdorimit të Kohës
ASN	Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve
ATN	Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BSH	Banka e Shqipërisë
Census-Al 2011	Censusi i Popullsisë e Banesave 2011
COICOP	Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Qëllimit (angl. <i>Classification of Individual Consumption According to Purpose</i>)
CPA	Klasifikimi Statistikor i Produkteve (angl. <i>Statistical Classification of Products</i>)
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
ESA'95	Sistemi Evropian i Llogarive
FATS	Statistikat e Tregtisë së Filialeve të Huaja (angl. <i>Foreign Affiliates Trade Statistics</i>)
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GDDS	Sistemi i Përgjithshëm i Shpërndarjes së të Dhënave (angl. <i>General Data Dissemination System</i>)
GFSM2001	Manuali i Statistikave Financiare të Qeverisë (angl. <i>Government Finance Statistics Manual 2001</i>)
GIS	Sistemi i Informacionit Gjeografik (angl. <i>Geographic Information System</i>)
COFOG	Klasifikimi i Funksioneve Qeveritare (angl. <i>Classification of the Functions of Government</i>)
GPS	Sistemi Global i Pozicionimit (angl. <i>Global Positioning System</i>)
HIÇP	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit
IÇP	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit
IJFPSF	Konsumi Final i Institucioneve Jo-Fitimprurëse që i shërbejnë Familjeve
IKN	Indeksi i Kushtimit në Ndërtim
INSTAT	Instituti i Statistikave
IOT	Tabela <i>input-output</i>
IPA	Instrumenti për Ndihmën e Para-Aderimit
ISCED	Klasifikimi Ndërkombëtar Standard i Arsimit
ISKSh	Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor
ISSH	Instituti i Sigurimeve Shoqërore

KESH	Korporata Energjetike Shqiptare
KKRT	Këshilli Kombëtar i Radio Televizionit
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MB	Ministria e Brendshme
MBUMK	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
MD	Ministria e Drejtësisë
METE	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
MF	Ministria e Financës
MICS	Anketa për Indikatorë të Shumëfishtë
MMPAU	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
MPÇSShB	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
MPPT	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTKRS	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
NVE (angl. NACE)	Nomenklatura e Aktiviteteve Ekonomike
NJEB	Njësia Ekonomike Bujqësore
NVE rev.2	Nomenklatura e Aktiviteteve Ekonomike
OECD	Organizata për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ekonomik (angl. <i>Organization of Economic and Cooperation Development</i>)
IHD (angl. OFATS)	Investimet e Huaja Direkte
PDA	Asistenti Personal Dixhital (angl. <i>Personal Digital Assistant</i>)
PKZMSA	Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit
PPP	Barazia e Fuqisë Blerëse (angl. <i>Purchasing Power Parity Statistics</i>)
PSZ	Programi i Statistikave Zyrtare
SDDS	Standardet Speciale të Shpërndarjes së të Dhënave (angl. <i>Special Data Dissemination Standard</i>)
SILC	Statistikat e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (angl. <i>Statistics on Income and Living Conditions</i>)
SITC	Klasifikimit Ndërkombëtar Standard i Tregtisë (angl. <i>Standard International Trade Classification</i>)
SNA-1993	Sistemit të Llogarive Kombëtare në Nivel Botëror (angl. <i>the System of National Account</i>)
SUT	Tabela e burim-përdorimeve (angl. <i>Supply and Use Tables</i>)
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën (angl. <i>United Nation Educational, Scientific and Cultural Organization</i>)

Hyrje

Programi Pesëvjeçar i Statistikave Zyrtare është dokumenti bazë që parashikon prodhimin nga Sistemi Kombëtar Statistikor e të dhënave statistikore të nevojshme për vëzhgimin e gjendjes ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë, duke respektuar garancinë e zbatimit të parimeve statistikore të parashikuara në ligj si dhe në Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (*European Statistics Code of Practice*).

Programi i Statistikave Zyrtare për periudhën 2012-2016 është dokumenti i dytë i këtij lloji pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 9180, datë 05.02.2004 “Për Statistikat Zyrtare”. Duke patur parasysh që ishte dokument i cili hartohej për herë të parë në Shqipëri pas krijimit të Institutit të Statistikave si një institucion i pavarur profesionalisht, Programi i mëparshëm i Statistikave Zyrtare (2007-2011) ka shërbyer jo vetëm si dokument planifikimi për statistikave zyrtare që do prodhoheshin gjatë kësaj periudhe, por edhe si dokument bazë për orientimin e INSTAT-it dhe agjencive të tjera statistikore drejt cilësisë së prodhimit statistikor sipas standardeve të parashikuara nga *Acquis Communautaire*.

Përmbushja e aktiviteteve statistikore dhe, veçanërisht, regjistrimeve të përgjithshme (Regjistrimi i Njësive Ekonomike Jobujqësore dhe Census-Al 2011) sipas afateve të parashikuara në Programin paraardhës, u mundësua nëpërmjet angazhimit të veçantë të të gjithë aktorëve të përfshirë në Sistemin Kombëtar Statistikor me mbështetjen e qeverisë shqiptare, partnerëve ndërkombëtarë dhe donatorëve, të cilët kanë garantuar jo vetëm burimet e mjaftueshme njerëzore dhe financiare, por edhe sigurimin e hapësirave dhe kushteve të nevojshme të punës për stafin e përfshirë.

INSTAT dhe agjencitë statistikore kanë luajtur rol shumë të rëndësishëm në proceset e hartimit të programeve kombëtare për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit si dhe në plotësimin e Pyetësorit për anëtarësim në BE, duke i siguruar të gjithë përdoruesve publikë të përfshirë informacionin e nevojshëm për vlerësimin e gjendjes dhe hartimin e politikave integruese.

Nga ana tjetër, këto procese kanë ndihmuar stafin e angazhuar në prodhimin e statistikave zyrtare për tu familjarizuar më tej me dokumentet evropiane që rregullojnë metodologjinë e kryerjes së proceseve prodhuese të statistikave, me parimet e përgjithshme statistikore të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian, duke qenë të ndërgjegjshëm për sfidat e ardhshme integruese të sistemit statistikor. Në këtë kontekst, hartimi i këtij Programi konsiderohet si një dokument shumë i rëndësishëm për planifikimin e aktiviteteve statistikore prioritare, të cilat do t'i shërbejnë jo vetëm funksionimit të një sistemi statistikor të avancuar, por edhe konsolidimit të instrumenteve për realizimin e tyre.

I. ECURIA E PROGRAMIT TË STATISTIKAVE ZYRTARE 2007-2011

1.1 Statistikat Demografike dhe Sociale:

1.1.1 Statistikat e popullsisë

Në lidhje me statistikave zyrtare mbi popullsinë, objektivat kryesorë të Programit Statistikor 2007-2011 ishin:

- *Përmirësimi i mbledhjes së informacionit demografik dhe sigurimi i informacionit mbi emigracionin.* Periudha tranzitore e Zyrave të Gjendjes Civile, të cilat janë baza kryesore e informacionit demografik, nuk i ndihmoi sa duhet statistikave të demografisë, në mënyrë që ajo të llogariste një popullsi të saktë.

- *Kryerja e Censurit të Popullsisë e Banesave.* Censusi i krye në tetor të vitit 2011, pas një procesi përgatitor prej 2 vjetësh dhe kontributit të qeverisë, donatorëve dhe gjithë aktorëve të tjerë të interesuar. Ky projekt, si dhe kalimi nga mbledhja e informacionit të statistikave vitale me skeda (format letër), në mënyrë elektronike, do të bëjnë të mundur që në Programin e ri Statistikor, statistikave të popullsisë të jenë sa më afër realitetit, duke pasur parasysh që ato janë shumë të rëndësishme si për politikë-bërësit ashtu edhe për përdoruesit e ndryshëm.

1.1.2 Statistikat e Arsimit

Sa i takon statistikave të arsimit, të cilat bazoheshin kryesisht në të dhënat administrative që sigurohen nga MASH, objektivi kryesor i Programit të mëparshëm Statistikor ka qenë *zgjerimi i gamës së treguesve edhe me sektorin privat* si dhe prodhimi i këtyre statistikave sipas standardeve dhe kërkesave metodologjike të Eurostat-it. Mund të themi që këto objektiva janë kryer pothuajse plotësisht.

Statistikat e Shëndetësisë janë të shumëllojshme dhe sigurohen nga MSh nëpërmjet burimeve të ndryshme të informacionit. Objekti kryesor i programit statistikor ka qenë *konsolidimi i treguesve të shëndetësisë dhe plotshmëria e informacionit statistikor*, objektiv ky që është realizuar pjesërisht duke pasur parasysh vështirësitë dhe vonesat në mbledhjen e tij. Programi i ri Statistikor përkon me strukturimin e sistemit statistikor të shëndetësisë nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë gjë që do të përmirësojë ndjeshëm statistikave në këtë fushë.

Gjithashtu, parashikohet kalimi nga Klasifikimi i sëmundshmërisë dhe Vdekshmërisë ICD9 në ICD 10. INSTAT ka parashikuar në programin e ri një sërë masash për implementimin e tij duke përbushur kështu një nga kërkesat e Eurostat-it.

1.1.3 Statistikat e Nivelit të Jetesës dhe Buxhetit të Familjes

Programi Statistikor 2007-2011 parashikonte *kryerjen e Anketës së Buxhetit të Familjes 2008-2009*, në mënyrë që t'i shërbente sa më mirë llogaritjes së konsumit

dhe të ardhurave të familjes, si tregues të matjes së nivelit të jetesës, dhe përditësimin të shportës së konsumit dhe konsumin final të familjeve, si pjesë e PBB-së. Kryerja e anketës në terren tregoi se nxjerrja e rezultateve kërkonte kohë dhe treguesit humbnin aktualitetin e tyre. Për këtë arsye Program i ri Statistikor parashikon kryerjen e kësaj ankete me bazë 3-mujore.

Përsa i përket *Anketës së Matjes së Nivelit të Jetesës*, ajo është një anketë që kryhet çdo 3 vjet. Në programin Statistikor 2007-2011 ishte parashikuar kryerja e saj në vitin 2008. Projekti u realizua në kohë dhe me sukses. Në Programin e ri statistikor është parashikuar kryerja e anketës në vitin 2012. Kjo anketë do të mundësojë ruajtjen e vazhdimësisë së të gjithë indikatorëve socialë dhe do të sigurojë monitorimin e nivelit të jetesës dhe të varfërisë në vend, si rezultat i aplikimit të politikave për këtë qëllim. E reja e kësaj ankete është se ajo jo vetëm do të ruajë vazhdimësinë e treguesve në nivel rajonal, por edhe do të mundësojë tregues në nivel prefekturë.

1.1.4 Statistikat e Punësimit

Në programin e mëparshëm të statistikave zyrtare (2007-2011), objektivat kryesorë për t'u arritur lidhur me statistikave të tregut të punës ishin:

- *Përmirësimi i treguesve nga rekordi administrativ;*
- *Ndërtimi i grupit të treguesve statistikorë të punës, të harmonizuar me kërkesat e standardet ndërkombëtare të Eurostat-it;*
- *Vlerësimin sasior dhe dinamik të zhvillimeve të tregut të punës mbështetur në të dhënat e integruara nga burimet administrative dhe statistikore.*

Këto objektiva u realizuan plotësisht duke sjellë një përmirësim të cilësisë së treguesve statistikorë si dhe llogaritjen e një sërë treguesish të rinj për tregun e punës. Megjithatë, mungesa e të dhënave me bazë tremujore mbi dinamikën e zhvillimeve të tregut të punës, dhe kërkesat gjithnjë e në rritje të përdoruesve institucionalë dhe privatë si dhe të institucioneve ndërkombëtare për të dhëna të harmonizuara me përkufizimet dhe metodologjinë e Eurostat-it dhe Organizatës Ndërkombëtare të Punës, bënë të nevojshëm kalimin nga anketë vjetore për forcat e punës në anketë të vazhdueshme. Anketa e vazhdueshme ka filluar të kryhet që në tremujorin e dytë të vitit 2011.

1.2 Statistikat makroekonomike

Gjatë periudhës së programit të mëparshëm statistikor 2007-2011, u arrit të vlerësoheshin një sërë treguesish të rinj si dhe të përmirësoheshin metodat dhe burimet e të dhënave të treguesve ekzistues. Ndër treguesit e rinj të cilët ishin parashikuar edhe në programin e mëparshëm ishte *vlerësimi i PBB-së tremujore me metodën e prodhimit* për sektorët kryesor të ekonomisë. Ky tregues u arrit të

vlerësohej me çmime korente dhe konstante dhe rezultatet e këtij të fundit, të publikoheshin me çmime konstante në dy trajta, (i) me çmimet e një viti më parë (ii) me çmime konstante me një vit bazë (2005=100). Këto seri në të njëjtën kohë u publikuan edhe me efekte sezonale duke i ofruar përdoruesve një informacion sa më të plotë e bashkëkohor.

Arritja e këtyre vlerësimeve kërkoi edhe një sërë përmirësimesh në treguesit e mëparshëm, si vlerësimi i PBB-së vjetore me çmime bazë apo mbledhja e indikatorëve të tjerë informacioni. Me publikimin e këtyre statistikave të llogarive makroekonomike afatshkurtra, Shqipëria përmbushi dhe një nga kërkesat kryesore për plotësimin e Standardeve Speciale të Shpërndarjes të të Dhënave (SDDS).

Gjithashtu, po gjatë periudhës 2007-2011 u arritën të vlerësoheshin dhe të publikoheshin edhe disa tregues të rinj makroekonomikë, si:

- PBB Rajonale sipas nivelit NUTS II. Ky vlerësim u arrit që të publikohej në vitin 2011 duke mundësuar një informacion më të plotë për shpërndarjen ekonomike të rajoneve të Shqipërisë;
- Vlerësimi i të Ardhurave Kombëtare Bruto (angl. GNI), për të cilin u arrit vlerësimi i tij në seri kohore që nga viti 1996, duke mundësuar një tregues tjetër të rëndësishëm makroekonomik;

Përveç treguesve të rinj që u prodhuan gjatë periudhës kohore të programit të mëparshëm statistikor, u bënë përmirësime edhe në vlerësimin e disa treguesve ekzistues si:

- Vlerësimi i PBB-së vjetore paraprake mbështetur mbi informacionet tremujore, duke mundësuar rezultate më të shpejta në kohë;
- Përmirësime metodike të disa prej komponentëve të vlerësimin të PBB-së sipas metodës së shpenzimeve;
- Fillimi i prodhimit të tabelave burim-përdorim me çmime konstante e korente;
- Përmirësim i vlerësimin të PBB-së me çmime konstante duke u mbështetur mbi disa indekse të reja çmimesh për tu përafëruar më shumë me lëvizjet reale të sektorëve.

1.3 Statistikat e ndërmarrjeve

Gjatë periudhës së zbatimit të PSZ 2007-2011, përmirësimet në statistikat e ndërmarrjeve u përqendruan në dy drejtime:

1. *Në statistikat afatshkurtra* u arrit të përmirësohej metodologjia e vrojtimit në drejtim të numrit të ndërmarrjeve, aktivitetit ekonomik dhe metodës së vlerësimin. U rrit numri i ndërmarrjeve duke përfshirë në vrojtim me zgjedhje

edhe ndërmarrjet e vogla, jo vetëm ndërmarrjet me 10+ të punësuar, si dhe duke shtuar aktivitete të reja ekonomike. U rrit fusha e mbulimit duke shtuar edhe dy aktivitete të reja domethënëse për zhvillimin ekonomik të vendit, shërbimet informatike dhe punimet inxhinierike. U përmirësua metoda e vlerësimit, duke zëvendësuar metodën e vlerësimit “mbajtja e ndërmarrjeve identike” e cila nuk pasqyronte ndryshimet reale në prodhimin e këtyre statistikave.

2. *Në statistikat strukturore të ndërmarrjeve* përmirësimet u arritën në drejtim të: riorganizimit të pyetësorit sipas planit kontabël të miratuar për format e ndryshme të raportimeve financiare të ndërmarrjeve, rritjes së numrit të ndërmarrjeve të vrojtuesve; fushave të aktivitetit (duke përfshirë aktivitete si arsim dhe shëndetësi); numrit të variablave të kërkuar; metodave të vlerësimit; numrit të indikatorëve të prodhuar; cilësisë së publikimit.

Informacioni i marrë nga vrojtimet afatshkurtra dhe strukturore ka shërbyer edhe për përmirësimin e cilësisë së variablave në regjistrin e ndërmarrjeve.

Janë shfrytëzuar më mirë burimet administrative për prodhimin e indikatorëve të cilët sigurohen vetëm nga këto burime.

Në fushën e statistikave monetare, u arritën realizimet e detyrave si në statistikat mbi çmimet edhe në statistikat e tregtisë së mallrave.

Në statistikat e çmimeve të konsumit u përditësuan peshat e produkteve dhe shporta e produkteve të konsumit të popullatës bazuar në anketën e buxhetit të familjes 2007, sipas programit; u përfundua rishikimi i indeksit të kushtimit në ndërtim për banesat si nga ana metodologjike, (llogaritja e tij me peshat e reja) edhe mënyra e llogaritjes (nga formati Excel në aplikimin SQL); u arrit në kohë realizimi i prodhimit të indeksit të çmimeve të prodhimit për mallrat e eksportit;

Në statistikat e tregtisë së jashtme u përmirësua cilësia e këtyre statistikave, afati i publikimit dhe u arrit marrja e këtij informacioni nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në nivelin më të detajuar, si rezultat i zbatimit me korrektësi të marrëveshjes së mirëkuptimit ndërmjet dy institucioneve.

1.4 Statistikat e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit

Gjatë periudhës 2007-2011, përgjegjëse për statistikat e bujqësisë ka qenë MBUMK dhe MMPAU të përcaktuara në këtë program si Agjenci Statistikore. Statistikat e siguruara nga këto agjenci nuk kanë patur ndryshime të mëdha gjatë periudhës në fjalë.

Në lidhje me statistikat e bujqësisë, Regjistrimi i njësive ekonomike bujqësore i parashikuar të realizohej në vitin 2010, duke bërë të mundur dhe

krijimin e Regjistrit Statistikor të Fermave, si burimi kryesor për përmirësimin e statistikave të bujqësisë, nuk u realizua. Si pasojë e shtyrjes së regjistrimit pas Censusit të Popullsisë dhe Banesave, Regjistri i Fermave Bujqësore i cili do të shërbente si bazë për vrojtimit statistikore në këtë fushë, nuk mundi të krijohet e për pasojë nuk ka pasur përmirësime në të dhënat statistikore mbi bujqësinë.

1.5 Statistikat multi-domain (mjedisit, shkencës dhe teknologjisë, informacionit)

Prodhimi i statistikave të mjedisit ka vazhduar sipas programit statistikor. Burimi kryesor i mbledhjes së tyre është administrativ.

Në lidhje me statistikave të teknologjisë së informacionit e komunikimit (TIK), INSTAT gjatë periudhës 2009-2010 ka arritur të sigurojë informacion statistikor mbi këta tregues duke përfshirë në Anketën Strukturore Vjetore, një rubrikë mbi këta tregues.

1.6 Mbështetja për prodhimin statistikor (Regjistrat statistikorë dhe Klasifikimet)

1.6.1 Regjistrat statistikorë

INSTAT, sipas rekomandimeve të BE-së, ka ndërtuar, mirëmban dhe është përgjegjës për Regjistrin statistikor të Ndërmarrjeve dhe Regjistrin Statistikor të Njësive lokale.

Regjistri i ndërmarrjeve përdoret si bazë për të realizuar vrojtimit me zgjedhje pranë tyre, kurse Regjistri i Njësive Lokale përdoret kryesisht për prodhimin e statistikave rajonale.

Gjatë periudhës 2007-2011 u realizuan objektivat kryesore si:

- U realizua me sukses Regjistrimi i Përgjithshëm i Njësive Ekonomike Jobujqësore duke plotësuar pritshmërinë e këtij aktiviteti;
- Përgatitja e regjistrit statistikor të ndërmarrjeve të përditësuar e cilësor në përputhje me kërkesat e BE-së, i cili ishte një nga rezultatet e regjistrimit, si dhe të aktiviteteve të tjera statistikore kryera për këtë qëllim (ANR), rishikimi i të gjithë treguesve të regjistrit dhe klasifikimet e tyre, shtimi i treguesve të rinj madhësia sipas xhiros apo klasifikimi sipas njësive institucionale etj;
- Përgatitja e regjistrit statistikor të njësive lokale në përputhje me kërkesat e BE-së ishte produkti më i rëndësishëm i Regjistrimit të Përgjithshëm të Ndërmarrjeve Ekonomike Jobujqësore;

- U realizua implementimi në regjistrat e njësive ekonomike i nomenklaturës së re ekonomike NACE Rev.2 si bazë për të gjitha aktivitetet statistikore brenda INSTAT por edhe në Institucionet e tjera në shkallë vendi.
- Një aplikim informatikë është duke u përgatitur, për përditësimin dhe menaxhimin e regjistrave të njësive ekonomike si dhe prodhimin e treguesve statistikore prej tyre.

1.6.2 Klasifikimet

Klasifikimet kanë shërbyer si një nga instrumentat kryesorë për krahasime të të dhënave statistikore jo vetëm me agjencitë statistikore dhe institucionet publike brenda vendit, por edhe me institucionet evropiane dhe ndërkombëtare. INSTAT ka zbatuar klasifikimet ekonomike të njehsuara me klasifikimet evropiane, duke ndjekur të gjitha rishikimet e bëra mbi këto klasifikime.

II. KUADRI LIGJOR I AKTIVITETEVE STATISTIKORE QË DO TË KRYHEN PËR PERIUdhËN 2012-2016

Korniza ligjore mbi të cilën mbështetet veprimtaria e institucioneve që mbulojnë prodhimin e statistikave zyrtare, është e përbërë nga dy kategori: akte normative kombëtare dhe akte normative ndërkombëtare.

Në kategorinë e parë përfshihen:

Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 “Për statistikat zyrtare” i cili përcakton qartë, në nenin 6 të tij, aspektet që duhet të mbulojë një Program shumëvjeçar për statistikat zyrtare si dhe procesin e miratimit të tij.

Programi i Statistikave Zyrtare për periudhën 2012-2016, i cili, sipas nenit 6 të ligjit të mësipërm, mbulon të dhënat statistikore të nevojshme për vëzhgimin e gjendjes ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë, duke u përqendruar në fenomene thelbësore për vendimmarrësit, si dhe duke respektuar të drejtën e qytetarëve për të dhëna zyrtare. Për realizimin e programit mbahet parasysh parimi i kosto-efektivitetit.

Vendimet e Këshillit të Statistikave. Duke qenë se, sipas ligjit të statistikave zyrtare, roli i këtij organi është të mbikëqyrë, mbështesë dhe të marrë vendime në ndihmë të INSTAT-it dhe agjencive të tjera statistikore për të siguruar hartimin dhe zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare, aktet e miratuara nga ky

organ janë të rëndësishme për ecurinë e zbatimit të aktiviteteve statistikore si dhe monitorimin e performancës së institucioneve përbërëse të sistemit kombëtar statistikor.

Marrëveshjet e Mirëkuptimit. Janë akte të nënshkruara mes dy ose më shumë palëve institucionale të cilat marrin përsipër përbushjen e detyrimeve të ndërsjella për shkëmbimin e informacioneve statistikore, format dhe afatet e shkëmbimit të tyre, në mënyrë që të garantohet përbushja e aktiviteteve statistikore të parashikuara në Program.

Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA-së). INSTAT, së bashku me agjencitë statistikore, ka për detyrë të prodhojë statistika transparente, të paanshme dhe në kohë, duke ndihmuar përdoruesit të gjykojnë mbi ecurinë e proceseve transformuese drejt integritit në BE. Ky mision ushtrohet në përputhje me mandatin publik dhe institucional që ka INSTAT, duke synuar ngritjen e një sistemi funksional statistikor i cili të shfrytëzojë maksimalisht burimet e informacionit.

Gjithashtu, në kategorinë e akteve kombëtare futen edhe aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë funksionimin dhe përcaktojnë detyrat që duhet të mbulojnë agjencitë statistikore, pjesë përbërëse të sistemit statistikor shqiptar. Një listë e plotë e akteve ligjore dhe nënligjore është pasqyruar në Aneksin 1 të këtij Programi.

Në kategorinë e dytë përfshihen konventat e ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe aktet komunitare të BE-së, të cilat shteti shqiptar i ka marrë përsipër t'i përafrojë në zbatim të nenit 70 të MSA-së. Përafrimi i legjislacionit vendas në fushën e statistikave me *acquis communautaire* mbetet një ndër objektivat prioritare, në mënyrë që të garantohet zbatimi i parimeve të statistikave zyrtare si dhe cilësia e prodhimit statistikor.

III. OBJEKTIVAT KRYESORË TË PROGRAMIT 2012-2016 DHE RISITË

Duke qenë se sfida kryesore për Shqipërinë është rruga drejt BE-së, Sistemi Kombëtar Statistikor do të luajë një rol të rëndësishëm për të furnizuar institucionet publike dhe me gjerë me statistika zyrtare. Ndryshimet e shpejta reformuese të agjencive qeveritare do të ndikojnë në mënyrë të tërthortë edhe tek institucionet e

këtij sistemi, jo vetëm për shkak të kërkesave të reja për statistika, por edhe për shkak të mundësive të reja për burime të dhënash statistikore. Kjo do të kërkojë mobilizimin e burimeve, rritjen dhe përmirësimin e kontakteve ndërinstitucionale dhe kapacitete profesionale për të përballuar dhe drejtuar këtë sfidë, në mënyrë që të kemi një zhvillim hap pas hapi, të njëjtë në të gjitha aspektet.

Në këtë këndvështrim, objektivat kryesorë të këtij programi do të jenë:

Objektiva Strategjike:

- Përafrimi i standardeve të statistikave zyrtare me ato të BE-së, duke zbatuar metodologjinë e prodhimit e publikimit, duke përdorur instrumentet monitoruese si dhe duke zbatuar parimet e statistikave zyrtare sipas Kodit të Praktikës Statistike;
- Edukimi dhe përhapja e kulturës statistikore dhe stimulimi i kërkesës për informacion statistikor;
- Sigurimi i bashkëpunimit statistikor ndërmjet agjencive statistikore, duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për rritjen e performancës statistikore.

Objektivat e prodhimit dhe shpërndarjes:

- Rritja e burimeve të të dhënave statistikore primare;
- Ndërtimi i një sistemi të integruar informacioni, i cili do të ndihmojë agjencitë statistikore në përpunimin më të shpejtë të informacionit, përdorimin e më shumë burimesh statistikore, natyrisht, duke respektuar me rigorozitet parimet e konfidencialitetit statistikor;
- Hartimi i një politike të shpërndarjes së të dhënave duke përmirësuar kalendarin e publikimeve, duke përdorur kalendarin për të monitoruar zbatimin e afateve të publikimit, duke qartësuar rolin faqes elektronike *website* në marrëdhënie me median tjetër, si dhe duke bërë të disponueshme sa më shumë të dhëna të publikuara në format elektronik;
- Rritja e kapacitetit profesional të media-s për interpretimin e duhur të statistikave të prodhuara, duke njohur burimet dhe mekanizmat e ndjekura për kryerjen e procesit prodhues.

Objektivat e infrastrukturës statistikore:

- Rritja e kapacitetit profesional të INSTAT-it dhe agjencive të tjera statistikore, duke i familjarizuar më tej me metodat e reja të prodhimit statistikor, klasifikimet standarde, etj.;
- Rritja e Cilësisë së Menaxhimit të Sistemit Kombëtar Statistikor;

- Riorganizimi i strukturës organizative të INSTAT-it dhe zyrat rajonale statistikore me qëllim koordinimin e shkëmbimit dhe kryerjes së aktiviteteve statistikore në mënyrë më eficiente;
- Përdorimi i teknologjive të reja për përmirësimin e shkëmbimit të informacionit dhe rritjen e shpejtësisë së prodhimit statistikor, duke monitoruar ruajtjen e marrëdhënies kosto-efektivitet, si dhe duke përforcuar garancinë për mbrojtjen e konfidencialitetit statistikor.

Risitë që sjell Programi i Statistikave Zyrtare 2012-2016 do të jenë kryesisht sipas fushave:

Për statistikat demografike:

- Marrja e informacionit të statistikave vitale (lindje, vdekje, martesë) nga formularë shkresorë, në elektronikë;
- Përdorimi i klasifikimit të ri ICD10 mbi sëmundshmërinë dhe shkaqet e vdekjeve;
- Duke filluar nga viti 2013, Anketa e Buxhetit të Familjes do të realizohet nga një anketë me bazë 1 vjeçare në anketë me bazë 3-mujore;
- Përllogaritja e linjës së varfërisë në Shqipëri jo vetëm në nivelin NUTS 1, por edhe në nivelin NUTS 3.
- Kryerja e anketës për kostot e punës në vitin 2013

Për statistikat makroekonomike:

- Paraqitja e të dhënave vjetore të llogarive kombëtare sipas sektorëve institucionalë. Format cilësor i mësipërm i të dhënave kryesore të ekonomisë do të japë një pamje mjaft sintetike të veprimtarisë të të gjithë aktorëve ekonomikë të ekonomisë shqiptare, duke ndihmuar në këtë mënyrë përdoruesit me më shumë informacion për analizat makroekonomike të vendit.
- Vlerësime të pavarura vjetore të komponentëve përbërës të PBB me anë të metodës së shpenzimeve, duke u përqendruar sidomos në treguesin e konsumit individual të popullatës (me çmime korrente e konstante);
- Vlerësime të ecurisë tremujore të komponentëve përbërës të PBB me anë të metodës së shpenzimeve;
- Zhvillimi i sistemit të integruar statistikor për hartimin e tabelave Burime-Përdorime dhe *Input-Output*;

Për statistikat e biznesit:

- Grumbullimi i informacionit të statistikave ekonomike nga ndërmarrjet duke përdorur teknika moderne si *webform*, postë do të rrisë shkallën e përgjigjes nga ana e ndërmarrjeve, besueshmërinë dhe shifra sa më afër realitetit
- Përdorimi i sistemit të ri të aplikimit nga formati Excel në aplikimin SQL për çmimet e konsumit do të rrisë cilësinë e analizës së çmimeve të konsumit në seri kohore; Rinovimi i peshave të produkteve dhe shportës së produkteve të konsumit bazuar në rezultatet e anketës më të fundit të buxhetit të familjes;
- Përdorimi i klasifikimeve të reja NACE Rev.2 dhe CPA 2008 mbi aktivitetet ekonomike dhe produktet do të rrisë shkallën e krahasueshmërisë së statistikave shqiptare me statistikave evropiane, në drejtim të përdorimit të klasifikimeve të rishikuara nga Eurostat si dhe do të rrisë nivelin e përafrimit me rregulloret e BE;
- Organizimi i anketës mbi produktet dhe shërbimet shqiptare me periodicitet tremujor, (i parashikuar në planin e kaluar si vrojtim i veçantë, por i realizuar si pjesë e vrojtimit strukturor të ndërmarrjeve), do të shërbejë jo vetëm për prodhimin e statistikave mbi sasinë dhe vlerën e produkteve dhe shërbimeve shqiptare, por do të përdoret edhe për hartimin e tabelës së Burime-Përdorime;
- Riorganizimi i vrojtimit strukturor pranë ndërmarrjeve sipas aktiviteteve do të rrisë nivelin e përfaqësimit për çdo aktivitet në drejtim të numrit të variablave dhe indikatorëve të prodhuar;
- Matja e tendencës së çmimeve të importit do të pasqyrojë jo vetëm tendencën e çmimeve të produkteve të importuara, por do të shërbejë edhe si deflator për statistikave të ndërmarrjeve dhe statistikave makroekonomike
- Matja e kostos së punimeve civile inxhinierike do të paraqesë tendencën e kostos së punimeve inxhinierike të kryera sipas elementëve përbërës
- Përdorimi i programit Eurotrace në statistikave të tregtisë së jashtme do të rrisë nivelin e cilësisë së këtyre të dhënave, shkallën e korrektimit dhe konvertimin e të dhënave të import-eksportit në disa klasifikime statistikore të domosdoshme për statistikave makroekonomike;

Për statistikave të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit:

- Ngritja e strukturës së statistikave të bujqësisë pranë INSTAT, duke e bërë këtë institucionin e vetëm përgjegjës për prodhimin e statistikave bujqësore;
- Krijimi i regjistrit të fermave bujqësore nga Regjistrimi i Përgjithshëm Bujqësisë, i planifikuar të kryhet në vitin 2012;
- Kryerja e vrojtimit të strukturës së fermës si dhe llogaritë ekonomike në bujqësi;

- Llogaritja e indeksit të çmimeve të produkteve bujqësore nëpërmjet vrojttimeve;
- Kryerja e vrojttimeve mbi blegtorinë, qumështin dhe produktet e tij me metodologji bashkëkohore.

Për statistikat *multi-domain* (mjedisit, shkencës dhe teknologjisë, informacionit):

- Kryerja e vrojtimit në nivel rrethi për mbetjet urbane;
- Kryerja e vrojtimit mbi teknologjinë e informimit të komunikimit pranë ndërmarrjeve;
- Kryerja e vrojtimit mbi shkencën dhe teknikën, inovacionin dhe teknologjinë.

Për mbështetjen për prodhimin statistikor (Regjistrat statistikorë dhe Klasifikimet):

- Regjistra statistikorë të njësive ekonomike, Ndërmarrjeve e Njësive Lokale, të përditësuar e cilësorë, sipas rekomandimeve të BE-së dhe kërkesave të brendshme; adresa të kodifikuara sipas koordinatave gjeografike për qytete e mëdha, sipas sistemit GIS nga përdorimit i GPS në çdo aktivitet statistikor;
- Kryerja e anketave specifike për përditësimin e regjistrave statistikorë të njësive ekonomike, përsëritja e asaj ekzistuese me afate periodike tremujor “Anketa e Ndërmarrjeve të Reja” si dhe futja në program e anketës së re vjetore “Anketa e Njësive Lokale”;
- Implementimi i klasifikimit të rishikuar të aktiviteteve NACE Rev.2 në të gjitha aktivitetet statistikore brenda INSTAT si dhe në shkallë vendi;
- Implementimi i klasifikimit të produkteve sipas CPA 2008 në të gjitha aktivitetet statistikore;

Për Teknologjinë e Informacionit

- Përdorimi i teknologjive të reja për kapjen dhe përpunimin e të dhënave;
- Shkëmbimi i informacionit *online* dhe nëpërmjet një protokolli të përcaktuar me agjencitë statistikore;
- Krijimi i magazinës së të dhënave (*data warehouse*) për integrimin e bazave të të dhënave të INSTAT-it, përfshi edhe *metadata*-n;
- Publikimi i një *website* dinamik të ri për përdoruesit për marrjen e të dhënave në kohë dhe sipas formateve të ndryshme;
- Ndërtimi i rrjetit të brendshëm komunikimi (*intranet*) për shkëmbimin në kohë të informacionit ndërmjet punonjësve.

Për bazën ligjore

- Rishikimi i ligjit ekzistues të statistikave zyrtare në mënyrë që të përmbushen rekomandimet e BE-së dhe Eurostat-it, me synimin e përafrimit të bazës ligjore mbi të cilën mbështetet veprimtaria e Sistemit Kombëtar Statistikor me atë të *acquis communautaire* si dhe të sigurohet pavarësia profesionale e institucioneve që merren me prodhimin e statistikave zyrtare.

IV. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Nenet 6 dhe 7 të ligjit nr.9180, datë 05.02.2004 “Për statistikat zyrtare” janë baza ligjore e INSTAT-it për kryerjen e aktiviteteve statistikore, si dhe për monitorimin e atyre të kryera nga agjencitë statistikore. Gjithashtu, ligji i jep të drejtë INSTAT-it të koordinojë grumbullimin e informacionit administrativ dhe të kontrollojë cilësinë e regjistrave të të dhënave administrative.

Në këtë këndvështrim INSTAT duhet të ngrëjë sisteme eficiente për menaxhimin cilësor të Sistemit Kombëtar Statistikor. Instrumenti më i rëndësishëm për monitorimin e veprimtarisë së sistemit statistikor është Programi Pesëvjeçar i Statistikave Zyrtare.

4.1 Procedura e ndjekur për hartimin e Programit

Për ndërtimin e Programit të ri të Statistikave Zyrtare, INSTAT është bazuar në strukturën e Compendium 2011. Duke zërthyer të gjitha nivelet e Compendium-it të Eurostat-it ka qenë më e lehtë të vlerësohen kushtet në të cilat operon sistemi ynë statistikor, të konstatohet gjendja aktuale e statistikave, të evidentohen anët e forta dhe të dobëta krahasuar me standardet që kërkojmë të arrijmë.

Veç kësaj, një arsye tjetër për përdorimin e kësaj strukture ka qenë edhe fakti se ky Program është parë e arsyeshme të jetë në të njëjtën linjë me atë kombëtar për zbatimin e MSA-së. Struktura e përgjigjeve për progresin në Kapitullin 18 “Statistikat” të *Acquis Communautaire*, ku INSTAT është institucioni përgjegjës koordinues, është e ndërtuar në të njëjtën formë me këtë Program (në nivel Fushe).

Fillimisht, si institucioni përgjegjës me ligj për draftimin e Programit, INSTAT-i i ka kërkuar të gjitha institucioneve publike të plotësojnë një matricë informative, e cila përmbante të gjitha aktivitetet statistikore që mbulonte institucioni përkatës, metodikën e kryerjes së tyre, periodicitetin, institucionet përgjegjëse për sigurimin e të dhënave si dhe bazën ligjore ku mbështetej zbatimi i këtyre aktiviteteve. Gjithashtu, matrica jepte informacion edhe për aktivitetet e reja që kishin parashikuar të kryenin institucionet në vitet e ardhshme, si dhe një listë të

statistikave zyrtare që këto institucione kërkonin t'i prodhonte sistemi ynë statistikor.

I gjithë ky informacion i marrë nga matricat, është hedhur në një *database* të veçantë, i cili ndihmon për hartimin e tabelave të ndryshme informative për të vlerësuar se çfarë prodhon sistemi statistikor në Shqipëri, kur dhe si i prodhon, cilat janë agjencitë përgjegjëse për t'i prodhuar dhe institucionet përgjegjëse për sigurimin e informacionit, cila do të jetë forma dhe afati i publikimit të statistikave të prodhuara, etj.

Nëpërmjet kësaj baze të krijuar të dhënash, është bërë e mundur të hartohen edhe tabelat e Aneksit II të këtij Programi, ku çdo i interesuar mund të orientohet për të marrë informacionin e lartpërmendur. Gjithashtu, tabelat ndihmojnë veçanërisht për të përcaktuar burimin e të dhënave, administrative ose jo, duke pasqyruar konkretisht institucionet e ngarkuara për sigurimin e informacionit. Baza e të dhënave do të jetë e aksesueshme në faqen elektronike të INSTAT-it, dhe çdo i interesuar do të njihet më hollësisht me informacionin që ajo mban.

Ashtu si dhe Compendium 2011, ky Program në përbërje të tij përfshin të gjitha fushat e statistikave, të ndara në nënkapitujt:

- I. Statistikat Demografike dhe Sociale;
- II. Statistikat makroekonomike;
- III. Statistikat e biznesit;
- IV. Statistikat e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit;
- V. Statistikat *multi-domain* (mjedisit, shkencës dhe teknologjisë, informacionit);
- VI. Mbështetja për prodhimin statistikor (Regjistrat statistikorë dhe Klasifikimet);
- VIII. Politika strategjike dhe Koordinimi.

Secili nënkapitull është ndarë në nivel Teme, e cila nëndahet në Module.

Duke qenë se sistemi ynë statistikor nuk është në gjendje t'i përshtatet plotësisht parashikimeve të Compendium 2011, d.m.th. jo të gjitha aktivitetet statistikore që zhvillohen në Republikën e Shqipërisë mund të grupohen dhe plotësojnë të gjithë Compendium-in, ky Program nuk përfshin të gjitha modulet e parashikuara në dokumentin e Eurostat-it. Sidoqoftë, fakti që struktura kryesore (në nivel Fushe) përmban informacion, si dhe pjesa më e madhe e temave dhe moduleve është plotësuar, tregon se sistemi ynë statistikor prodhon statistika në pjesën më të madhe të fushave socio-ekonomike e më gjerë.

Në brendësi të secilit modul, duke patur parasysh edhe formën e lartpërmendur të raportimit për ecurinë e PKZMSA-së për Kapitullin 18, ndodhen disa nëndarje për të pasqyruar: një përshkrim të shkurtër të situatës aktuale të statistikave të kategorisë përkatëse, objektivat strategjike dhe aktivitetet që do të

zbatohen për arritjen e tyre, si dhe rezultatet e pritshme që do të tregojnë, në fund të fundit, edhe shkallën e përputhshmërisë së standardit me atë të Compendium-it.

4.2 Analiza SWOT (Fuqitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Kërcënimet)

Ashtu si në Programin Statistikor 2007-2011 , analiza SWOT përfshin klimën në të cilën funksionon Sistemi Kombëtar Statistikor, duke vënë në qendër INSTAT-in, si institucioni përgjegjës për monitorimin e ecurisë dhe performancës së këtij sistemi. Tashmë INSTAT ka krijuar një eksperiencë pothuaj 20 vjeçare dhe është në gjendje të vlerësojë kapacitetin, mekanizmat dhe burimet me të cilat operon. Gjithashtu, një ndihmë të madhe japin edhe raportet e vlerësimit të hartuara nga ekspertët e huaj në vite, veçanërisht Raporti Global i Vlerësimit të Sistemit Kombëtar Statistikor i hartuar nga Eurosta-it për Shqipërinë në Tetor 2010. Ky dokument, i hartuar me kërkesën e Eurosta-it për vlerësimin e sistemit statistikor në kuadër të procesit të vlerësimit të përgjigjeve të Pyetësorit për anëtarësim në BE, ka vënë në dukje jo vetëm problematikat e sistemit, por edhe ka dhënë rekomandimet e mundshme për zgjidhjen e tyre. Në këtë këndvështrim, analiza SWOT hartohet si vijon:

FUQITË

- **Bazë e konsoliduar ligjore.** Duke marrë parasysh eksperiencën e deritanishme të funksionimit të Sistemit Kombëtar Statistikor, si dhe raportet e vlerësimit të ekspertëve të Eurostat-it, konstatohet se ligji aktual për statistikave zyrtare është një bazë e fortë ligjore për prodhimin e statistikave zyrtare. Kjo kornizë mundëson zbatimin e parimeve themelore të statistikave zyrtare, duke garantuar pavarësinë profesionale dhe konfidencialitetin statistikor.
- **Mbështetje e politikës mbi të dhënat statistikore,** gjë që ka mundësuar konsolidimin e treguesve statistikore si dhe kryerjen e aktiviteteve të reja statistikore.
- **Reputacion pozitiv.** Duke u mbështetur në pavarësinë dhe aftësitë profesionale të stafit, INSTAT gëzon respektin e përdoruesve gjë që ka sjellë jo vetëm rritjen e numrit të tyre, por edhe rritjen e kërkesave për statistika. Tashmë ky institucion njihet jo vetëm si prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare, por edhe si institucioni përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve zyrtare statistikore në vend. Në këtë aspekt, INSTAT gëzon reputacion të mirë edhe tek donatorët, të cilët kanë dhënë një kontribut të madh për përmbushjen e aktiviteteve statistikore madhore, duke gjetur përballë një institucion korrekt, të qëndrueshëm dhe të aftë profesionalisht.

- **Ndërlidhje e fortë mes pjesës më të madhe të sektorëve statistikorë.** Shkëmbimi i informacionit statistikor në kohë dhe sipas formës së kërkuar i mundëson sektorëve prodhimin e statistikave sipas metodologjisë dhe kalendarit të parashikuar. Nëpërmjet disa sektorëve statistikorë pranë ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera publike, INSTAT ka arritur të krijojë kontaktet e duhura për të krijuar një rrjet të konsoliduar shkëmbimi statistikor.
- **Staf profesional dhe i motivuar.** Personeli i sistemit statistikor, veçanërisht i INSTAT-it, gëzon kapacitetet profesionale jo vetëm në fushat statistikore, por edhe në ato mbështetëse, si teknologji informacioni dhe administrative. Gjithashtu, pothuajse i gjithë stafi zotëron shumë mirë gjuhën angleze.
- **Aftësi trajnuese për personelin, statisticienët e rinj dhe përdoruesit.** Eksperienca e fituar gjatë ushtrimit të profesionit në institucion, si dhe njohuritë e marra gjatë misionëve të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, kanë bërë që një pjesë e madhe e stafit të zotërojë njohuri të mjaftueshme për të gjitha proceset, metodologjitë dhe format e tjera që duhen ndjekur për prodhimin e statistikave zyrtare.
- **Përputhje dhe zbatim i klasifikimeve statistikore ndërkombëtare.** Pjesa më e madhe e klasifikimeve kombëtare statistikore i është përshtatur standardeve ndërkombëtare.
- **Marrëdhënie të mira ndërkombëtare.** Në kuadër të proceseve për zbatimin e MSA-së, si dhe duke përfituar nga eksperiencat e ofruara nga Eurostat-i dhe ekspertët e tjerë të huaj, INSTAT dhe agjencitë statistikore kanë arritur të forcojnë marrëdhëniet ndërinstitucionale, si kombëtare ashtu edhe ndërkombëtare.
- **Vetëdije për standardet e cilësisë së statistikave zyrtare.** Me drejtimin e duhur menaxherial, si dhe duke përfituar nga proceset monitoruese të Eurostat-it, Instituti i Statistikave dhe agjencitë e tjera statistikore janë të ndërgjegjshëm për ngritjen e sistemeve monitoruese dhe përdorimin e instrumenteve të duhura me qëllim rritjen e cilësisë së prodhimit të statistikave zyrtare.

DOBËSITË

- **Forma të pamjaftueshme komunikimi me aktorët.** Format e komunikimit me aktorët kryesorë duhet të zhvillohen më tej. Duhet punuar veçanërisht për një komunikim më të mirë me institucionet që sigurojnë të dhënat administrative.

- **Shpërndarja e informacionit statistikor.** Disponimi i një kalendari publikimi nuk është i mjaftueshëm për të patur një politikë të qartë shpërndarjeje të statistikave zyrtare. Prandaj, duhen ndërmarrë veprime të tjera zhvilluese për të përcaktuar mënyrat më të mira të publikimit dhe transmetimit prodhimit statistikor, për të vendosur në format PDF të gjitha të dhënat e prodhuara, etj.
- **Përdorimi jokorrekt dhe moskuptimi i të dhënave statistikore të publikuara.** Për këtë, trajnimi i përdoruesve për fusha të ndryshme të statistikës do të ndikonte në rritjen e shkallës së interpretimit dhe analizave të informacionit statistikor. Mungesa e integritetit të sistemit të *metadata*-ve në web ndikon që përdorues të ndryshëm të mos kuptojnë si duhet metodologjinë e ndjekur për prodhimin e të dhënave statistikore.
- **Informacioni jo i plotë nga njësitet statistikore ekonomike (jobujqësore).** Pavarësisht përcaktimit të metodave të përdorura për mbledhjen e të dhënave, me deklaram të lirë “ballë për ballë” apo me postë, njësitet statistikore ekonomike jobujqësore e japin informacionin e kërkuar jo të plotë, me gabime. Gjithashtu, shpesh nuk respektohet afati kohor për dërgimin e të dhënave administrative.
- **Infrastruktura jo e plotë statistikore në institucionet e administratës publike.** Në ministritë e linjës apo institucionet e tjera publike mungesa e zyrës së statistikës dhe stafit përkatës sjell mangësi në cilësinë e informacionit statistikor si dhe në sigurimin e këtij informacioni brenda afatit.
- **Mungesa e strukturës akademike në profil statistike për përgatitjen specialistëve të rinj.** Kjo sjell vështirësi në gjetjen dhe rekrutimin e kandidatëve të përshtatshëm që angazhohen në fushën e statistikave.

MUNDËSITË

Programi i ri statistikor 2012-2016 do të :

- Mbështesë politikbërësit për hartimin e politikave makroekonomike dhe sociale si në nivel kombëtar ashtu edhe rajonal.
- Forcojë lidhjet me institucionet e tjera, agjenci statistikor ose jo.
- Konsolidojë Sistemin Statistikor Kombëtar duke e harmonizuar atë me standardet e BE-së.
- Rrisë aftësitë profesionale të stafit.

KËRCËNIMET

Kërcënimi kryesor që INSTAT mund të dështojë në përmbushjen e kërkesave sfiduese gjatë këtyre pesë vjetëve është për disa arsye:

- Moszbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga ky Program nga të gjithë aktorët, si: mosrespektimi i afateve kohore për dërgimin e të dhënave dhe informacioni jo i plotë nga njësitë statistikore dhe siguruesit e të dhënave administrative, do të sillte vonesë në zbatimin e aktiviteteve statistikore sipas afateve të parashikuara dhe mangësi në sasinë dhe cilësinë e treguesve.
- Mungesa e zyrës së statistikës si dhe lëvizja e herëpashershme e strukturës organizative në ministritë e linjës dhe institucionet e tjera që sigurojnë të dhënat administrative, nuk do të garantonte realizimin e këtij Programi.
- Mungesa e burimeve të mjaftueshme financiare mund të rrezikojë moskryerjen e vrojttimeve të parashikuara në këtë Program.
- Mospërdorimi i klasifikimeve të njëjta në të gjitha institucionet. Nëse nuk do të arrihet përdorimi i klasifikimeve të parashikuara të implementohen gjatë zbatimit të këtij programi, atëherë kjo do të sillte mospërputhshmërinë e të dhënave për të njëjtët tregues.

4.3 Sistemi i Integruar i Teknologjisë së Informacionit

Nga këndvështrimi i teknologjisë së informacionit, sistemet statistikore të informacionit gjithmonë kanë përbërë një seri sfidash, kërkimesh e përparime teknologjike në shumë fusha të ndryshme, duke filluar nga teknikat e avancuara të grumbullimit të të dhënave, validimit dhe vizualizimit të të dhënave, nga *metadata repositories* dhe *data warehouse* shumëfishe tek *data mining* etj.

Statistika është një profesion i lidhur me informacionin, prandaj dhe suksesi i statistikave varet nga mënyra që ne jemi në gjendje të mbledhim, përpunojmë, ruajmë dhe të shpërndajmë këtë informacion. Duke hyrë në shekullin e 21-të, menaxhimi i informacionit statistikor është i paimagjinueshëm pa një mbështetje të mjeteve përshtatshme të teknologjisë moderne të informacionit.

Integrimi i sistemeve të informacionit statistikor kërkon marrjen në konsideratë të nevojave të ndryshme specifike të fazave individuale të përpunimit të të dhënave dhe në kontekste të ndryshme. Prandaj, krijuesit e sistemeve të integruara të informacionit statistikor duhet, si hap të parë, të krijojnë një model që të përshkruajë funksionet e zyrave statistikore.

INSTAT-i merr një sasi të madhe të të dhënave administrative nga institucionet e tjera. Këto të dhëna janë mbledhur në mënyra të ndryshme dhe në formate të ndryshme. Këto të dhëna janë përdorur për të prodhuar statistika sociale dhe statistika ekonomike. Mungesa e sistemit elektronik të shkëmbimit të të

dhënave administrative ndikon në procesin e prodhimit të statistikave zyrtare, bazuar në Programin shumëvjeçar të statistikave zyrtare.

Implementimi i një sistemi për automatizimin e mbledhjes së të dhënave dhe përpunimi nga burime administrative do të rrisë cilësinë statistikore dhe do të zvogëlojë kohën e përpunimit e të shpërndarjes. Brenda kontekstit të një zyre statistikore, në përgjithësi, një magazinë e të dhënave statistikore mund të përkufizohet si një magazinë e vetme, e plotë dhe pjesë e *metadata*-s të cilat janë fituar nga burime të ndryshme, të mbledhura e kombinuara për të formuar një strukturë; të dokumentuara në një format standard dhe të ruajtura në një strukturë që lejon përdoruesit të shohin, të ekzekutojnë *query*, të kombinojnë e shkarkojnë të dhënat për analiza në nivele të ndryshme. Për të arritur qëllimet e përmendura më lart, magazina e të dhënave si vend i magazinimit duhet të themelohet, por edhe të dokumentojë procesin e përgjithshëm të magazinimit të të dhënave, në të cilin instituti mbledh, transformon dhe ngarkon të dhënat në sisteme fizike të ndryshme, të optimizuara për marrjen e vendimeve. Zgjidhja duhet të jetë e orientuar nga *metadata*.

Projektimi, zhvillimi dhe zbatimi i magazinës së të dhënave (*Data Warehouse- DW*) të INSTAT-it konsiston në:

- Përcaktimin e kërkesave DW;
- Identifikimin e *software* më të përshtatshëm për menaxhimin e DW;
- Zhvillimi i sistemit DW;
- Plotësimi i DW me informacionin statistikor dhe përcaktimi i procedurave standarde për të mirëmbajtur DW;
- Marrja e të dhënave.

Standardizimi i transferimit të të dhënave nga organizatat qeveritare - ofruesit e të dhënave administrative për zyrën statistikore, do të ketë një ndikim pozitiv në sistemin e përgjithshëm statistikor.

Automatizimi i mbledhjes së të dhënave dhe përpunimi nga burimet administrative konsiston në:

- Identifikimin e të gjithë burimeve të të dhënave të kërkuara nga INSTAT-i, në bazë të Programit;
- Përcaktimin e protokollit të këmbimit të të dhënave;
- Zbatimi i sistemit për këmbimin e të dhënave.

V. AGJENCITË STATISTIKORE

Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 “Për statistikat zyrtare”, i ndryshuar, parashikon qartësisht përkufizimin e agjencive statistikore si autoritetin përgjegjës, përveç Institutit të Statistikave, të autorizuar sipas Programit të Statistikave Zyrtare për të ndërmarrë veprimtari për prodhimin e statistikave zyrtare.

Duke u bazuar në informacionin e mbledhur përmes matricave, si dhe përpunimit të të dhënave që përmban *database* i këtij Programi, është arritur të vendosen prioritetet për prodhimin e statistikave gjatë periudhës pesëvjeçare 2012-2016, si dhe të përcaktohen institucionet përgjegjëse që do të luajnë rolin e agjencisë statistikore gjatë kësaj periudhe. Pasqyra e mëposhtme liston këto agjenci si dhe numrin e aktiviteteve statistikore zyrtare pjesë e Programit.

Agjencitë statistikore dhe numri i aktiviteteve statistikore

Agjencia Statistikore	Numri i aktiviteteve statistikore
Instituti i Statistikave	115
Banka e Shqipërisë	65
Ministria e Financave	9

VI. PLANIFIKIMI I KOSTOS SË NEVOJSHME PËR KRYERJEN E OPERACIONEVE STATISTIKORE 2012-2016

Për planifikimin e kostove të mbulimit të aktiviteteve statistikore që do të kryhen gjatë periudhës 2012-2016, janë marrë parasysh dokumentet e planifikimit buxhetor, të hartuar në përputhje me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe aktet nënligjore dhe Udhëzimet e Ministrisë së Financave në zbatim të tij. Që nga viti 2010, pranë INSTAT funksionojnë Grupi për Strategjinë, Buxhetin dhe Integrimin (GSIB) dhe Ekipi për Menaxhimin e Programit (EMP). Këto struktura operojnë jo vetëm për orientimin e strategjive sektoriale, por edhe për planifikimin dhe monitorimin e ekzekutimit të fondeve buxhetore afatmesme për institucionin.

Gjithashtu, dokumente të rëndësishme planifikimi financiar janë edhe projekt-fishat e plotësuar nga INSTAT për fondet IPA kombëtare dhe me shumë përfitues, marrëveshjet e nënshkruara mes Qeverisë Shqiptare dhe atyre Zvicerane e Suedeze, të cilat do të mbulojnë një pjesë të madhe të zërave për aktivitetet madhore statistikore gjatë periudhës pesëvjeçare, si dhe asistencën teknike

përkatëse, shumë të nevojshme për garantimin e ecurisë së proceseve në përputhje me standardet e duhura.

Ndërkohë, brenda buxhetit vjetor janë përfshirë edhe zërat e aktiviteteve që janë në proces implementimi, të cilat përfshijnë periudha të Programit paraardhës dhe gjejnë vazhdimësinë në këtë Program. Ndër veprimet operacionale të projekteve kryesore në zbatim e sipër veçohen ato në kuadër të Census-Al 2011, Regjistrimit të Përgjithshëm të Bujqësisë, etj.

Një element që ndikon në buxhetin e INSTAT-it është mënyra e mbledhjes së të dhënave. Duke qenë se pjesa më madhe e tyre kryhet duke përdorur intervistues, atëherë një pjesë e konsiderueshme e buxhetit shërben për mbulimin e shpenzimeve për pagat, dietat dhe të tjera operative.

Tabela 5.1 paraqet strukturën e kostos së aktiviteteve statistikore të realizuara me fondet e alokuar nga buxheti i shtetit, për vitet 2010 dhe 2011 nga INSTAT.

Tabela 5.1 Struktura e kostos

Në mijë Lekë

Shpenzime	2010	2011
Vrojtime në ndërmarrje	29,661	31,320
Vrojtime në familje	25,612	26,125
Regjistrime (ndërm.+pop.)	113,856	433,542
Shpenzime institucionale	195,949	196,360
Shuma	365,078	687,347

Tabela 5.2 paraqet parashikimin e buxhetit të INSTAT-it për periudhën 2012-2016, i cili është në përputhje me Programin Buxhetor Afatmesëm.

Sa i takon fondeve nga donatorët e huaj, për vitet e ardhshme INSTAT ka aplikuar të përfitojë nga fondet dhe grantet e BE-së (IPA Kombëtare dhe me shumë përfitues), Kombeve të Bashkuara (UNFPA, UNICEF, UNDP) si dhe qeverisë së Zvicrës dhe Suedisë. Duke qenë se ndodhemi akoma në fazë studimi dhe aplikimi, nuk mund të jepet një vlerë e saktë për vitet e ardhshme.

Tabela 5.2 Parashikimi i buxhetit 2012-2016

Në milion Lekë

	2012	2013	2014	2015	2016
Të mbuluara nga buxheti	430	479	500	522	552
Të mbuluara nga asistenca e huaj	420				

VII. MONITORIMI I ECURISË SË PROGRAMIT

Monitorimi i ecurisë së programit është element shumë i rëndësishëm për garantimin e plotësisimit të aktiviteteve statistikore të parashikuara në të. Ligji nr.9180, datë 05.02.2004 “Për statistikatat zyrtare” i parashikon instrumentet monitorues. Sipas neneve 8 dhe 11 të tij, autoritetet prodhuese të statistikave zyrtare i paraqesin për miratim Këshillit të Statistikave një Raport Vjetor mbi ecurinë e Programit dhe punën e kryer. Bazuar në këtë dokument, Këshilli i Statistikave mund të propozojë ndryshimet e mundshme në Program, për të garantuar shmangien e problemeve në vitet pasardhëse, si dhe për t’iu përshtatur ndryshimeve të kushteve ekonomike, sociale dhe mjedisore në vend.

Sipas ligjit të lartpërmendur, Këshilli i Statistikave shqyrton edhe raportet katërmujore të paraqitura nga INSTAT-i për ecurinë e zbatimit të Programit. Në këtë mënyrë, Këshilli i Statistikave vlerëson eficiencën e zbatimit dhe përputhshmërinë e produkteve me kërkesat ndërkombëtare.

Instrumente të tjera monitoruese janë edhe ekzekutuesit e autorizuar të cilët, brenda tremujorit të parë, përgatisin raporte vjetore për ecurinë e zbatimit të aktiviteteve sektoriale gjatë vitit paraardhës. Raportet shqyrtohen nga Këshilli i Statistikave, i cili jep edhe rekomandimet e veçanta për tu patur parasysh gjatë viteve në vazhdim.

Marrëveshjet e ndryshme të mirëkuptimit, nënshkruar mes INSTAT dhe agjencive statistikore ose me institucionet e tjera publike/jopublike, parashikojnë ngritjen e grupeve të përbashkëta për të diskutuar mbi zbatimin e aktiviteteve statistikore, programet për të ardhmen, etj. Këto struktura ndikojnë në ndërgjegjësimin e agjencive përkatëse për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ky Program, si në aspektin prodhues të statistikave, ashtu dhe në atë të dhënies së informacionit. Së bashku me prodhuesit e statistikave zyrtare, ata sigurojnë harmonizimin maksimal të prioriteteve të dhëna në programin trevjeçar me ato të programeve vjetore gjatë gjithë kohës që është në fuqi ky Program.

Ndërkohë, rolin monitorues të veprimtarisë statistikore të të gjithë sistemit në vend, e ka Instituti i Statistikave. Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të MSA-së, si dhe zbatimit të rekomandimeve të BE-së për Shqipërinë për përafrimin me *Acquis Communautaire* sipas Kapitulli 18 “Statistikatat”, INSTAT përpiqet të krijojë një kulturë në rritje statistikore midis agjencive të tjera, duke ndjekur shkallën e përpjekjeve për të realizuar detyrimet e MSA-së nga këto agjenci.

FUSHA 1 – STATISTIKAT DEMOGRAFIKE DHE SOCIALE

Tema 1.01 Popullsia

Përshkrimi

Statistikat e Popullsisë studiojnë popullsinë sipas dimensioneve hapësinore të shpërndarjes dhe strukturës së saj, duke iu referuar karakteristikave demografike, sociale dhe ekonomike. Në mënyrë që të nxirren ligjshmëritë që kanë prodhuar këto fenomene demografike merret parasysh evolucioni i këtyre ndryshimeve. Gjithashtu, njohuritë mbi fenomenet demografike vihen në shërbim të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit.

Statistikat e popullsisë apo statistikat demografike të Shqipërisë janë bazuar në të dhënat e Regjistrimeve të Popullsisë dhe të dhënat e lëvizjeve natyrore dhe të brendshme të popullsisë, të monitoruara nga skedat e statistikave vitale.

Prioritetet

Nga viti 1950 deri në 1990, popullsia e Shqipërisë ka përjetuar dekada të rritjes së shpejtë të popullsisë, edhe pse ritmi i kësaj lëvizje ra në mënyrë progresive. Lindshmëria ishte shumë më e lartë se kudo tjetër në Evropë, ndërkohë që vdekshmëria ishte relativisht e lartë, gjë që ndjek modelin e vendeve Mesdhetare. Shkëmbimet me vendet e huaja përmes migrimit ishin pothuajse inekzistente dhe lëvizjet në vend, nga rajoni në rajon, ishin shumë të kufizuara.

Vitet 90-të e ndryshuan në mënyrë të konsiderueshme këtë pamje. Rënia e lindshmërisë shkoi drejt niveleve që janë më afër vendeve evropiane, emigracioni ishte në shkallë të gjerë, duke lënë gjurmë të forta në piramidën e moshës. Gjithashtu migracioni i brendshëm e ndryshoi shumë ekuilibrin midis rajoneve të vendit. Vitet që pasuan pas regjistrimit të popullsisë 2001, theksuan rënien e lindshmërisë në nivele akoma më të ulëta dhe një vdekshmëri pothuaj stacionare. Të dhënat për vitin 2001 janë marrë nga rezultatet e Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave që u krye në prill të vitit 2001. Të dhënat e popullsisë 1995-2000 u bazuan në projeksionet e popullsisë duke marrë si bazë rezultatet e regjistrimit të popullsisë të vitit 1989. Hipoteza e emigracionit sipas projeksioneve pas vitit 1995 nuk u vërtetua, sepse kjo dukuri mori përmasa më të mëdha në vitet në vazhdim. Kjo ka sjellë që në Shqipëri ritmi i rritjes së popullsisë të jetë akoma pozitiv, por riprodhimi i saj të jetë i pamundur.

Studimet demografike të thelluara do të mund të sjellin në vëmendje të politikbërësve masat që duhen marrë në të ardhmen, nëse këta tregues do të vazhdojnë të ulen, pra nëse popullsia do të fillojë të plakët.

Moduli 1.01.01 Demografia, censuset dhe projeksionet

1.01.01.01 Demografia

Përshkrimi i situatës aktuale

Një burim kryesor për furnizimin me të dhëna në sektorin e demografisë është Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile e cila siguron të dhënat lidhur me statistikave vitale: lindjet, vdekjet, vdekjet nën një vjeç dhe martesat.

Sistemi i regjistrimit të gjendjes civile aktualisht është në proces modernizimi. Disa nga kufizimet e vëzhguara në sistemin aktual do të mënjahen në të ardhmen. Sidoqoftë, identifikimi i kufizimeve është i nevojshëm, pasi kjo lejon kuptimin e vështirësive që do të hasen në implementimin e sistemit të ri.

Ministria e Brendshme ka përgjegjësinë e prodhimit të akteve civile dhe mbledhjen e statistikave vitale. Në total, në Republikën e Shqipërisë, gjenden 408 Zyra të Gjendjes Civile të cilat mbledhin të dhëna për lindjet, martesat, vdekjet foshnjore dhe vdekjet e tjera në nivel lokal. Ministria ka përgjegjësinë gjithashtu për krijimin dhe administrimin e Regjistrin Themeltar Elektronik të Popullsisë.

Të dhënat mbi lindjet, vdekjet dhe martesat tashmë do të merren *online* nga regjistrat e Gjendjes Civile. Kjo praktikë e re e mbledhjes së të dhënave do të sigurojë një cilësi, shpejtësi dhe disponibilitet më të lartë të të dhënave.

A. Lindjet dhe vdekjet

Lindjet dhe vdekjet janë dy ndër tre komponentët kryesorë që ndikojnë në ndryshimin e popullsisë së një vendi dhe, si rrjedhojë, ata janë tepër të rëndësishëm për llogaritjen e numrit të popullsisë.

Të dhënat mbi lindjet dhe vdekjet merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Regjistrimi i lindjeve dhe vdekjeve bëhet fillimisht në bashkinë ku ndodhet banesa ligjore (vendi ku personi është regjistruar në Regjistrin Themeltar), pastaj në regjistrin specifik dhe më pas në një formular i cili është ndërtuar posaçërisht nga INSTAT-i. Ky formular jep informacion shtesë për qëllime statistikore. Formularët mbledhen në çdo zyrë kryesore të gjendjes civile në nivel rrethi dhe i dërgohen INSTAT-it, për përpunimin e të dhënave që ata përmbajnë.

B. Martesat

Të dhënat mbi martesat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Regjistrimi i martesave bëhet fillimisht në bashkinë ku ndodhet banesa ligjore (vendi ku personi është regjistruar në Regjistrin Themeltar), pastaj në regjistrin specifik dhe më pas në një formular i cili është ndërtuar posaçërisht nga INSTAT-i. Ky formular jep informacion shtesë për qëllime statistikore. Formularët

mblidhen në çdo zyrë kryesore të gjendjes civile në nivel rrethi dhe i dërgohen INSTAT-it, për përpunimin e të dhënave që ato përmbajnë.

C. Zgjidhjet e martesave

Të dhënat statistikore mbi zgjidhjet e martesave merren nga Zyra e Statistikës pranë Ministrisë së Drejtësisë. INSTAT publikon vetëm zgjidhjet e martesave sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë, sepse ato përfaqësojnë realisht divorcet e ndodhura në një vit të dhënë.

Të dhënat demografike, sidomos ato të migracionit, merren gjithashtu nga Censuset e popullsisë. Projeksionet e popullsisë si dhe statistika mbi migracionin në vitet në vazhdim do të bazohen në Census-Al 2011.

Objektivat strategjikë

- Përmirësimi dhe plotshmëria e mbledhjes së informacionit nga skedat demografike, probleme të cilat më parë kanë ndikuar negativisht në llogaritjet e ngjarjeve demografike siç janë: lindjet, vdekjet, lëvizjet e brendshme të popullsisë. Skedat mundësojnë llogaritjen e popullsisë që nga 1 Janari i çdo viti;
- Llogaritja e treguesve të qëndrueshëm në lidhje me lindjet dhe vdekjet;
- Llogaritja e treguesve të qëndrueshëm në lidhje me martesat dhe divorcet;
- Përgatitja e publikimi i rezultateve kryesore të Census-Al 2011 dhe përlllogaritja e treguesve kryesorë demografikë sipas këtij censusi;
- Kryerja e punës përgatitore për analizat tematike, bazuar në rezultatet e Census-Al 2011;
- Sigurimi i një bashkëpunimi më të ngushtë me institucionet përkatëse, për mbledhjen e informacionit në mënyrë periodike dhe të vazhdueshme;

Aktivitete zbatuese

Në kuadër të projektit për informatizimin e zyrave të gjendjes civile në Republikën e Shqipërisë, do të bëhet i mundur transferimi i të dhënave mbi statistikat vitale *online*, ku të gjitha zyrat do të integrohen në një rrjet të kompjuterizuar. Qëllimi është gjetja e një formati që i përshtatet të gjithë institucioneve të cilët interesohen potencialisht për të dhënat që ai përmban. Kjo praktikë e mbledhjes së të dhënave do të sigurojë një cilësi, shpejtësi dhe disponibilitet më të lartë të të dhënave. Gjithashtu do të bëjë të mundur shmangien e disa problemeve lidhur me cilësinë e të dhënave të lindjeve dhe vdekjeve jo vetëm me mos raportimin e disa rretheve, por gjithashtu edhe me plotshmërinë e informacionit për këto evente.

Po kështu, kjo praktikë e mbledhjes së të dhënave do të bëjë të mundur llogaritjen e statistikave vitale dhe të popullsisë në kohë reale dhe me një cilësi të lartë.

- Zhvillimi i takimeve të herëpashershme me Ministrinë e Drejtësisë për një bashkëpunim më të ngushtë në mënyrë që të arrihet mbledhja e të dhënave në mënyrë periodike, të vazhdueshme dhe sipas formatit të përshtatshëm.
- Shfrytëzimi i të gjithë burimeve të mundshëm, për të siguruar prodhimin e treguesve sipas definicioneve dhe kërkesave të Eurostat-it.

Rezultatet e pritshme

Një përmbledhje e kategorisë së treguesve demografikë që prodhohen çdo vit janë:

- ✓ Llogaritja e popullsisë më 1 Janar dhe mesatare vjetore sipas grupmoshës, gjinisë dhe qarqeve;
- ✓ Statistika të plota mbi eventet demografike: lindje, vdekje;
- ✓ Statistika të plota mbi martesat dhe divorcet;
- ✓ Sigurim informacioni mbi lëvizjet e brendshme të popullsisë;

Burimi i informacionit

Burimi i informacionit sigurohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe nga MD. Megjithatë vlen të përmendet se është INSTAT ai që bën përpunimin e mëtejshëm të të dhënave si dhe përlllogaritjen e treguesve kryesorë. Një burim i rëndësishëm informacioni për llogaritjen e treguesve kryesorë demografikë, arsimor, ekonomik dhe shëndetësor është Census-Al 2011.

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Tregues të Popullsisë	2011	2012	2013	2014	2015
Tregues të Lindshmërisë	2011	2012	2013	2014	2015
Tregues të vdekshmërisë	2011	2012	2013	2014	2015
Tregues të Martesave	2011	2012	2013	2014	2015

1.01.01.02 Censuset

Përshkrimi i situatës aktuale

Censusi i Popullsisë dhe Banesave është numërimi i plotë i të gjithë individëve, njësisive ekonomike familjare dhe banesave, destinacioni i të cilave është

banimi. Ky është një vrojtim tejet kompleks, i cili siguron një informacion të rëndësishëm jo vetëm për politikbërësit, por edhe për komunitetin e gjerë të përdoruesve dhe të biznesit.

Qëllimi kryesor i Censurit të Popullsisë dhe Banesave është të japë një panoramë aktuale dhe të saktë të realitetit demografik, ekonomik dhe social në vend. Censusi jep një fotografim të momentit mbi gjendjen sociale dhe nivelin e jetesës së popullsisë në një moment të dhënë (Momenti kritik i Censurit).

Në nivel kombëtar, popullsia është e rëndësishme për planifikimin dhe shpërndarjen e institucioneve të kujdesit shëndetësor, arsimit, punësimit, etj. Rezultatet në bazë rajonesh janë të domosdoshme për përcaktimin e politikave rajonale, por më e rëndësishmja është shpërndarja e popullsisë dhe njohja e karakteristikave të saj në nivel lokal. Kjo shpërndarje ndihmon në njohjen më të mirë të nevojave për shkolla, spitale, zonat ku papunësia mund të jetë më e madhe, përcaktimin e vendeve për qëllime biznesi, etj.

Censusi është gjithashtu një mënyrë mjaft e mirë për të njohur dhe matur lëvizjet e brendshme të popullsisë (migracionin e brendshëm). Krahasimi i rezultateve të dy regjistrimeve të fundit, duke pasur parasysh edhe shtesën natyrore të popullsisë për këto dhjetë vjet, na ndihmon dhe na jep mundësi për të përlllogaritur numrin e personave që kanë lëvizur jashtë Shqipërisë (migracionin neto).

Censusi i fundit i Popullsisë dhe Banesave u krye më 1 Tetor 2011 (Census-Al 2011), dhjetë vjet pas regjistrimit të vitit 2001, bazuar në ligjin nr.8669, datë26.10.2000 ‘Për Censusin e Popullsisë dhe Banesave’, i ndryshuar.

Census-Al 2011 u bazua tërësisht në rekomandimet e Eurostat dhe UN¹, si rrjedhim, rezultatet e tij do të jenë plotësisht të krahasueshme me ato të vendeve të tjera. Për implementimin e tij u përdor metoda tradicionale e mbledhjes së informacionit “derë më derë” me anketues. Ai u bazua plotësisht në deklarin e lirë të individëve dhe përfshiu 100% të çështjeve “core topics” të rekomanduara nga Eurostat dhe UN, si dhe rreth 65% të atyre “noncore topics”. Gjatë procesit u përdor koncepti i “popullsisë së hapur” dhe “Popullsi me vendbanim të zakonshëm” si dhe koncepti “njësi ekonomike familjare”, i cili ishte i ndryshëm nga ai i familjes.

Census-Al 2011 do të jetë pikënisja për ndërtimin e një regjistri statistikor të popullsisë dhe do të krijojë mundësinë që censusi i ardhshëm të bazohet në përdorimin e regjistrit të popullsisë. Kjo do të krijojë mundësinë për të pasur gjithmonë një popullsi të përditësuar jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe në nivele më të vogla administrative (komuna, bashki). Për herë të parë censusi u bazua

1

http://www.unece.org/fileadmin/DAM/stats/publications/CES_2010_Census_Recommendations_English.pdf

tërësisht në harta dixhitale (GIS), si dhe hedhja e të dhënave u krye me anë të skanerave optikë.

Objektivat strategjikë

- Të ndihmojë Qeverinë për planifikimin dhe alokimin e burimeve si dhe të drejtojë politikën sipas shpërndarjes dhe përbërjes së popullsisë;
- Sigurimi i numrit të popullsisë rezidente sipas karakteristikave bazë demografike, ekonomike dhe sociale në nivel kombëtar dhe sipas ndarjeve më të ulta administrative;
- Sigurimi i statistikave sipas rekomandimeve të UN dhe Eurostat-it, të cilat do të jenë të krahasueshme me vendet e tjera Evropiane;
- Ofrimi i informacionit i cili do të shërbejë gjithashtu si një strukturë bazë informacioni mbi të cilin do të ngrihet struktura e një kampioni;
- Ndërtimi i një baze të dhënash egzostive e cila do të shërbejë gjithashtu për të dhënë përgjigje më të mirë kundrejt nevojave të përdoruesve;
- Ofrimi i informacionit bazë institucioneve të tjera qendrore në mënyrë që të asistohen në përcaktimin e strategjive të tyre.

Aktivitetet zbatuese

Në kuadër të Census-AL 2011 po ndërmerren aktivitetet:

- Përgatitja e rezultateve finale të census;
- Përgatitjet për analizat tematike.

Rezultate të pritshme

- ✓ Matja e popullsisë banuese në vend, sipas karakteristikave të tyre demografike, sociale dhe ekonomike;
- ✓ Matja e numrit të Njësive Ekonomike Familjare;
- ✓ Përlllogaritja e treguesve demografikë, arsimorë, shëndetësorë dhe ekonomikë;
- ✓ Bazë e krijuar për ndërtimin e projeksioneve të popullsisë.

Burimi i informacionit

Rezultatet përfundimtare të Census-AL 2011

1.01.01.03 Projeksionet

Përshkrimi i situatës aktuale

Projeksionet e popullsisë janë llogaritje që tregojnë zhvillimin e ardhshëm të një popullsie duke marrë për bazë disa hipoteza të bëra për prirjet e ardhme të lindshmërisë, vdekshmërisë dhe migracionit.

Projeksionet janë llogaritje që shoqërohen me pasiguri, prandaj, për të evidentuar këtë, ato shoqërohen me disa hipoteza për normat demografike të lindshmërisë, vdekshmërisë si dhe migracionit. Zakonisht projeksionet shoqërohen me hipotezën e ulët, të mesme si dhe të lartë për këto norma. Për të arritur në këto hipoteza kërkohet një studim i thellë i trendeve të shkuara të vendit për këta komponentë, por dhe një studim i thelluar i vendeve që i ngjasojnë më shumë vendit tonë në këto tregues demografikë.

INSTAT do të përdorë Census-Al 2011 si popullsi bazë për të llogaritur projeksionet e popullsisë për 20 vitet e ardhshme. Projeksionet do të llogariten për grupmosha njishe, femra dhe meshkuj. Do të shihet mundësia e llogaritjes së tyre në nivel prefekturë. Kjo do të varet edhe nga cilësia e të dhënave historike për lindjet, vdekjet dhe migracionit në këtë nivel.

Objektivat strategjikë

Projeksionet e popullsisë do të parashikojnë ndryshimet e popullsisë duke marrë si pikënisje numrin e popullsisë nga Census-Al 2011 dhe duke u bazuar në disa hipoteza bazë (duke patur parasysh lindjet, vdekjet dhe migracionin). Objektivat strategjikë në lidhje me këtë modul janë:

- Llogaritja e projeksioneve për 20 vitet e ardhshme 2011-2031;
- Llogaritja e projeksioneve të popullsisë në nivel vendi, meshkuj dhe femra në grupmosha njishe. Kjo do të bëhet në tre variante. Në variantin më të mirë të mundshëm si dhe do të shoqërohet me variantin i ulët dhe i lartë për të shoqëruar pasiguritë më të cilat lidhen këto llogaritje.
- Do të shihet mundësia e llogaritjes së projeksioneve në Nivel NUTS 2. Kjo do të varet dhe nga cilësia e të statistikave vitale në këtë nivel si dhe mundësia e llogaritjes së migracionit të brendshëm dhe të jashtëm.
- Do të shihet mundësia e llogaritjes së projeksioneve në Nivel NUTS 3 (Nivel Qarku). Kjo do të varet dhe nga cilësia e të statistikave vitale në këtë nivel si dhe mundësia e llogaritjes së migracionit të brendshëm dhe të jashtëm.

Aktivitetet zbatuese

Aktivitetet për arritjen e objektivave strategjikë do të jenë si më poshtë:

- Studimi i trendeve të kaluara mbi fenomenet demografike që janë lindjet, vdekjet, migracioni i brendshëm si dhe migracioni i jashtëm;

- Kryerja e një analize të thellë e këtyre trendeve jo vetëm brenda vendit, por kjo analizë duhet të shoqërohet me studimin e këtyre fenomeneve demografikë për vendet në rajon. Në këtë mënyrë do të mundësohet gjetja e një modeli që i përshtatet sjelljes që do të ketë popullsia e vendit tonë;
- Analiza e migracionit si një nga elementët më të vështirë në llogaritjen e projeksioneve të popullsisë. Do të kërkohen të dhënat për emigracionin dhe në vendet fqinjë ose vendet kryesore destinacion të emigrantëve shqiptarë, për të patur një ide më të qartë të shkallës së emigracionit në Shqipëri. Kjo mundëson llogaritjen sa më të saktë të projeksioneve të Shqipërisë.

Rezultate të pritshme

- ✓ Ndërtimi i hipotezave për lindshmërinë, vdekshmërinë dhe migracionin

Burimet e informacionit

Për llogaritjen në mënyrë sa më të saktë të Projeksioneve të popullsisë kërkohen disa burime të dhënash. Më të rëndësishmet janë burimet nga Census-Al 2011 si dhe statistikat vitale në vite për lindjet, vdekjet si dhe për migracionin e brendshëm e të jashtëm.

Migracioni, si një nga komponentët e projeksioneve, i bën ato shumë të ndjeshme nga nivelet e supozuara të ardhme të tij. Për statistikat e emigracionit kërkohet një hulumtim i këtyre vlerave sidomos për vendet kryesore destinacion për emigrantët shqiptarë. Të dhënat e migracionit mbeten problematike dhe kjo mund të ndikojë dhe në cilësinë e projeksioneve.

Gjithashtu, llogaritja e projeksioneve në nivel NUTS 2 dhe prefekturë kërkon të dhëna të plota dhe të sakta për të gjithë komponentët demografikë (lindjet, vdekjet, migracioni i brendshëm dhe migracioni i jashtëm).

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Projeksionet e Popullsisë		x	x		
Analiza e Migracionit		x	x		
Analiza e lindshmërisë dhe vdekshmërisë		x	x		

Moduli 1.01.02 Migracioni dhe Azilkërkesit

Përshkrimi i situatës aktuale

Objektivi i këtij moduli ka të bëjë me zhvillimin dhe prodhimin e statistikave cilësore në lidhje me migracionin.

Duhet thënë se statistikat lidhur me migracionin vazhdojnë të mbeten problem, ato nuk janë të plota dhe të zhvilluara mirë, nëse i referohemi standardeve ndërkombëtare.

Burimet kryesore të të dhënave për të analizuar vlerësimin e migracionit kanë qenë informacioni i mbledhur gjatë Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave 2001 si dhe të dhënat e Anketës së Matjes së Nivelit të Jetesës 2002, 2005, 2008.

Për më tej, një burim informacioni për këtë çështje do të jenë të dhënat e mbledhura nga Census-Al 2011, meqenëse pyetësi në përmbajtje të tij kishte një modul të veçantë për migracionin, i hartuar duke u bazuar në rekomandimet e UN dhe Eurostat. Referuar migracionit të brendshëm, të dhënat do të merren *online* nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, në kuadër të marrëveshjes së nënshkruar nga INSTAT-i me këtë institucion. Në këtë mënyrë do të mund të sigurojmë dhëna më cilësore dhe të plota mbi statistikat e popullsisë dhe lëvizjet e brendshme të popullsisë.

Sa i përket migracionit të jashtëm, si burim informacioni do të jetë informacioni i mbledhur nga vendet destinacion për emigrantët shqiptarë, sipas një marrëveshjeje bashkëpunimi të ndërsjellë. Po ashtu, për këtë çështje është menduar dhe po vazhdojnë diskutimet për përfshirjen e një moduli të veçantë për migracionin në anketën e forcës së punës (LFS- 3 mujore).

Ndërkohë që për azil kërkuesit dhe për të huajt që marrin leje qëndrimi, të dhënat i siguron MB.

Objektivat strategjikë

Objekivi kryesor strategjik është krijimi i bazës së të dhënave për migracionin. Për të mundësuar ngritjen e kësaj baze është shumë e rëndësishme së pari të mundësohet një bashkëpunim i ngushtë dhe i ndërsjellë jo vetëm me institucionet vendase, por edhe me institucionet statistikore ndërkombëtare. Gjithashtu, duhet të shfrytëzohen të gjitha burimet aktuale për llogaritjen e indikatorëve në këtë fushë, si dhe duhet të shqyrtohet mundësia e pasurimit me indikatorë të rinj në përputhje me definicionet ndërkombëtare.

Census-Al 2011 do të përbëjë bazën e këtyre statistikave dhe kjo referuar kryesisht lëvizjeve të brendshme të popullsisë dhe migrantëve të kthyer, ndërkohë që duke përdorur metoda indirekte do të mundësohet një vlerësim i numrit të emigrantëve.

Aktivitetet zbatuese

- Ngritja e një baze statistikave migracioni bazuar në të dhënat e mbledhura nga Census-Al 2011;
- Harmonizimi i definicioneve statistikore me ato të Eurostat;
- Përlllogaritja në mënyrë indirekte e numrit të emigrantëve;

- Rritja e bashkëpunimit me institucionet përkatëse për mundësimin e të dhënave mbi azil-kërkuesit dhe të huajt që banojnë në Shqipëri;
- Rritja e bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare, për shkëmbim informacioni statistikor në lidhje me shqiptarët që jetojnë në këto vende, duke iu siguruar edhe atyre informacion për shtetasit e huaj që banojnë në Shqipëri.

Rezultatet e pritshme

Koeficientët që do të përlogariten në kuadër të këtij moduli janë:

- ✓ Popullsia rezidente
- ✓ Numri i të huajve që banojnë në Shqipëri
- ✓ Koeficienti neto i migracionit
- ✓ Azilkërkuesit sipas vendeve të origjinës
- ✓ Azilkërkuesit sipas arsyes
- ✓ Të huajt që punojnë në Shqipëri sipas degëve të ekonomisë dhe profesionit

Burimi i informacionit

- Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, të dhënat mbi lëvizjet e brendshme të popullsisë;
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, të dhëna mbi azil-kërkuesit dhe personat e huaj që jetojnë në Shqipëri;
- Statistikat e emigracionit të vendeve kryesore destinacion për shqiptarët;
- Census-Al 2011 si dhe anketat e ndërmarra pranë INSTAT.

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Të dhëna mbi të huajt që banojnë në Shqipëri	2011	2012	2013	2014	2015
Të dhëna mbi azilkërkuesit	2011	2012	2013	2014	2015
Të dhëna mbi emigracionin	2011	2012	2013	2014	2015

Tema 1.02 Tregu i Punës

Përshkrimi

Statistikat e Tregut të Punës sigurojnë përshkrime strukturore të tregut të punës bazuar në informacionin administrativ tremujor dhe vlerësimet vjetore nga Anketa për Forcën e Punës. Fokusi është kryesisht në anën e ofertës së tregut të punës (pjesëmarrjen në dimensione të ndryshme të tregut të punës, forcën e punës dhe personat joaktivë). Aktualisht statistikat e tregut të punës mbulojnë territorin

shqiptar dhe ofrojnë një mjet të rëndësishëm për vendimmarrësit për të hartuar dhe monitoruar politikat ekonomike dhe të punësimit. Rezultatet e marra nga të dhënat e Anketave të Forcës së Punës për vitet 2007-2009 janë publikuar, ndërkohë që për vitin 2010 dhe 2011 rezultatet mbi situatën e tregut të punës do të publikohen në vitin 2012, pasi të merren rezultatet përfundimtare të Census-Al 2011. Ndërsa janë publikuar rregullisht në faqen e web-it të INSTAT (www.instat.gov.al) treguesit kryesorë të tregut të punës të cilat janë llogaritur bazuar në të dhënat administrative.

Prioritetet

Në periudhën afatmesme, fokusi është në përmirësimin e statistikave të punës në drejtim të mbulimit dhe cilësisë nëpërmjet: (i) përshtatjes dhe përforcimit të Anketës Tremujore të Forcave të Punës, në mënyrë që të mund të plotësohen më mirë kërkesat e përdoruesve për të dhëna të duhura dhe në kohë, (ii) përmirësimin të koherencës dhe integritimit të statistikave të punësimit; (iii) zhvillimit të mëtejshëm të treguesve strukturorë dhe treguesve bazë ekonomike për tregun e punës; (iv) kryerjen e anketës për matjen e kostos së punës.

Do të përpilohet një plan veprimi i detajuar për përmirësimin e cilësisë së të dhënave të mbledhura nëpërmjet anketës, si dhe do të plotësohen raportet e cilësisë së të dhënave të anketës sipas modelit të rekomanduar nga Eurostat-i. Një studim i avancuar do të kryhet për të analizuar të gjitha burimet e mundshme që përdoren aktualisht për tregun e punës. Zbatimi i NACE Rev.2 për Vrojtimin e Forcave të Punës do të bëhet në vitin 2012. Një përpjekje e veçantë do të bëhet për hartimin e treguesve të rinj dhe të rëndësishëm në mënyrë që të sigurohet një matje më e mirë e performancës së tregut të punës. Një bazë të dhënash e dokumentuar e Anketës për Përdorimin e Kohës 2010-2011 në një format të kuptueshëm dhe të aksesueshëm për qëllim analizash nga përdoruesit akademikë dhe qeveria do të ngrihet në 2012.

Moduli 1.02.01 Punësimi dhe papunësia

Përshkrimi i situatës aktuale

Për prodhimin e statistikave të tregut të punës në Shqipëri, INSTAT-i përdor dy burime informacioni: Burimet administrative dhe Anketën e Forcave të Punës që kryhet nga INSTAT-i që nga viti 2007.

Burimet administrative

Të dhënat e mbledhura nga burimet administrative publikohen në INSTAT me periodicitet tremujor. Këto të dhëna mbulojnë punësimin në sektorin shtetëror,

punësimin në sektorin privat jo-bujqësor dhe papunësinë e regjistruar. Të dhënat mbi punësimin në sektorin shtetëror mblidhen mbi bazën e programit statistikor kombëtar nga Instituti i Statistikës. Të dhënat administrative mbi punësimin në sektorin privat jo-bujqësor dhe të papunët e regjistruar mblidhen nga MPCSShB.

Për punësimin në sektorin privat bujqësor janë përdorur estimimet e marra nëpërmjet anketave pranë familjeve (deri në vitin 2007 është përdorur vlerësimi i marrë nga AMNJ 2005).

Anketa e Forcës së Punës (AFP)

Është burimi i dytë i informacionit që përdor INSTAT për punësimin në Shqipëri. Kjo Anketë ka si bazë familjen dhe të dhënat mblidhen nëpërmjet intervistimit të drejtpërdrejtë të të gjithë individëve 15 vjeç e lart në familjet të cilave u ka rënë shorti për t'u intervistuar. Anketa për forcën e punës është një anketë që kryhet në nivel kombëtar, dhe mbulon gjithë territorin e Shqipërisë. Anketa është kryer në katër vitet e kaluara, respektivisht në 2007, 2008, 2009 dhe 2010 me periodicitet vjetor.

Nevojat në rritje për tregues më të përditësuar për tregun e punës, dhe informacion sa më real mbi shkallën e kërkimit aktiv të punës, mënyrat e kërkimit dhe shkallën e inaktivitetit në tregun e punës (të cilat kushtëzojnë direkt hartimin e politikave të duhura mbi punësimin dhe trajnimin e të papunëve apo riintegrimin në tregun e punës të personave ekonomikisht jo aktivë), bëri që INSTAT në vitin 2011 të fillojë anketën e vazhdueshme të forcave të punës, rezultatet e së cilës do të publikohen me periodicitet tremujor. Anketa e vazhdueshme e forcave të punës është anketë panel ku një familje intervistohet në pesë tremujorë të njëpasnjëshëm. Anketimi kryhet me intervistë të drejtpërdrejtë dhe në vend të pyetësorëve letër që u përdorën në 4 anketat e para vjetore, po përdoren Asistenti Personal Dixhital (PDA). Hedhja e të dhënave bëhet direkt në PDA gjatë intervistimit, ndërsa përpunimi i të dhënave bëhet në SPSS.

Nëpërmjet kryerjes në vijimësi të AFP synohet ngritja e një sistemi statistikor të qëndrueshëm të statistikave të tregut të punës sipas standardeve të Eurostat-it. Anketa mbledh të dhëna bazë mbi karakteristikat demografike të anëtarëve të familjeve dhe të dhëna të detajuara mbi të punësuarit dhe të papunët. Mbi bazën e të dhënave të mbledhura arrihet të bëhet një vlerësim sasior dhe dinamik i zhvillimeve të tregut të punës, përcaktohet pjesëmarrja në tregun e punës e personave në moshë 15 vjeç e lart, niveli i punësimit, punësimi sipas aktiviteteve ekonomike, punësimi sipas gjinisë dhe grupmoshave, shkalla e papunësisë, pjesëmarrja e grave në tregun e punës etj. AFP kryhet në përputhje me rekomandimet metodologjike të Zyrës Ndërkombëtare të Punës (ILO), të adoptuara në Konferencën e 13-të Ndërkombëtare të Statisticienëve të Punës dhe me rekomandimet e EUROSTAT-it.

AFP kryhet mbi një kampion prej 5040 familjesh gjithsej. Është një kampion dy-hapësh, me stratifikim. Stratifikimi bazohet në dy grupe studimi kryesore: qytet/fshat dhe 12 prefektura me një total prej 24 stratash. Në hapin e parë zgjidhen PSU-të me metodën PPS-sistematike, ku si madhësi matjeje përdoret numri total i familjeve. Në hapin e dytë, një numër i njëjtë familjesh zgjidhet brenda çdo PSU-je.

Gjatë përpunimit të të dhënave, aplikohen klasifikimet ndërkombëtare ISCO-88 deri në vitin 2009, NACE Rev.1 deri në vitin 2010. Në vitin 2012 do të përdoren për profesionet nomenklatura ISCO-08 dhe për aktivitetet ekonomike NACE Rev2.

Objektivat strategjikë

Objektivi kryesor i statistikave të tregut të punës është sigurimi i përshkrimeve të sakta mbi madhësinë, strukturën dhe karakteristikat e pjesëmarrësve të ndryshëm në tregun e punës. Statistikat e tregut të punës mbulojnë aspekte afatshkurtra dhe strukturore të tregut të punës, si për anën e ofertës ashtu dhe për anën e kërkesës së tregut të punës, në terma monetarë dhe jomonetarë. Këto aspekte përfshijnë: Punësimin dhe papunësinë – AFP-në dhe burimet administrative.

Objektivi strategjik do të sigurohet nëpërmjet harmonizimit të metodologjisë të anketës së vazhdueshme të forcave të punës me rekomandimet dhe rregulloret e Eurostat-it lidhur me saktësinë e të dhënave të mbledhura dhe me përpunimin në kohë reale të tyre, si dhe lidhur me madhësinë e zgjedhjes dhe llogaritjen e treguesve të cilësisë së anketës.

Aktivitetet zbatuese

- Në kuadër të hartimit të projekt-programit pesëvjeçar të statistikave zyrtare, në mënyrë që sistemi statistikor të prodhojë një gamë sa më të gjerë treguesish për të kënaqur interesat e sa më shumë përdoruesve, do të zhvillohen takime me grupet e interesit, do të merren opinione si dhe do të hartohen parashikimet buxhetore përkatëse për kryerjen e aktiviteteve;
- Hartimi i memorandumeve të bashkëpunimit mes institucioneve të përfshira në programin pesëvjeçar të statistikave zyrtare për format dhe afatet e shkëmbimit të të dhënave statistikore;
- Zhvillimi i trajnimeve të personelit të INSTAT-it si dhe agjencive të tjera statistikore;
- Përmirësimi i përlllogaritjes së treguesve të tregut të punës që masin punësimin informal dhe punësimin në sektorët informalë të ekonomisë;
- Kryerja e një studimi të plotë për dinamikën e zhvillimeve të tregut të punës në Shqipëri bazuar në rezultatet e Anketave (vjetore) të Forcave të Punës 2007-2011 dhe në të dhënat e Census-Al 2011;

- Analiza e të gjitha burimeve të të dhënave statistikore për punësimin dhe hartimi i pasqyrave statistikore të detajuara në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha institucionet publike dhe private që mbledhin të dhëna për punësimin.

Periodiciteti i aktiviteteve statistikore:

Aktiviteti statistikor	2012	2013	2014	2015	2016
Anketa tremujore e forcave të punës	x	x	x	x	x

Rezultatet e pritshme

- ✓ Konsolidimi i anketës tremujore të forcave të punës lidhur me cilësinë e të dhënave të mbledhura;
- ✓ Zhvillimi i analizave longitudinale dhe *cross-section* i të dhënave të anketës së forcave të punës;
- ✓ Përditësimi i *sample*-it të anketës tremujore të forcave të punës me bazën e re të të dhënave nga Census-Al 2011 dhe rritja e *sample*-it për të marrë statistika për tregun e punës sa më të besueshme dhe sa më përfaqësuese në nivel NUT 2 dhe 3.
- ✓ Përshtatja-me-qëllimin e statistikave të tregut të punës, që ndryshe do të thotë një cilësi e lartë statistikore e të dhënave (aksesin dhe afatet kohore të shpërndarjes së të dhënave, saktësinë, koherencën, krahasueshmërinë dhe përkatësinë).

Burimi i informacionit

Burimet kryesore të informacionit për punësimin dhe për papunësinë janë: burimet administrative dhe anketat pranë familjeve.

- Burimet administrative:
 - Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
 - Shërbimi Kombëtar i Punësimit
 - Drejtoria e Përgjithshme e Tatim-taksave
- Anketat pranë Familjeve:
 - Anketa Tremujore e Forcave të Punës

Burimet njerëzore

Me burimet njerëzore që ka aktualisht sektori i statistikave të tregut të punës mund të mbulohen të gjitha aktivitetet që lidhen me zbatimin e anketës së forcave të punës dhe me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave administrative për punësimin dhe papunësinë.

Anketa Tremujore e Forcave të Punës							
Personel	2012	2013	2014	2015	2016	Frekuenca	Periudha
Anketues	50	50	50	50	50	Tremujore	Janar-Dhjetor

Burimet financiare

Këto aktivitete statistikore janë të mbuluara nga buxheti i shtetit. Për anketën e forcave të punës janë të punësuar 45 anketues në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Moduli 1.02.02 Pagat dhe kostot e punës

Përshkrimi i situatës aktuale

Të dhënat për pagat i referohen pagës minimale zyrtare, pagës mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë.

Të dhënat mbi pagat në sektorin shtetëror mblidhen nga INSTAT nëpërmjet burimeve administrative me periodicitet tremujor. Këto të dhëna japin informacion të hollësishëm për çdo grup-profesionesh sipas Nomenklaturës Ndërkombëtare të Profesioneve (ISCO-08). Çdo fund viti, të dhënat për pagën mesatare për një të punësuar në sektorin shtetëror, jepen të detajuara edhe për çdo aktivitet ekonomik duke u bazuar në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike (NACE).

Për pagat në sektorin privat është përdorur informacioni i marrë nga Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve. Kjo anketë kryhet çdo vit dhe mbulon aktivitetet e Industrisë, Transportit e Telekomunikacionit, Tregtisë dhe disa sektorë të Shërbimeve.

Përdorimi i këtyre burimeve është bërë pasi aktualisht në Shqipëri akoma nuk ka një vrojtim që i dedikohet tërësisht pagave dhe fitimeve.

Anketa mbi Kostot e Punës mbledh një informacion të detajuar mbi komponentët e ndryshëm të kostos së punës. Përveç komponentëve të pagave (p.sh. shpërblimet, bonuset, pagesat për ditët që nuk ka punuar, si dhe pagat dhe rrogat në natyrë), përfshihen dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të paguara nga punëdhënësi. Gjithashtu jepet informacion dhe për shpenzimet e trajnimit profesional dhe taksat dhe subvencionet në lidhje me punësimin e personelit. Në të njëjtën kohë, anketa merr informacion mbi numrin e punësuarve me kohë të plotë dhe numrin e orëve të punës të paguara. Aktualisht në Shqipëri anketa mbi kostot e punës nuk është kryer ndonjëherë.

Objektivat strategjikë

Qëllimi kryesor i mbledhjes së informacionit mbi pagat është vrojtimi i nivelit, shpërndarjes dhe ndryshimit të pagave përgjatë një viti. Këto statistika ofrojnë një mundësi për të krahasuar pagat në industri të ndryshme dhe për grup-profesione të ndryshme. Rritja reale e pagave dhe hendeku gjinor i pagave janë gjithashtu të një rëndësie të veçantë për monitorimin e treguesve ekonomikë dhe që përdoren nga politikë-bërësit, punëdhënësit dhe sindikatat për të vlerësuar kushtet e kërkesës dhe të ofertës për punë.

Anketa e kostove të punës ka si objektiv kryesor të sigurojë informacion mbi koston mesatare mujore të punës për punonjës, të paguara nga punëdhënësi dhe për një orë efektive të punuar, dhe për kohën që nuk ka punuar.

Aktivitetet zbatuese

- Rishikimi i metodologjisë së përdorur për llogaritjen e pagës mesatare mujore në sektorin privat dhe shtetëror dhe koordinimi mes burimeve që mbledhin informacion për pagat;
- Përgatitja e metodologjisë dhe e pyetësorëve për kryerjen e anketës pilot për kostot e punës gjatë vitit 2012;
- Përgatitja e raportit vlerësues për anketën pilot të kostove të punës;
- Kryerja e anketës së plotë në vitin 2013 ku viti referues do të jetë viti 2012 siç rekomandohet nga Eurostat-i.

Periodiciteti i aktiviteve statistikore:

Aktiviteti statistikor	2012	2013	2014	2015	2016
Anketa pilot e kostove të punës	x	-	-	-	-
Anketa e kostove të punës	-	x	-	-	-
Tregues administrativë mbi pagat në sektorin shtetëror	x	x	x	x	x

Rezultatet e pritshme

- ✓ Kostot mesatare mujore të punës;
- ✓ Kostot mesatare të punës për një orë pune;
- ✓ Struktura e kostove të punës (paga, rroga, kosto të tjera të punës).

Burimi i informacionit

Burimet kryesore të informacionit për pagat dhe kostot e punës janë: burimet administrative dhe anketat pranë ndërmarrjeve.

1. Burimet administrative:

- a) Drejtoria e Përgjithshme e Tatim-taksave
2. Anketat pranë Ndërmarrjeve:
- a) Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve Ekonomike
 - b) Anketa e Kostove të Punës

Burimet njerëzore

Me burimet njerëzore që ka aktualisht sektori i statistikave të tregut të punës nuk mund të mbulohen të gjitha aktivitetet që lidhen me prodhimin e statistikave të për kostot e punës.

Anketa Pilot / Anketa e Kostove të Punës							
Personel	2012	2013	2014	2015	2016	Frekuenca	Periudha
Anketues	20	75	0	0	0	Një herë në 4 vjet	Mars - Qershor
Operatorë	1	2	0	0	0	Një herë në 4 vjet	Mars - Qershor

Moduli 1.02.04 Përdorimi i kohës dhe balanca e punës me jetën familjare

Përshkrimi i situatës aktuale

Qëllimi i anketës për përdorimin e kohës (APK) është të sigurojë informacion të detajuar se si individët shpenzojnë kohën e tyre. Ai mundëson dhënien e informacionit mbi punën e papaguar, aktivitetet jashtë vendit të punës dhe çështjet që lidhen me përshtatjen e punës dhe jetës familjare.

INSTAT-i e kreu për herë të parë anketën për përdorimin e kohës në nivel kombëtar në vitin 2010-2011. Qëllimi kryesor i AKP-së është të japë vlerësime në nivel kombëtar se si njerëzit shpenzojnë kohën e tyre; të krijojë dhe vendosë një traditë të re në kryerjen e vrojtimeve për përdorimin e kohës në nivel kombëtar në një perspektivë afatgjatë; të ndërtojë një grup treguesish standard në mënyrë që të vlerësojë se si shqiptarët shpenzojnë kohën e tyre.

Objektivi strategjik

Objektivi kryesor i anketës së përdorimit të kohës është të sigurojë statistika mbi mënyrën se njerëzit e shpërndajnë kohën në aktivitete të ndryshme.

Aktivitetet zbatuese

Meqë anketat për përdorimin e kohës kryhen me një periodicitet 10-vjeçar, INSTAT gjatë tre viteve të ardhshme nuk do të kryejë një anketë të re. Aktivitetet që do të kryhen lidhur me anketën e përdorimit të kohës janë:

- Krijimi i *metadata*-ve për anketën e përdorimit të kohës;
- Krijimi i një bazë të dhënash të dokumentuar në një format të aksesueshëm për gjenerimin e tabelave me rezultate të anketës sipas nevojave të përdoruesve.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Përmirësimi i cilësisë së statistikave sociale lidhur me barazinë gjinore.

Burimet njerëzore

Me burimet njerëzore që ka aktualisht sektori i statistikave të tregut të punës mund të mbulohen të gjitha aktivitetet që lidhen me prodhimin e statistikave të përdorimit të kohës.

Tema 1.03 Arsimi dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës

Përshkrimi

Kjo temë ka të bëjë me prodhimin e informacionit statistikor për arsimin. Burimi i informacionit janë të dhënat e marra nga MASH sipas Programit të Statistikave Zyrtare. Indikatorët prodhohen për të gjithë nivelet e arsimit, për arsimin publik dhe atë privat. Në llogaritje përfshihen fëmijë, nxënës dhe studentë të regjistruar dhe të diplomuar. Indikatorët llogariten gjithashtu për institucionet arsimore dhe stafin mësimdhënës.

Prioritetet

Prioriteti kryesor është përmirësimi i vazhdueshëm i procesit të prodhimit të statistikave dhe sigurimi i cilësisë së tyre duke siguruar përshtatshmërinë, krahasueshmërinë, koherencën dhe ndjekjen e afateve për botimin e statistikave të arsimit. Objektivi për tu përmbushur mbetet përmirësimi i të dhënave dhe prodhimi i treguesve për arsimin privat, sikurse dhe atë publik. Rëndësi do t'i kushtohet në mënyrë të veçantë marrjes së të dhënave për arsimin e lartë sipas procesit të Bolonjës.

Moduli 1.03.01 Statistikat e arsimit

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT i prodhon statistikat e arsimit bazuar në Programin e Statistikave Zyrtare. Në këtë Program përcaktohet mënyra e përfimit të të dhënave për arsimin në vend sipas viteve shkollore, me burim të dhënat e marra nga MASH.

Të dhënat mbledhen nga institucionet arsimore të të gjitha niveleve dhe formës së pronësisë publike dhe jo publike, që nga kopshtet deri te universitetet.

Llogaritja e treguesve statistikorë bëhet për të gjithë nivelet e arsimit për fëmijë, nxënës e studentë, si edhe për stafin mësimdhënës.

Treguesit llogariten për të regjistruarit me të gjitha karakteristikat që i shoqërojnë, si: gjinia, mosha, vendbanimi, në sistemin me kohë të plotë ose jo të plotë, etj., për nxënës dhe studentë të diplomuar, sipas gjinisë, shkollave dhe universiteteve (publike ose private), sipas fakulteteve, degëve dhe fushave të studimit etj.; për stafin mësimdhënës në institucionet arsimore të të gjitha niveleve, për gjininë, nivelin arsimor të tyre, sipas ndarjeve qytet e fshat, në sistemin me kohë të plotë ose të pjesshëm, stafin efektiv dhe jo efektiv në universitete, për tituj dhe grada shkencore të marra prej tyre, etj.; për të gjitha institucionet arsimore që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë vendin sipas shkollave dhe universiteteve (publike ose private), sipas fakulteteve, degëve të studimit etj.

Procesi i mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave statistikore të arsimit kryhet sipas klasifikimit ndërkombëtar standard të arsimit ISCED-97.

Universitetet shqiptare kanë aplikuar pothuajse plotësisht programin e studimeve sipas procesit të Bolonjës, gjë që është duke u reflektuar në vazhdim edhe në statistikat e tyre.

Vrojtimet që kryhen nga INSTAT mbi matjen e nivelit të jetesës dhe mbi forcat e punës përmbajnë edhe pyetje rreth fushës së arsimit. Këto vrojtime bazohen mbi të dhënat nga deklaratat e individit dhe familjes.

Objektivat strategjikë

- Paraqitja sa më reale e realitetit arsimor nëpërmjet statistikave të fushës;
- Sigurimi i statistikave të krahasueshme në nivel ndërkombëtar;
- Përpunimi i të dhënave dhe llogaritja e indikatorëve sipas afateve të përcaktuara;
- Implementimi i klasifikimit të ri ISCED 2011 sipas rekomandimeve të Eurostat-it dhe përshtatja e tij për llogaritjen e treguesve;
- Përmirësimi i vazhdueshëm i informacionit në cilësi dhe në afate;
- Përmirësimi i vazhdueshëm i formave të raportimit, duke iu përshtatur ndryshimeve të sistemit arsimor;

- Bashkëpunimi me sektorët e tjerë, kryesisht me ato që kanë për burim anketat sociale për marrjen e informacionit alternativ ose shtesë dhe llogaritjen e treguesve të rinj;
- Shpërndarja e statistikave arsimore sipas afateve;
- Shtimi i indikatorëve të rinj për nivele të caktuara të arsimit.

Aktivitetet zbatuese

Informacioni që përftojmë bazohet në të dhënat administrative të marra nga regjistrat e institucioneve arsimore në vend. INSTAT-it i ofrohet ky informacion nga MASH në formën e tabelave për çdo nivel arsimit, për sektorin publik dhe privat, për të regjistruar, të diplomuar, staf mësimdhënës dhe institucione.

Përpjekje të përbashkëta dhe të vazhdueshme do të bëhen nga të dy institucionet tona, për përmirësime të cilësisë së informacionit të mbledhur.

Rezultate të pritshme

- ✓ Plotësimi i nevojave për statistika arsimore të sakta, koherente dhe të krahasueshme;
- ✓ Pasqyrimi i situatës arsimore në vend nëpërmjet treguesve statistikorë siç janë parashikuar në Programin Statistikor Zyrtar

Burimi i Informacionit

MASH, sektori i statistikës, është burimi i informacionit për të dhëna arsimore administrative. Nga INSTAT hartohen format e raportimit, si pjesë integrale e Programit Statistikor Zyrtar, të cilat kanë gjejnë miratimin e sektorit të statistikave në Ministri.

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Tregues të arsimit parashkollor	2011	2012	2013	2014	2015
Tregues të arsimit 9-vjeçar	2011	2012	2013	2014	2015
Tregues të arsimit të mesëm	2011	2012	2013	2014	2015
Tregues të arsimit të lartë	2011	2012	2013	2014	2015

Moduli 1.03.02 Statistikat e trajnimit profesional

Përshkrimi i situatës aktuale

Statistikat e arsimit nuk i mbulojnë trajnimet e mëtejshme të kryera në qendra publike ose private, qendra kulturore ose institucione dhe qendra biznesi që

ofrojnë kurse ose trajnime me qëllim aftësimin e mëtejshëm dhe të cilët nuk janë pjesë përbërëse e sistemit arsimor.

Tema 1.04 Kultura

Përshkrimi

Kjo temë përfshin të gjitha statistikat lidhur me kulturën. Statistikat në fushën e kulturës bazohen në të dhënat administrative nga Ministria përkatëse dhe operatorët e tjerë të tillë si Këshilli Kombëtar i Radio Televizioneve, etj.

Prioritetet

- Përmirësimi i vazhdueshëm i statistikave dhe indikatorëve të kulturës;
- Një bashkëpunim më i mirë me burimet përkatëse të informacioneve, në mënyrë që të sigurohet cilësi më e mirë në mbledhjen e të dhënave;
- Plotësimi i Programit Statistikor për Kulturën me statistika për aktivitete të pa raportuara më parë;
- Prodhimin e statistikave të krahasueshme me vendet e tjera evropiane.

Moduli 1.04.01 Statistikat e kulturës

Përshkrimi i situatës aktuale

Të dhënat për kulturën mblidhen nga burime administrative. Burimi kryesor është MTKRS. Burime të tjera janë KKRTSh, etj.

Të dhënat e grumbulluara nga INSTAT janë mbështetur në Programin e Statistikave Zyrtare, për treguesit kulturorë dhe operatorët radio-televizivë.

Të dhënat mblidhen për: institucione që japin shfaqje, teatro, kinema; tregues të aktivitetit të Muzeve dhe Monumenteve, Parku i Butrintit, biblioteka, ekspozita, pikturë, skulpturë, fotografi artistike; struktura e sporteve, ekipe etj. Këtu përfshihen tregues si: shpërndarja e teatrove, filma të prodhuar brenda vendit, filma të shfaqur të huaj dhe të vendit; shpërndarja e muzeumeve, monumenteve të kulturës; numri i bibliotekave, libra të tërhequr, ekspozita për librin; stacione kombëtare e jo kombëtare; ekspozita të çelura; ekipe sportive, ndeshje të zhvilluara etj.

Informacionit statistikor mbi kulturën në Shqipëri funksionon në bazë të ligjit "Për Statistikat Zyrtare", Nr 9180, të miratuar më 5.2.2004 nga Parlamenti.

Objektivat strategjikë

- Zhvillimi i marrëdhënieve me ndonjë burim tjetër informacioni për aktivitetet kulturore artistike dhe sportive të rretheve;

- Përmirësimi i marrjes së informacionit në afat nga burimet e disponueshme administrative;
- Përpunimi i të dhënave dhe llogaritja e indikatorëve të fushës;
- Përmirësimi i vazhdueshëm i formave të raportimit duke iu përshtatur ndryshimeve të varësisë së institucioneve të artit kulturës dhe sporteve;
- Bashkëpunimi me sektorët e tjerë kryesisht për të përdorur si burim vrojtimet sociale për marrjen e informacionit

Aktivitetet zbatuese

- Përftimi i informacionit duke u bazuar në të dhënat administrative të disa institucioneve. INSTAT-it i ofrohet ky informacion në formën e tabelave, nga MTKRS, KKRT, Radio Tirana, Televizioni Publik Shqiptar, Qendra Kombëtare e Kinematografisë, etj. Informacioni përmban të dhëna për aktivitetet e kryera nga institucionet kulturore të artit dhe trashëgimisë si edhe të sportit.

Rezultate të pritshme

- ✓ Plotësimi i nevojave për statistika të kulturës, artit, trashëgimisë e sportit në vend;

Burimi i Informacionit

Ministria e Turizmit Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Këshilli Kombëtar i Radio Televizioneve, Radio Tirana, Televizioni Publik Shqiptar, Qendra Kombëtare e Kinematografisë, etj., janë burimi administrativ nga i cili sigurohen të dhënat.

INSTAT harton format e raportimit, si pjesë integrale e Programit Statistikor Zyrtar.

Tema 1.05 Shëndeti dhe Siguria

Përshkrimi

Statistikat në lidhje me shëndetin publik përfshijnë të dhëna mbi statistikën e sëmundshmërisë, vdekshmërisë, aktivitete të institucioneve shëndetësore (spitalore dhe shërbimit parësor). Ato analizojnë dhe shpërndajnë një grup të qëndrueshëm të statistikave mbi shëndetin publik, si element statistikor i informacionit shëndetësor, të kërkuar për mbështetjen e Strategjisë Shëndetësore të mëtejshme, e mbështetur kjo në programin statistikor kombëtar.

Prioritetet

- Përmirësimi i cilësisë së informacionit;

- Përmirësimi në monitorimin e harmonizuar të statistikave publike në nivel rutinë;
- Përmirësimi i mëtejshëm i cilësisë së të dhënave dhe *metadata*-ve të përdorura për treguesit e shëndetit;
- Përmirësimi i analizës dhe shpërndarjes së statistikave të kujdesit shëndetësor.

Moduli 1.05.01 Statistikat e Shëndetit Publik

Përshkrimi i situatës aktuale

Statistikat për të dhënat shëndetësore mblidhen nga disa burime, siç janë burimet administrative, të cilat mbledhin informacionin nga regjistrat bazë të institucioneve shëndetësore. Informacioni i evidentuar në kartelat dhe regjistrat e spitaleve, klinikat dhe institucione të tjera mjekësore me e pa shtretër, përbën dokumentacionin klinik dhe administrativ. Por për ta mbledhur këtë informacion janë përcaktuar formularë sipas rregullave të informacionit statistikor.

Statistikat e shëndetësisë të prodhuara nga INSTAT plotësohen dhe nga anketat e ndryshme të tilla si: AMNJ, MIKS, SDSHSh (ADHS), etj.

INSTAT është përgjegjës për përpunimin dhe shpërndarjen e statistikave të ndryshme lidhur me shërbimet shëndetësore dhe shkaqet e vdekjes në Shqipëri.

Të dhënat statistikore tregojnë shpërndarjen aktuale sipas rajoneve të shkaqeve të vdekjes, grup-moshave, gjinisë, vendbanimit (urban-rural), diagnozave kryesore, numrin e personelit mjekësor për popullatë, numrin e institucioneve me dhe pa shtretër për popullatë, numrin e njerëzve të hospitalizuar dhe shkaqet e shtrimit në spital; numri mesatar i vizitave për popullatë për fëmijët, gratë shtatzëna dhe të rriturit, incidencën e sëmundjeve kryesore infektive dhe mbulesën vaksinale. Afatet përfundimtare për paraqitjen e të dhënave janë përcaktuar për secilin format të raportimit.

INSTAT ka miratuar Klasifikimin Ndërkombëtar të Sëmundjeve, Versioni i 9 (ICD-9), e cila siguron një kornizë të integruar dhe të qëndrueshëm për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave statistikore mbi sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë, të krahasueshme në nivel ndërkombëtar. ICD-9 siguron një metodologji për kategorizimin e të dhënave mbi sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë.

Objektivat Strategjikë

- Përmirësimi i cilësisë së informacionit.
- Përmirësimi në monitorimin e harmonizuar të statistikave publike në nivel rutinë;

- Përmirësimi i mëtejshëm i cilësisë së të dhënave dhe *metadata*-ve të përdorura për treguesit e shëndetit;
- Përmirësimi i analizës dhe shpërndarjes së statistikave të kujdesit shëndetësor;
- Futja në përdorim i Klasifikimit Ndërkombëtar të Sëmundjeve ICD 10;
- Përmirësimi i formave dhe raportimit nga institucionet shëndetësore, raportimit të tyre në forme elektronike;
- Nevoja për të shtuar informacionin shtesë që duhet për të prodhuar dhe për të dhënë informacione të ndara sipas gjinisë dhe rajonit, kryesisht kjo për sa i përket burimeve njerëzore, si në sektorin publik, ashtu dhe atë privat.
- Përmirësimi i burimeve dhe kapaciteteve njerëzore që mund të përmbushin plotësisht kërkesat e një sistemi statistikor shëndetësor modern, për të evituar vonesat dhe pasaktësinë në analizën e tij.
- Mundësia e futjes së pyetësorëve standard të rekomanduar nga Eurostat-i, (EIHS) Anketa Evropiane e Shëndetit, ku merret informacion mbi gjendjen e shëndetit dhe përcaktuesve bazë të tij.

Aktivitetet zbatuese

Statistikat për të dhënat shëndetësore mblidhen nga burimet administrative, të cilat e mbledhin informacionin nga regjistrat bazë të institucioneve shëndetësore.

Përsa i përket shkaqeve të vdekjeve, si burim informacioni është skeda e vdekjeve që merret nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, Institutin e Shëndetit Publik dhe institucione të tjera është bërë përpjekje vazhdimisht për të siguruar të dhëna të krahasueshme me vendet e rajonit. Është vendosur të përdoret një listë treguesish për shëndetin publik, me mbështetjen e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Një bashkëpunim i ngushtë i institucioneve, që mbledhin informacion shëndetësor, ka bërë të mundur hartimin e një plani pune në Sistemet e Informacionit Shëndetësor për periudhën 2010-2015, për ngritjen dhe përmirësimin e standardeve për një sistem të integruar të të dhënave si në burime njerëzore, strukturës së IT në sistemin shëndetësor, buxhetet, hartimin e protokolleve, kualitetit dhe nxitjes për përmirësimin e sistemeve të informacionit, në bazë të standardeve të EU-së.

Rezultatet e pritshme

Mbledhja e të dhënave statistikore të shëndetësisë na mundëson përlllogaritjen e një sërë treguesish shëndetësor të cilët do të shërbejnë për monitorim, vlerësim të situatës shëndetësore aktuale dhe marrjen e masave për përmirësimin e mëtejshëm.

Treguesit që do të përlogariten janë:

- Treguesit e Aktivitetit Shëndetësor në Institucione të shërbimit Parësor;
- Treguesit e Aktivitetit Shëndetësor në Institucione të kujdesit Spitalor;
- Tregues të Shëndetit Publik si vaksinimet, sëmundjet kronike, mënyra e të ushqyerit etj;
- Shkaqet e vdekjeve sipas skedës për vdekjet mbi një vjeç;
- Shkaqet e vdekjeve për vdekjet e fëmijëve nën një vjeç;
- Statistika financiare të Shëndetësisë Publike.

Burimi i informacionit

Burim i të dhënave statistikore shëndetësore janë:

- ✓ Ministria e Shëndetësisë
- ✓ Instituti i Shëndetit Publik
- ✓ Instituti i Sigurimeve dhe Kujdesit Shëndetësor
- ✓ Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
- ✓ Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
- ✓ Ministria e Financave
- ✓ Drejtoria e Llogarive Kombëtare, Instituti i Statistikave.

Burimet njerëzore dhe financiare

Në rast të zbatimit të (EIHS) Anketa Evropiane e Shëndetit, e cila do të siguronte informacion mbi gjendjen e shëndetit dhe përcaktuesve bazë të tij, është e nevojshme të shoqërohet me shtim stafi dhe buxheti.

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Treguesit e Aktivitetit Shëndetësor në Institucione të shërbimit Parësor	2011	2012	2013	2014	2015
Treguesit e Aktivitetit Shëndetësor në Institucione të kujdesit Spitalor	2011	2012	2013	2014	2015
Tregues të shkaqeve të vdekjeve	2011	2012	2013	2014	2015

Tema 1.06 Shpërndarja e të ardhurave dhe niveli i jetesës

Përshkrimi

Statistikat e shpërndarjes së të ardhurave dhe të nivelit të jetesës bazohen në dy burime kryesore: Anketa e Buxhetit të Familjes (ABF) dhe Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës (AMNJ).

Anketa e Buxhetit të Familjes (ABF) është një vrojtim statistikor i cili siguron të dhëna mbi shpenzimet dhe të ardhurat e familjeve, shpenzimet për vetë-konsum, si dhe AMNJ është një anketë shumëqëllimëshe, e cila kryhet në familje dhe është një nga burimet kryesore të informacionit për të matur kushtet e jetesës, gjendjen e varfërisë si dhe për të siguruar një instrument të nevojshëm për të ndihmuar hartuesit e politikave në monitorimin dhe zhvillimin e programeve sociale.

Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës, për t'u përafëruar më shumë me Anketën e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (SILC) sipas kompendiumit të Eurostat-it dhe krijimin e një ankete të vazhdueshme për matjen e nivelit dhe kushteve të jetesës, riskut për të qënë i varfër, përjashtimin shoqëror ose material dhe mirëqënien ka të përfshirë për herë të parë disa pyetje dhe module në brendësinë e saj.

Prioritetet

Prioritet kryesorë janë:

- Kryerja e Anketës së Matjes së Nivelit të Jetesës 2012 edhe në nivel Prefekturë.
- Është planifikuar që ABF të kryhet me baza tre-mujore duke filluar nga viti 2013.

Moduli: 1.06.01 Anketa e Buxhetit të Familjes

Përshkrimi i situatës aktuale

Anketa e Buxhetit të Familjes (ABF) është një vrojtim statistikor i cili siguron të dhëna mbi shpenzimet dhe të ardhurat e familjeve, shpenzimet për vetë-konsum, si dhe të dhëna për situatën socio-demografike në të cilën jetojnë familjet. Kjo anketë është plotësisht e harmonizuar me studimet ABF në vendet e tjera Evropiane. Për të përcaktuar strukturën e konsumit është përdorur klasifikimi COICOP/ABF i rekomanduar nga Eurostat për vendet Evropiane; *"Anketa e Buxhetit të Familjes në BE, Metodologji dhe Rekomandime për harmonizim, 2003"*. Ky vrojtim dhe të dhënat e mbledhura japin gjithashtu informacion mbi përbërjen e shpenzimeve të konsumit total të familjeve.

Anketa e Buxhetit të Familjes ka një shtrirje 1-vjeçare në terren. ABF është kryer për herë të parë në 1999-2000, përfaqësuese vetëm për zonën urbane të Shqipërisë, në krahasim me përfshirjen totale të territorit të vendit në 2006-2007 dhe një përfaqësim në nivel prefekturë dhe ndarje urbane-rurale.

Objektivi strategjik

Objektivi kryesor i këtij vrojtimi është përcaktimi i strukturës së Buxhetit të Familjeve, si dhe përdorimi i strukturës së shpenzimeve në përditësimin e shportës

dhe peshave të Indeksit të Çmimeve të Konsumit si dhe në përlllogaritjen e konsumit final të familjeve të përdorura nga Llogaritë Kombëtare.

Aktivitetet zbatuese

- Në kuadër të hartimit të projekt-programit të statistikave zyrtare duke filluar nga viti 2013, INSTAT ka parashikuar kryerjen e Anketës së Buxhetit të Familjes me baza tre mujore.
- ABF do të vazhdojë të përmirësohet sipas rekomandimeve dhe udhëzimeve të EUROSTAT-it.
- Përmirësim i vazhdueshëm i metodologjisë së llogaritjeve dhe publikimi i të dhënave.

Periodiciteti i aktiviteteve statistikore:

Aktiviteti statistikor	2012	2013	2014	2015	2016
Anketa Tremujore e Buxhetit të Familjes	-	x	x	x	x

Rezultatet e pritshme

- ✓ Do bëhet e mundur harmonizimi për t'i shërbyer më mirë Drejtorisë së Llogarive Kombëtare si dhe përditësimit të Shportës dhe Peshave të Indeksit të Çmimeve të Konsumit;
- ✓ Llogaritja e Buxhetit të Familjeve sipas prefekturave;
- ✓ Struktura e shpenzimeve familjare për 12 grupet kryesore;
- ✓ Struktura e shpenzimeve familjare sipas tipologjisë së familjeve;
- ✓ Shpenzimet për produkte të vetëkonsumuara;
- ✓ Shpërndarja e të ardhurave;
- ✓ Paraqitja e një panorame të kushteve të banimit;
- ✓ Ofrimi i shërbimeve bazë dhe zotërimi i pajisjeve afatgjata;

Burimi i informacionit

Anketa e Buxhetit të Familjes

Burime njerëzore

Anketa Tremujore e Buxhetit të Familjes						
Burime njerëzore	2013	2014	2015	2016	Frekuenca (herë)	Periudha e fillimit
Anketues	50	50	50	50	4 herë / vit	Janar 2013

Moduli: 1.06.02 Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës

Përshkrimi i situatës aktuale

Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës është një anketë shumëqëllimëshe, e cila kryhet në familje dhe është një nga burimet kryesore të informacionit për të matur kushtet e jetesës, gjendjen e varfërisë si dhe për të siguruar një instrument të nevojshëm për të ndihmuar hartuesit e politikave në monitorimin dhe zhvillimin e programeve sociale. Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës është kryer në kuadër të monitorimit të vazhdueshëm të varfërisë dhe krijimin e një sistemi të vlerësimit të politikave të parashikuar nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Statistikat mbi të ardhurat, përfshirjen sociale dhe kushtet e jetesës janë bazuar në Anketën e Matjes së Nivelit të Jetesës.

Mirëqenia e individëve të një vendi matet zakonisht nga konsumatorët, duke siguruar informacion për nivelin dhe shpërndarjen e varfërisë në vend. Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës është gjithashtu një mjet i fuqishëm për vlerësimin dhe përcaktimin e kostove sociale. Ky vrojtim ofron të dhëna në nivel kombëtar, në nivel rajoni dhe zonës urbane/rurale. Rajonet në këtë rast janë krijuar për qëllime statistikore dhe e ndajnë Shqipërinë në 4 zona të mëdha sipas një kriteri agro-gjeografik dhe si rrjedhim edhe një supozimi mbi homogjenitetin ekonomik: Rajoni Bregdetar, Qendror, Malor dhe Tirana urbane.

Objektivi strategjik

Objektivi kryesor i këtij vrojtimi është të mbledhë informacion për ndërtimin dhe matjen e mirëqenies dhe identifikimin e faktorëve që e përcaktojnë atë.

Aktivitetet zbatuese

- Në mënyrë që sistemi statistikor të prodhojë një gamë sa më të gjerë treguesish sociale për të kënaqur interesat e sa më shumë përdoruesve, në kuadër të hartimit të projekt-programit të statistikave zyrtare, në Qershor të vitit 2012 do të realizohet Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës, e cila do të furnizojë me të dhëna jo vetëm në nivel 4 Rajonesh (të përmendura më lart) por edhe në nivel qarku.
- Modifikimi dhe përshtatja e pyetësorit duke ruajtur krahasueshmërinë ndër vite dhe duke mundësuar dhënien e një panorame të plotë të karakteristikave të ndryshme socio-ekonomike të familjeve shqiptare;
- Përmirësimi i nivelit të dizagregimit të treguesve mbi të ardhurat, konsumin, kushtet e banimit, shëndetësisë, arsimit etj.;

- Përgatitja e një publikimi të veçantë, i cili do të përmbajë rezultatet, metodologjinë dhe disa analiza referuar anketave në vite të Matjes së Nivelit të Jetesës, bazuar në rezultatet e arritura nga ndërtimi i një baze të plotë të dhënash;
- Rritja e bashkëpunimit me agjencitë e tjera statistikore në mënyrë që gjithmonë e më shumë treguesit që prodhohen nga kjo anketë të plotësojnë kërkesat e përdoruesve të statistikave brenda dhe jashtë vendit, privatë dhe publikë.

Periodiciteti i aktiviteteve statistikore:

Aktiviteti statistikor	2012	2013	2014	2015	2016
Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës	x	-	-	-	-
Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës	-	-	-	x	-

Rezultate të pritshme

- ✓ Indikatorë të disagreguar në nivel Prefekturë;
- ✓ Llogaritja dhe paraqitja e treguesve kryesorë të varfërisë absolute dhe relative, monetare dhe jo-monetare;
- ✓ Llogaritja dhe paraqitja e treguesve kryesorë të pabarazisë ;
- ✓ Statistika mbi kushtet e banimit;
- ✓ Statistika mbi zotërimin e pajisjeve afatgjata dhe aksesin në shërbimet bazë;
- ✓ Asistenca sociale;
- ✓ Shpërndarja e të ardhurave;
- ✓ Kapitali social dhe përfshirja sociale;
- ✓ Statistika mbi tregues të ndryshëm të Edukimit;
- ✓ Statistika mbi tregues të ndryshëm të Shëndetit;
- ✓ Të dhëna mbi migrimin e brendshëm dhe të jashtëm;
- ✓ Llogaritja dhe paraqitja e treguesve kryesorë të pabarazisë gjinore;
- ✓ Të dhëna të ndryshme për grupe të caktuara të popullsisë;

Burimi i informacionit

Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës

Burime njerëzore

Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës
--

Burime njerëzore	2012	Frekuenca (herë)	Periudha e fillimit
Anketues	175	Çdo 3 vjet	Qershor 2012
Supervizorë	29	Çdo 3 vjet	Qershor 2012
Kontrollorë	8	Çdo 3 vjet	Qershor 2012

*Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës planifikohet që, duke kaluar edhe nëpërmjet një periudhe tranzicioni për të ruajtur krahasueshmërinë e të dhënave, të kalojë në Anketën e Matjes së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës në përputhje me compendiumin statistikor të EUROSTAT-it.

Tema 1.07 Mbrojtja sociale

Përshkrimi

Puna në lidhje me Statistikat e Mbrojtjes Sociale konsiston në mbledhjen e të dhënave administrative në lidhje me numrin e kontribuuesve sipas sektorëve, masën e kontributit, pensionet sipas kategorive dhe gjinisë, masën e pensionit, etj. Grumbullohen të dhëna dhe për numrin e familjeve që marrin ndihmë ekonomike, për fondin e ndihmës detajuar sipas strukturës së familjeve, tipit të ndihmës dhe ndarjes administrative, të dhëna rreth pagesës për personat me aftësi të kufizuar si edhe të dhëna rreth pagesës së papunësisë.

Prioritetet

Fokusi do të jetë mbledhjen e të dhënave vjetore për mbrojtjen sociale duke zbatuar ESSPROS (Sistemi Evropian i Statistikave të integruara për mbrojtjen sociale) dhe në zhvillimin e metodologjisë së statistikave të mbrojtjes sociale.

Moduli 1.07.01 Mbrojtja sociale

Përshkrimi i situatës aktuale

Fushat e aktiviteteve që mbulohen nga kjo temë janë: të dhëna mbi shpenzimet për mbrojtjen sociale dhe numrin e përfituesve sipas skemave të mbrojtjes sociale dhe të dhënat për pensionet.

Instituti i Statistikës së Shqipërisë mbledh të dhëna për mbrojtjen sociale nga burimet administrative. Të dhënat për shpenzimet për mbrojtjen sociale dhe numrin e përfituesve merren nga MPÇSShB. Këto të dhëna sigurojnë informacion për numrin e personave në pagesë papunësie dhe nivelin bazë të pagesës së

papunësisë (i cili përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave), numrin e familjeve të trajtuara me ndihmë ekonomike si dhe fondin e ndihmës ekonomike. INSTAT i publikon këto të dhëna me çdo tre muaj në faqen zyrtare të *web-it* www.instat.gov.al. Të dhënat administrative mbi pensionet mblidhen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Instituti i Statistikës së Shqipërisë i publikon të dhënat për pensionet me periodicitet vjetor.

Objektivi strategjik

Qëllimi kryesor i statistikave të mbrojtjes sociale është sigurimi i përshkrimeve të hollësishme dhe koherente për mbrojtjen sociale (për përfituesit e mbrojtjes sociale disagreguar sipas llojit të përfitimit dhe origjinës, shpenzimeve për mbrojtjen sociale, etj).

Aktivitetet zbatuese

- Zgjerimi i gamës së statistikave sociale me treguesit e mbrojtjes sociale për fëmijët.
- Krijimi i *metadata*-ve për skemat e mbrojtjes sociale sipas udhëzimeve të Eurostat-it.

Periodiciteti i aktiviteteve statistikore:

Aktiviteti statistikor	2012	2013	2014	2015	2016
Tregues të pensioneve	x	x	x	x	x
Tregues të ndihmës ekonomike	x	x	x	x	x

Rezultatet e pritshme

- ✓ Përmirësimi i sistemit të statistikave për mbrojtjen sociale do t'i shërbejë realizimit të strategjive kombëtare për mbrojtjen sociale dhe për mbrojtjen e fëmijëve.
- ✓ Të dhënat për mbrojtjen sociale do të jenë të harmonizuara në nivel kombëtar me statistikat të tjera sociale.

Burimet

Me burimet njerëzore që ka aktualisht sektori i statistikave të tregut të punës mund të mbulohen të gjitha aktivitetet që lidhen me prodhimin e statistikave të mbrojtjes sociale.

Aktiviteti statistikor	2012	2013	2014	2015	2016
Anketa pilot e kostove të punës	x	x	x	x	x

Anketa e kostove të punës	-	-	-	-	-
---------------------------	---	---	---	---	---

Tema 1.10 Statistikat juridike

Përshkrimi

Për hartimin e statistikave të kriminalitetit dhe të drejtësisë zbatohet një metodologji adekuate e cila i referohet funksionimit të skemës së sistemit të informacionit që aplikojnë strukturat e policisë, MB, gjykatat dhe MD sipas hierarkisë strukturore nga niveli vendor në atë qendror, e deri në finalizimin e botimit të tyre.

Hartimi i statistikave të kriminalitetit kalon nëpër disa stadi. Struktura e policisë vendore, duke filluar që nga postat, rajonet e komisaritetet e policisë në rrethe administrojnë ngjarjet, krimet e shkeljet e ndryshme të ligjit në regjistrat e ngjarjeve sipas llojit të tyre. Si burime fillestare të statistikave shërbejnë faktet e provat që grumbullohen nga denoncimet e personave, kallëzimet e ndryshme, konstatimet dhe këqyrjet e ngjarjeve kriminale, zbulimet e bëra nga vetë policia etj.

Pas regjistrimit të ngjarjeve kriminale kalohet në fazën e përpunimit të tyre sipas formularëve tip që kanë shërbimet e policisë dhe, veçanërisht, policia kriminale. Pas përpunimit në nivel komisariti, ato kalojnë në nivelin rajonal ose drejtoritë e policisë së qarqeve dhe, më pas, dërgohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë në Ministrinë e Brendshme.

Hartimi i statistikave të drejtësisë realizohet nga disa burime kryesore që sigurojnë informacionin statistikor, siç janë: gjykatat e shkallës së parë, gjykatat e apeleve dhe gjykata e lartë. Me anë të akteve nënligjore materiali statistikor dërgohet në Ministrinë e Drejtësisë nga institucionet e tjera, nëpërmjet formularëve të plotësuar me të dhënat sipas udhëzimeve përkatëse të Ministrisë të Drejtësisë. Burim tjetër i rëndësishëm statistikor që merr MD, i cili shërben për pasqyrimin e të dhënave lidhur me hetimet paraprake, dinamikën e tyre dhe dërgimin e çështjeve për gjykim, është edhe evidenca statistikore që Prokurori i Përgjithshëm dërgon periodikisht. Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit mbyll ciklin e grumbullimit të të dhënave për ekzekutimin e vendimeve penale dhe civile, duke plotësuar në tërësi të gjithë lëndën e parë, me të cilën Zyra e statistikës pranë Ministrisë së Drejtësisë harton informacionin përfundimtar, model i cili i shërben INSTAT-it për paraqitjen e statistikave të drejtësisë.

Prioritetet

Statistikat e krimeve shërbejnë për të njohur situatën e krimeve në Shqipëri dhe për të përmirësuar punën në luftimin e tyre. Klasifikimi i krimeve dhe kundërvajtjeve penale sipas natyrës së tyre, bëhen gjithnjë duke iu referuar Kodit Penal. Në këtë rast bëhet fjalë për ngjarje të konstatuara ose të ndodhura dhe jo për

gjykime të cilat janë në kompetencën e organeve të drejtësisë për të dhënë verdiktin.

Puna paraprake e bërë për njohjen e situatës kriminale në vend ka dhënë mundësinë që vendi ynë të hyjë në një fazë të re të luftës ndaj krimit të organizuar që është edhe angazhimi i shtetit shqiptar për integrimin në Evropë.

Moduli 1.10.01 Të dhënat administrative mbi krimet dhe zbulimi i tyre

Përshkrimi i situatës aktuale

Statistikat e kriminalitetit që mbledh dhe publikon INSTAT merren nga MB (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë), ndërsa statistikat e drejtësisë merren nga MD. Për publikimin e tyre përdoret një metodologji e caktuar e cila implikon disa institucione, të cilat bashkërendojnë punën e tyre.

Në përgatitjen e Vjetarit Statistikor 1995-2004, INSTAT ka publikuar të dhëna në lidhje me statistikat e kriminalitetit dhe drejtësisë. Më vonë, INSTAT nuk ka botuar të dhëna mbi kriminalitetin. Statistikat e mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë kanë qenë të vështira për tu transformuar sipas kërkesave të Eurostat-it. INSTAT është duke realizuar takime me këto institucione për të vendosur një standard të ri të mbledhjes së këtyre statistikave, në interes të të gjithë përdoruesve.

Objektivat strategjikë

Objekti kryesor strategjik është krijimi i bazës së të dhënave për statistikat juridike sipas kërkesave të Eurostat. Për këtë qëllim, është shumë e rëndësishme së pari të mundësohet një bashkëpunim i ngushtë dhe i ndërsjellë me ministritë e linjës dhe institucionet e varësisë. Duhet planifikuar takime të vazhdueshme me këto institucione për dërgimin e të dhënave në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike, në mënyrë që të mundësohet ndërtimi i indikatorëve të qëndrueshëm në këtë fushë.

Nga ana tjetër, në mënyrë që indikatorët e prodhuar të plotësojnë kërkesat e Eurostat-it, është i nevojshëm edhe harmonizimi i definicioneve statistikore me ato të Eurostat-it.

Aktivitetet zbatuese

- Ngritja e bazës së të dhënave juridike sipas rekomandimeve dhe kërkesave të Eurostat-it;
- Harmonizimi i definicioneve sipas atyre të Eurostat-it;
- Ndërtimi i indikatorëve të qëndrueshëm;

- Nënshkrimi i memorandumeve të bashkëpunimit me institucionet përkatëse për dërgimin periodik, të vazhdueshëm dhe sipas formës së përshtatshme, të të dhënave;

Rezultatet e pritshme

Koeficientët që do të përlogariten në kuadër të këtij moduli për çdo vit janë:

- ✓ Çështjet penale dhe civile, gjykata e shkallës së parë;
- ✓ Çështjet penale dhe civile, gjykata e apelit;
- ✓ Çështjet penale dhe civile, Gjykata e Lartë;
- ✓ Krimet dhe zbulimi i tyre;
- ✓ Të dënuarit.

Burimi i informacionit

- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, siguron të dhënat mbi veprat penale sipas klasifikimit të krimeve
- Ministria e Drejtësisë, siguron të dhëna mbi numrin e të dënuarve si dhe çështjet e shqyrtuar nga gjykatat e niveleve të ndryshme;
- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve e cila siguron të dhëna në lidhje me të dënuarit sipas disa karakteristikave individuale (mosha, gjinia, arsimimi, etj.).

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Treguesit mbi çështjet penale dhe civile sipas shkallës së gjykatave (e Parë, Apelit, e Lartë)	2011	2012	2013	2014	2015
Treguesit mbi krimet dhe zbulimi i tyre	2011	2012	2013	2014	2015
Tregues mbi personat e dënuar	2011	2012	2013	2014	2015

Tema 1.12 Statistika të tjera në fushën demografike dhe sociale

Moduli 1.12.02 Statistikat gjinore

Përshkrimi i situatës aktuale

Aspekti gjinor është një dimension çelës për të gjithë fushat e statistikave në nivel individual. Ky modul përfshin punën që do të bëhet në këtë aspekt si dhe në promovimin e perspektivës gjinore në statistikë. Kjo përfshin të gjithë hapat duke filluar nga prodhimi i të dhënave, analiza e tyre e deri ne publikimin final në *ëeb* ose

përmes publikimeve në *hard copy*. Për të monitoruar aspektin gjinor në disa fusha sociale do të prodhohen në mënyrë të rregullt një sërë indikatorësh gjinorë.

Funksioni i indikatorëve gjinorë në fushën e arsimit është që të tregojnë ndryshimet e ndodhura me kohën në këtë fushë të jetës sociale duke e parë në aspektin gjinor. Me anë të këtyre indikatorëve mund të tregojmë statusin dhe rolin e femrave dhe meshkujve në fushën e arsimit. Rrjedhimisht ne mund të tregojmë gjendjen e barazisë gjinore në këtë fushë. Prodhimi në mënyrë të saktë dhe të plotë I këtyre indikatorëve do të bëjë të mundur politikbërësve marrjen e vendimeve të duhura për arritjen e objektivave në këtë drejtim.

Indikatorët gjinorë në fushën e punësimit tregojnë ndryshimet e ndodhura me kohën në këtë fushë të para në aspektin gjinor. Këta indikatorë tregojnë diskriminimin ndaj grave, nëse ka, në aspektin e përfshirjes në forcën e punës. Gjithashtu ata tregojnë gjendjen e barazisë gjinore në këtë fushë. Prodhimi në mënyrë të saktë i këtyre indikatorëve do të ndihmojë politikbërësit në marrjen e masave të duhura për reduktimin e diskriminimit ndaj gruas në forcën e punës.

Një rëndësi të veçantë kanë indikatorët gjinorë në fushën e shëndetësisë. Vitet e fundit është rritur interesi për të analizuar mënyrën se si gjinia dhe aspekte të tjera të saj mund të ndikojnë shëndetin.

Një rëndësi të veçantë kanë treguesit gjinorë në fushën e varfërisë.

Gjithashtu pjesëmarrja në vendimmarrje dhe fuqizimi i femrave është një fenomen i ri për të cilin nevojitet të llogariten tregues të rinj dhe në harmoni me standardet ndërkombëtare.

Objektivat strategjikë

- Analiza dhe prodhimi i indikatorëve të disagreguar femra dhe meshkuj;
- Ndërtimi i treguesve të qëndrueshëm;
- Harmonizimi me definicionet ndërkombëtare;
- Shfrytëzimi i të gjitha burimeve aktuale për prodhimin e këtyre indikatorëve, por njëkohësisht mundësia e pasurimit të tyre me tregues të përditësuar me definicionet ndërkombëtare.

Aktivitete zbatuese

Aktivitetet që do të ndërmerren për arritjen e objektivave janë:

- Përdorimi efektiv i burimeve administrative aktuale. Kjo do të arrihet nëpërmjet mbledhjeve dhe takimeve me ministritë e linjës për të zgjeruar fushën e veprimit për statistikat gjinore;
- Shfrytëzimi i Anketave sociale pranë familjeve që INSTAT kryen, duke mundësuar llogaritjen e treguesve të cilët nuk mund të llogariten nga burime administrative;

- Në të ardhmen do të shihet mundësia e shfrytëzimit të të dhënave nga anketat ekonomike.

Rezultate të pritshme

Treguesit gjinorë që do të prodhohen në fushën e statistikave gjinore do të jenë:

- ✓ Indikatorët gjinorë në fushën e arsimit
- ✓ Indikatorët gjinorë në fushën e punësimit
- ✓ Indikatorët gjinorë në fushën e varfërisë
- ✓ Indikatorët gjinorë në fushën e shëndetësisë
- ✓ Indikatorët gjinorë në fushën e fuqizimit në vendimmarrje

Këta tregues do të shërbejnë në paraqitjen sa më të plotë të situatës gjinore në fusha të ndryshme.

Burimet e informacionit

- Census-Al 2011 i cili do të jetë baza për llogaritjen e Projeksioneve;
- Anketa e Forcave të Punës për llogaritjen e treguesve gjinorë në fushën e punësimit;
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës, burim administrativ për llogaritjen e treguesve gjinorë në arsim;
- Ministria e Shëndetësisë për llogaritjen e disa treguesve gjinorë në shëndetësi;
- Statistikat vitale që do të shërbejnë në llogaritjen e treguesve të ndryshëm në fushën e shëndetësisë, lindshmërisë si dhe shfrytëzimi i tyre në përditësimin periodik të popullsisë;
- AMNJ për llogaritjen e treguesve gjinorë në fushën e varfërisë;
- Kuvendi i Shqipërisë, Universitetet, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të cilat do të jenë institucione që do të ndihmojnë me furnizimin me të dhëna për llogaritjen e treguesve në pjesëmarrje në vendimmarrje;
- Shfrytëzimi i mundshëm i të dhënave për numrin e femrave drejtuese në biznes që mund të përftohen nga anketa ekonomike.

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Treguesit gjinorë në fushën e arsimit	2011	2012	2013	2014	2015
Treguesit gjinorë në fushën e punësimit	2011	2012	2013	2014	2015
Treguesit gjinorë në fushën e përfshirjes sociale	2011	2012	2013	2014	2015
Tregues gjinorë mbi pjesëmarrjen në	2011	2012	2013	2014	2015

vendimmarrje					
--------------	--	--	--	--	--

FUSHA 2 - STATISTIKAT MAKROEKONOMIKE

Tema 2.01 Llogaritë Ekonomike Vjetore

Përshkrimi

Llogaritë Kombëtare Vjetore luajnë një rol të rëndësishëm në hartimin e politikave ekonomike dhe janë baza e informacionit për të treguar zhvillimin dhe ndryshimet strukturore të ekonomisë së vendit. Ato i ofrojnë përdoruesve tregues kryesorë dhe informacion bazë për zhvillimin ekonomik të vendit. Të dhënat e kësaj kategorie përdoren nga Qeveria, Ministria e Financave, ministritë e tjera të linjës dhe institucionet qendrore, institucione kërkimore, organizatat ndërkombëtare, partnerët socialë, tregjet financiare, median, analistët ekonomikë dhe përdoruesit e tjerë publikë dhe privatë. Nëpërmjet treguesve të shumtë sigurohet një kuadër i fortë dhe pikë referimi për vlerësimet tre mujore (shih Tema 2.02) dhe për llogaritjen e treguesve të tjerë të rëndësishëm, si të ardhurat kombëtare bruto, për përcaktimin e burimeve të veta. Baza metodike e të dhënave të harmonizuara është në përputhje me Sistemin Evropian të Llogarive të vendeve të BE-së (ESA95), i cili është version i Sistemit të Llogarive Kombëtare në nivel botëror (SNA-1993).

Prioritetet

Në vitet e fundit është bërë një punë intensive në fushën e statistikave të llogarive kombëtare për përmirësimin dhe shtimin e treguesve makroekonomikë, në përputhje me kërkesat dhe standardet evropiane. Që prej Marsit 2010, Llogaritë Kombëtare Shqiptare asistohen nga projekti IPA 2007 Kombëtar. Objektivat e përgjithshme të projektit synojnë zhvillimin e sistemit shqiptar të llogarive kombëtare me qëllim përafrimin sa më të plotë me parimet e aplikuara në Sistemin Evropian të Llogarive (ESA '95) dhe SNA-1993.. Kështu, në këtë kuadër, janë parashikuar:

A. Zhvillimi i disa elementëve të rinj kryesore:

- Fazat e para për llogaritë kombëtare sipas sektorëve institucionalë;
- Vlera e Shtuar bruto sipas rajoneve statistikore NUTS 2 dhe NUTS 3;
- Vlerësime të pavarura për komponentët e metodës së shpenzimeve të PBB;
- Zhvillime në sistemin e Tabelave Burime-Përdorime e *Input-output* (Termi

Angl. SUT & I/OT)

B. Përmirësime metodike e të konsistencës të llogaritjeve të PBB:

- Përmirësime metodike të vlerësimeve vjetore, vlerësimeve të ekonomisë së pavrojtuar, për vlerësimet tremujore, etj;
- Përmirësime metodike të vlerësimeve.

C. Implementimi i klasifikimeve të reja

- Implementimi NACE Rev. 2
- Implementimi CPA 2008

Moduli 2.01.01 Sistemi Evropian i Llogarive dhe Moduli 2.01.02 Llogaritë kombëtare (treguesit)

A. Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) me metodën e Prodhimit

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT publikon vlerësimet e PBB sipas metodës së prodhimit, me çmime korrente dhe konstante. Kjo realizohet në mënyrë të pavarur dhe është konsideruar si metoda më e mirë për vlerësimin e PBB-së, pasi bazohet në një numër të madh burimesh informacioni, gjë që lejon aplikimin e metodave direkte të llogaritjes së treguesve.

Objektivi Strategjik

Objektivi kryesor i statistikave të Llogarive Kombëtare Vjetore është vlerësimi në nivel kombëtar i treguesve të Llogarive Kombëtare, sipas metodës së Prodhimit, me çmime korrente e konstante si dhe përmirësimi i burimeve të të dhënave dhe metodologjisë për konsolidimin e mëtejshëm të këtyre llogarive me synim përafrimin gjithnjë e më tepër të tyre me standardet e BE-së (SNA 1993/ESA 1995). Në këtë kontekst, rëndësi merr sigurimi i prodhimit cilësor të tyre e, sidomos, të dy nga karakteristikat kryesore të cilësisë siç janë, saktësia dhe koha sa më e shkurtër e vlerësimit të tyre.

Ky objektivi do të sigurohet nëpërmjet:

- Implementimit të vazhdueshëm të metodologjive të rishikuara të llogaritjes së agregatëve të Llogarive Kombëtare, mbështetur në manualët dhe rregulloret e vazhdueshme që miraton Eurostat në këtë fushë statistikore;
- Llogaritjes së treguesve të rinj, si Inputet e punës dhe Produktiviteti, tregues të cilët janë të lidhur ngushtë me vlerësimin e Llogarive Kombëtare Vjetore;

- Implementimit të klasifikimit NACE Rev.2 në Llogaritë Kombëtare Vjetore. Programi i ri statistikor duhet të ketë parasysh implementimin e klasifikimit të ri të aktiviteteve ekonomike NACE Rev.2, i cili do të çojë në revizionimin e të gjithë burimeve të informacionit;
- Forcimit të kapaciteteve në INSTAT për prodhimin dhe përmirësimin e statistikave ekzistuese të Llogarive Kombëtare.

Aktivitetet zbatuese

- Përmirësimi i metodologjisë duke u mbështetur në konceptet dhe SNA 1993/ESA 1995, për të pasur statistika të dobishme dhe të krahasueshme me vendet evropiane;
- Rritja e bashkëpunimit me institucione të tjera, për shfrytëzim sa më të mirë të burimeve administrative;
- Përmirësim i vazhdueshëm i burimeve të informacionit dhe metodologjisë së llogaritjeve të ekonomisë së pavrojtuar;
- Vazhdimi i vlerësimeve të komponentëve të PBB-së me metodën e Prodhimit, duke shfrytëzuar të gjitha burimet e mundshme të informacionit, përfshirë këtu edhe të dhënat nga Regjistrimi i Përgjithshëm i Njësive Ekonomike Jobjuqësore 2010, Census-Al 2011 dhe Regjistrimi i Njësive Ekonomike Jobjuqësore 2012;
- Kryerja e studime të vazhdueshme mbi praktikën e ndjekura nga vendet e tjera;
- Ngritja e një Grupi Pune për të studiuar mundësinë e ndërtimit të një baze të dhënash unike, me përmbajtjen e treguesve të pasqyrave financiare të subjekteve që veprojnë në vendin tonë;
- Implementimi i nomenklaturës së aktiviteteve NACE Rev.2 në Llogaritë Kombëtare Vjetore dhe hartimi i treguesve të rinj, si të *input*-it të punës sipas aktivitetit ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal sipas tipit të punësimit, ashtu dhe matjes së produktivitetit, në përputhje me metodologjinë dhe legjislacionin e BE-së.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Cilësi e përmirësuar e llogaritjes së treguesve të Llogarive Kombëtare;
- ✓ Vlerësimi i treguesve të ekonomisë së pa vrojtuar me metodën e prodhimit, me çmime korente dhe konstante;
- ✓ Publikimi në nivel më të detajuar në vitet në vazhdim duke kaluar nga klasifikimi aktual me A7 degë në klasifikimin A25 degë të ekonomisë;
- ✓ Vlerësimi i treguesve të PBB-së me metodën e prodhimit në nivel A60 me çmime korente dhe konstante;

- ✓ Afrimi në kohë i prodhimit dhe publikimi i të dhënave të Llogarive Kombëtare;
- ✓ Vlerësimi i PBB-së me çmime konstante me anë të procesit të deflatimit të dyfishtë duke përmirësuar matjet në volum dhe në çmim të llogarive kombëtare.

Moduli 2.01.02 Llogaritë Kombëtare
Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) me metodën e
Prodhimit

Treguesit	Viti				
	2012*	2013	2014	2015	2016
Prodhimi	2010	2011	2012	2013	2014
Konsumi Ndërmjetës	2010	2011	2012	2013	2014
Vlera e Shtuar	2010	2011	2012	2013	2014
Pesha specifike e degëve	2010	2011	2012	2013	2014
Rritja reale vjetore	2010	2011	2012	2013	2014
Deflatorët	2010	2011	2012	2013	2014
Kontributi	2010	2011	2012	2013	2014

** Në vitin 2012 treguesit publikohen në nivel 7 degësh, në vitet në vazhdim në 25 degë*

Burimet e informacionit

Treguesit e Llogarive Kombëtare Vjetore bazohen kryesisht në shfrytëzimin e të dhënave të prodhuara nga vrojtimitet statistikore dhe burimet administrative. INSTAT, Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare janë furnizuesit kryesorë të informacionit për përpilimin e llogarive vjetore.

Burimet kryesore të marrjes së informacionit nga INSTAT u referohen regjistrimeve të përgjithshme dhe vrojtimitëve statistikore mbi ndërmarrjet e njësitë ekonomike familjare, ndërmjet të cilave mund të përmendim: Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve (ASN), Anketa e Forcave të Punës (AFP), Anketa e Matjes së Standarteve të Jetesës (AMSJ), Anketa e Buxhetit të Familjeve (ABF), Regjistrimi i Përgjithshëm i Njësive Ekonomike Jo-Bujqësore 2010, Census-Al 2011, etj.

Burimet administrative sigurojnë informacion në lidhje me pasqyrat financiare vjetore, pagesat e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar dhe Tatimit mbi Fitimin, pagesat e kontributeve shoqërore që deklarohen subjektet ekonomike në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare sigurojnë të dhëna mbi subjektet që kryejnë aktivitete financiare, si dhe për llogaritjen e Shërbimit të Ndërmjetësuesve Financiarë të Matura Indirekt (FISIM-angl). Ndërsa të dhënat mbi të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit merren nga Ministria e Financave.

Përdorimi i një game të gjerë informacioni ka për qëllim gjithëpërfshirjen dhe integrimin e të gjitha burimeve ekzistuese në funksion të llogaritjes e PBB-së dhe treguesve të tjerë ekonomikë. Ndërkohë, për fusha të pambuluara me informacion, është e nevojshme të aplikohen metoda indirekte vlerësimi, duke u mbështetur në rekomandimet dhe rregulloret e Eurostat-it.

B. Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) me metodën e Shpenzimeve

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT, publikon vlerësimet e PBB-së sipas metodës së shpenzimeve, me çmime korrente dhe me çmimet e vitit të mëparshëm. Këto vlerësime nuk realizohen në mënyrë të pavarur për të gjithë komponentët përbërës. Disa prej komponentëve vlerësohen në mënyrë direkte, si Eksportet Neto, Konsumi Final i Administratës Publike dhe Konsumi Final i Institucioneve Jo-Fitimprurëse që i shërbejnë Familjeve (shkurt IJFP_{SF}). Konsumi Final i Popullatës vlerësohet duke përdorur një sërë treguesish të integruar që rezultojnë nga metoda e prodhimit. Vlerësimi i PBB-së sipas metodës së shpenzimeve në mënyrë të pavarur është gjithashtu një nga objektivat kryesore të projektit IPA-2007 Kombëtar (Komponenti Llogaritë Vjetore) për të cilën janë kryer një seri punimesh të cilat do të finalizohen me përfundimin e projektit.

Objektivi Strategjik

Objektivi kryesor është vlerësimi në nivel kombëtar i treguesve të statistikave të Llogarive Kombëtare sipas metodës së shpenzimeve, me çmime korrente e konstante, duke synuar koherencën me konceptet e SNA-93 (ESA-95) si dhe zbatimin e rekomandimeve të dhëna për zhvillime të mëtejshme të Llogarive Kombëtare.

Nëpërmjet integritit të informacionit statistikor ekzistues mbi sistemin ekonomik e social të vendit, aplikimit të kombinuar me metodat bilancuese, realizohen vlerësime mbi komponentë të veçantë të përdorimeve finale të PBB-së, konkretisht: formimin bruto të kapitalit, konsumin final (të popullatës, administratës publike e IJFP_{SF}) si dhe shkëmbimet neto të produkteve e shërbimeve me botën e jashtme. Me anë të këtyre vlerësimeve, synohet llogaritja e pavarur, me rrugë statistikore, e PBB-së me metodën e shpenzimeve.

Aktivitetet zbatuese

Në kuadër të përmirësimit të metodologjisë së Llogarive Kombëtare Vjetore, me metodën e shpenzimeve, do të zhvillohen këto aktivitete kryesore:

- Analiza e komponentëve kryesorë të llogaritjes së PBB-së me metodën e shpenzimeve: analiza e rezultateve ekonomike të Rregjistrimit të Përgjithshëm të Njësive Ekonomike Jo-bujqësore, të cilat do të lejojnë realizimin e aktiviteteve të mëposhtme:
 - Vlerësimi i Investimeve dhe Ndryshimeve në Inventar bazuar në të dhëna komplete dhe direkte nga njësitë ekonomike;
 - Vlerësimi i konsumit final të Institucioneve Jo-Fitimprurëse në shërbim të familjeve (IJFP_{SF}).
- Përmirësim i vazhdueshëm i burimeve të informacionit, kryesisht i vrojtimit statistikore që realizohen në INSTAT. Propozime për burime të reja informacioni apo për kryerjen e vrojtimit të reja.
- Përmirësimi metodologjik i vlerësimeve aktuale. Aktiviteti do të fokusohet kryesisht në përmirësimet metodologjike të gjithë komponentëve të Produktit të Brendshëm Bruto me metodën e Shpenzimeve, konkretisht:
 - Vlerësimi i Formimit Bruto të Kapitalit Fiks, me çmime korrente dhe konstante ;
 - Ballafaqimi i burimeve ekzistuese për llogaritjen e Konsumit të Familjeve;
 - Vlerësimi i Konsumit të Administratës Publike me çmimet e vitit bazë dhe me çmimet e vitit paraardhës;
 - Vlerësimi i Ndryshimeve në Inventar.
- Plotësimi i informacionit të nevojshëm për llogaritjen e komponentit të Eksporteve Neto.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Vlerësimi me rrugë të pavarur i PBB-së me metodën e shpenzimeve, sipas komponentëve përbërës të përdorimeve finale;
- ✓ Vlerësimi i Konsumit final të popullatës, Konsumit final të administratës publike (individual- kolektiv), Konsumi final i IJFP_{SF}, Formimi bruto i kapitalit si dhe shkëmbimet neto të produkteve e shërbimeve me botën e jashtme;
- ✓ Publikimi i të gjithë komponentëve përbërës të PBB-së me metodën e shpenzimeve, me çmime korrente dhe me çmimet e vitit paraardhës.

Moduli 2.01.02 Llogaritë kombëtare					
Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) me metodën e Shpenzimeve					
Treguesit	Viti				
	2012	2013	2014	2015	2016
Shpenzimet për Konsum Final të Familjeve	2010	2011	2012	2013	2014
Shpenzimet për Konsum Final të Institucioneve Jo-fitimprurëse	2010	2011	2012	2013	2014
Shpenzimet për Konsum Final të Administratës Publike	2010	2011	2012	2013	2014
Formimi Bruto i Kapitalit Fiks	2010	2011	2012	2013	2014

Eksporti i Mallrave dhe Shërbimeve	2010	2011	2012	2013	2014
Impori i Mallrave dhe Shërbimeve	2010	2011	2012	2013	2014
Struktura e PBB me metodën e Shpenzimeve	2010	2011	2012	2013	2014
Rritja reale vjetore e komponentëve të Shpenzimeve	2010	2011	2012	2013	2014
Deflatorët	2010	2011	2012	2013	2014
Kontributi	2010	2011	2012	2013	2014

Burimet e informacionit

Si burime kryesore të marrjes së informacionit për llogaritjen e PBB-së me metodën e shpenzimeve konsiderohen përgjithësisht burimet statistikore dhe administrative. Burimet statistikore kanë të bëjnë me regjistrimet e përgjithshme, vrojtimit statistikore mbi ndërmarrjet, familjet etj. Ndërsa burimet administrative i referohen të gjithë arkivave administrative, me qëllim të gjithëpërfshirjes dhe integritimit të të gjitha burimeve ekzistuese në dispozicion.

INSTAT, Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë janë kryesisht furnizuesit kryesorë të informacionit për vlerësimin e PBB-së sipas metodës së shpenzimeve. Për fusha të pambuluara me informacion, është e nevojshme mbështetja në vlerësime të ndryshme me origjinë nga burimet administrative, vrojtimit statistikore, studime, etj.

Moduli 2.01.03 Llogaritë Vjetore të Sektorëve Institucionalë

Përshkrimi i situatës aktuale

Një prej objektivave të projektit IPA-2007 Kombëtar, konsiston në zhvillimin për herë të parë të Llogarive Vjetore sipas sektorëve institucionalë, duke zhvilluar një sistem të thjeshtuar, i cili do të realizojë kalimin e treguesve ekonomikë ekzistues nga burime të ndryshme, në koncepte të Llogarive Kombëtare për sektorët institucionalë. Synohet të arrihet ndërtimi i dy prej llogarive kryesore, llogaria e Prodhimit dhe llogaria e të Ardhurave, në përputhje me parimet e balancimit të aplikuar në Sistemin evropian të Llogarive (ESA 95) dhe SNA 93.

Objektivi Strategjik

Objektivi kryesor i llogarive vjetore sipas sektorëve institucionalë është vlerësimi dhe analiza në nivel kombëtar i llogarive vjetore, duke dhënë një paraqitje të plotë të transaksioneve jofinanciare për çdo sektor institucional të ekonomisë, siç janë: Ndërmarrjet jofinanciare, Institucionet financiare, Administrata Publike, Familjet, realizuar kjo nëpërmjet integritimit të informacionit statistikor ekzistues mbi sistemin ekonomik e social të vendit dhe aplikimit të kombinuar të metodave balancuese, duke synuar koherencën e plotë me konceptet e SNA-93 (ESA-95).

Ky objektiv do të sigurohet nëpërmjet:

- Pasqyrimin të drejtë dhe të saktë në programin e ri statistikor të treguesve të prodhuar.
- Forcimit të kapaciteteve në INSTAT për prodhimin dhe përmirësimin e statistikave ekzistuese të Llogarive Kombëtare;
- Implementimit të vazhdueshëm të metodologjive të rishikuara të llogaritjes së agregatëve të Llogarive Kombëtare, mbështetur në manualin dhe rregulloret e vazhdueshme që miraton Eurostat-i në këtë fushë statistikore.

Aktivitetet zbatuese

Në kuadër të vlerësimit të llogarive vjetore sipas sektorëve institucionalë, do të zhvillohen aktivitetet kryesore të mëposhtme:

- Propozime për përmirësimin e burimeve statistikore apo administrative të informacionit si bazë e nevojshme për analizën e sektorëve institucionalë;
- Rritja e bashkëpunimit me institucionet e ndryshme për shfrytëzim sa më të mirë të burimeve administrative;
- Rishikimi i përmbajtjes aktuale të Memorandumeve të Bashkëpunimit me Ministrinë e Financave dhe institucioneve të saj vartëse (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, etj); propozime për një Memorandum Bashkëpunimi me Autoritetin e Mbikëqyrjes financiare;
- Studime të vazhdueshme mbi praktikën e ndjekur nga vendet e tjera.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Klasifikimi i njësive institucionale në sektorë institucionalë. Të gjitha njësitë ekonomike që operojnë në aktivitetin ekonomik do të analizohen dhe klasifikohen në sektorë institucional, duke u grupuar në:
 - ✓ Njësitë Jofinanciare
 - ✓ Njësitë Financiare
 - ✓ Qeveria
 - ✓ Familjet
 - ✓ Institucionet Jofitimprurëse në shërbim të familjeve;
- ✓ Vlerësimi i treguesve përkatës të Llogarisë së Prodhimit sipas sektorëve Institucionalë: Prodhimi (tregtar, për përdorim vetjak, prodhim jotregtar), Konsumi Ndërmjetës, Taksat mbi produktet, Subvencionet mbi produktet dhe Vlera e Shtuar. Vlerësimet do të bëhen me çmime korrente;
- ✓ Vlerësimi i treguesve përkatës të Llogarisë së të ardhurave sipas sektorëve Institucionalë: Kompensimi i punonjësve, taksat mbi prodhimin dhe importet, subvencionet dhe teprica bruto operative me çmime korrente;

- ✓ Përgatitja e një publikimi ku do të përmbahen rezultatet, metodologjia dhe disa analiza për sektorët institucionalë.

Moduli 2.01.03 LLOGARITË KOMBËTARE					
Llogaritë Vjetore të Sektorëve Institucionalë					
Treguesit	Viti				
	2012	2013	2014	2015	2016
LLOGARIA E PRODHIMIT sipas sektorëve institucional			2012	2013	2014
LLOGARIA E TË ARDHURAVE sipas sektorëve institucional			2012	2013	2014

Burimet e informacionit

Llogaritë e sektorëve Institucionalë bazohen kryesisht në Llogaritë vjetore të njësisive institucionale ekonomike (Jofinanciare, Financiare, Qeveria, Familjet, institucionet jofitimprurëse në shërbim të familjeve, Familjet), statistikat e pagave, statistikat e Bilancit të Pagesave, etj.

INSTAT, Ministria e Financave, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Banka e Shqipërisë janë kryesisht furnizuesit kryesorë të informacionit për përpilimin e llogarive sektoriale. Për fusha të pambuluara me informacion, është e nevojshme të mbështetemi në vlerësime të ndryshme me origjinë burime administrative, vrojtme statistikore, studime, etj.

Burimi kryesor i marrjes së informacionit i referohet regjistrimeve të përgjithshme, vrojtmeve statistikore mbi familjet, ndërmarrjet, arkivave statistikore e administrative, me qëllim të përfshirjes dhe integritit të të gjitha burimeve ekzistuese në dispozicion.

2.01.03.01 Administrata Publike

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT-i përpunon të dhëna të cilat mblidhen në rrugë administrative nga Ministria e Financave, Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH), Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor (ISKSH), mbi informacionet kryesore të strukturës së shpenzimeve dhe të ardhurave të sektorit të administratës publike. Këto të dhëna përdoren për vlerësimin e PBB-së sipas metodave të prodhimit e shpenzimeve, nëpërmjet vlerësimit të treguesve të mëposhtëm:

- Prodhimi, Konsumi Ndërmjetës dhe Vlera e shtuar e administratës publike, aktivitetit të arsimit, shëndetësisë (pjesa buxhetore) me çmime korrente e konstante;
- Konsumi final i administratës publike, me çmime korrente e konstante, i ndarë në konsum individual dhe kolektiv;
- Llogaritja e taksave mbi produktet, me çmime korrente dhe konstante;

- Llogaritja e subvencioneve mbi produktet me çmime korrente dhe konstante.

Objektivat Strategjikë

Objektivi kryesor i statistikave të Administratës Publike është të ndërtojë statistika krahasuese, të besueshme dhe të përshtatshme duke prodhuar informacione mbi treguesit ekonomikë të sektorit të Administratës Publike në periudha vjetore si dhe periudha tremujore. Ato japin një panoramë të plotë të treguesve makroekonomikë të sektorit të administratës publike. Gjithashtu, pjesë e përmirësimeve të sektorit të administratës publike, në kuadrin e projektit IPA 2007 Kombëtar, është ndërtimi i të gjitha llogarive të Administratës Publike. Kjo do të ndihmojë në krijimin e një strukture më të plotë të informacionit makroekonomik të Administratës Publike. Puna për grumbullimin, miratimin dhe diseminimin e të dhënave mbi administratën publike si dhe përcaktimi dhe zhvillimi i indikatorëve, do të organizohen sipas Programit të Ri të Statistikave Zyrtare 2012-2016.

Ky objektivi do të sigurohet nëpërmjet:

- Forcimit të marrëdhënieve institucionale me ministritë e linjës dhe institucionet e tjera prodhuese të burimeve administrative (Ministria e Financave, ISSH, ISKSH, etj.);
- Forcimit të kapaciteteve në INSTAT për prodhimin dhe përmirësimin e statistikave ekzistuese;
- Ndërtimit të një grupi pune INSTAT=Ministria e Financave për përcaktimin e sektorëve dhe nënsektorëve të Administratës Publike, listën nominative të institucioneve përbërëse përkatëse në administratën publike qendrore dhe lokale, kodifikimin e klasifikimit ekonomik kontabël drejt kodifikimeve bazuar në kërkesat e Sistemit Evropian të Llogarive (ESA).

Aktivitetet zbatuese

- Klasifikimi i sektorëve dhe nënsektorëve të Administratës Publike sipas standardeve të ESA 95;
- Implementimi dhe përmirësimi i nomenklaturave të nevojshme midis INSTAT dhe Ministrisë së Financave;
- Informacione të detajuara për strukturën e Klasifikimit Ekonomik Kontabël të përdorur nga Ministria e Financave;
- Ristrukturimi i artikujve të Klasifikimit Ekonomik Kontabël sipas Sektorëve Institucionalë me të cilat janë krijuar këto transaksione;
- Ndërtimi i një kalendari për transmetimin e të dhënave nga Ministria e Financave drejt INSTAT-it;
- Ndërtimi i një strukture eksperimentale vjetore të serisë së plotë të llogarive jo-financiare të qeverisë;

- Përmirësimi i të dhënave aktuale për vlerësimin e treguesve ekonomikë të ISSH dhe ISKSH, si dhe detajimin e transfertave të kryera ndaj popullatës, me burime shtesë administrative;
- Përmirësimi i metodave të vlerësimit të Formimit Bruto të Kapitalit Fiks për sektorin e Administratës Publike;
- Përmirësim sasior dhe cilësor i treguesve statistikorë të Administratës Publike

Rezultatet e pritshme

- ✓ Ndërtimi i serisë së plotë të llogarive të sektorit institucional të Administratës Publike;
- ✓ Ndërtimi i treguesve të Llogarive Kombëtare vjetore e tremujore të Administratës Publike;
- ✓ Vlerësimi i Taksave dhe Subvencioneve mbi produktet në nivel vjetor dhe tremujor;
- ✓ Integrimi i treguesve të sektorit të Administratës Publike me sektorët e tjerë Institucionalë;

Burimet e informacionit

Institucionet e përfshira në sigurimin e informacionit statistikor për hartimin e statistikave të treguesve të Llogarive Kombëtare të Administratës Publike (Qeverisë qendrore dhe lokale) janë Ministria e Financave, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Burimet kryesore të informacionit janë të ardhurat si dhe shpenzimet e subjekteve të Administratës Publike, e strukturuar sipas standardeve kontabël të qeverisë. Burime të tjera informacioni janë të përbëra nga të dhënat administrative të numrit të punonjësve në administratën publike si dhe të dhënat për transfertat ndaj popullatës që kryhen nga institucionet e ISSH dhe ISKSH.

Moduli 2.01.04 Tabelat burime-përdorime dhe tabelat *input-output*

Përshkrimi i situatës aktuale

Aktualisht INSTAT po punon për vlerësimin dhe ndërtimin e tabelave sintezë të ekonomisë, siç janë tabela e burim-përdorimeve (SUT) dhe tabela *input-output* (IOT). Theksojmë se këto vlerësime janë vetëm në hapat e para të tyre në trajtë eksperimentale për vitet 2008 dhe 2009. Objektivi është që, në kuadër të projektit Kombëtar IPA 2007, të arrihet një vlerësim i mirë për vitin 2009, i cili është konsideruar dhe si një vit që do të sigurojë një informacion më të plotë me të dhëna

ekonomike. Deri tani janë përpiluar dhe ndërtuar SUT me çmime korrente në nivel detajimi 25 degë x 25 degë për vitet 2008 dhe 2009, të pabalancuara, mbështetur mbi informacionin ekzistues. Janë ndërtuar SUT me çmime konstante në nivel 25 degë x 25 degë të pabalancuara për vitin 2009. Për këto vlerësime, objektivi kryesor ishte gjetja dhe mbledhja e indekseve përkatëse për secilin agregat të SUT si dhe analiza për të vlerësuar mundësinë e përdorimit të tyre.

Objektivat Strategjikë

Objektivi parësor është që të mblidhet, verifikohet dhe analizohet një grup i madh treguesish ekonomik, me qëllim ndërtimin e tabelave burime-përdorime (shkurt SUT-Termi Angl.) dhe input-output (shkurt IOT-Termi Angl.), për të bërë të mundur sintezën e plotë të sistemit të llogarive kombëtare. Këto tabela japin portretin më të detajuar të ekonomisë, pasi paraqesin hap pas hapi një analizë të detajuar të procesit të prodhimit dhe përdorimit të mallrave dhe shërbimeve dhe të ardhurave të krijuara.

Aktivitetet zbatuese

- Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit mbi marrjen e të dhënave në nivel të detajuar lidhur me librat e shitjeve dhe të blerjeve ndërmjet INSTAT-it dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;
- Propozime për ndryshimin e strukturës së mbledhjes së informacionit për përbërjen e kostos nga Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve (ASN). Është e nevojshme që informacioni të merret në nivel nomenklature CPA 2008;
- Përpunimi i të dhënave mbi importet dhe eksportet e mallrave në nivel nomenklature (*Combined Nomenclature* CN) dhe kalimi i tyre në nivel nomenklature CPA 2002, 6, 4 dhe 2 shifror si dhe në nivel alfabetik 2 shifror;
- Mbledhje më të detajuar të të dhënave mbi importet dhe eksportet e shërbimeve të vlerësuara nga Banka e Shqipërisë dhe grupimi i tyre sipas klasifikimeve ekonomike;
- Grupimi i të dhënave të dala nga vrojtimi statistikor mbi buxhetin e familjeve (Termi Angl. HBS) nga niveli i detajuar i nomenklaturës COICOP në klasifikimin CPA 2002;
- Kalimi i vlerësimeve nga versionet e vjetra të nomenklaturave në versionet e reja si: NVE rev1.1 në NVE rev.2; CPA 2002 në CPA 2008, etj.
- Mbledhje e informacionit me anë të anketave ekzistuese pranë ndërmarrjeve ose nëpërmjet anketave të reja për shpërndarjen e marzhit të tregtisë me pakicë dhe shumicë si dhe të marzhit të transportit;
- Përdorim i informacionit të marrë nga anekset e pasqyrave financiare për ndërmarrjet që operojnë në sektorë që nuk janë të mbuluar nga anketa strukturore pranë ndërmarrjeve.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Vlerësime në nivele 13 degë x 13 degë të tabelave burim-përdorim me çmime korrente;
- ✓ Vlerësime në nivele 13 degë x 13 degë të tabelave burim-përdorim me çmime konstante;
- ✓ Vlerësime në nivele 25 degë x 25 degë të tabelave burim-përdorim me çmime korrente;
- ✓ Vlerësime në nivele 25 degë x 25 degë të tabelave burim-përdorim me çmime konstante;
- ✓ Vlerësime në nivele 60 degë x 60 degë të tabelave të burime-përdorime me çmime korrente;
- ✓ Vlerësime në nivele 60 degë x 60 degë të tabelave të burime-përdorime me çmime konstante;
- ✓ Vlerësim të tabelave input-output në nivele 25 degë x 25 degë.

Treguesit	VITI				
	2012	2013	2014	2015	2016
Tabela e burimeve dhe e përdorimeve me çmime korrente (13x13)		2009 dhe 2010			
Tabela e burimeve dhe e përdorimeve me çmime korrente (25x25)			2011	2012	2013
Tabela e burimeve dhe e përdorimeve me çmime konstante (13x13)		2010			
Tabela e burimeve dhe e përdorimeve me çmime konstante (25x25)			2011	2012	2013
Tabela input-output (25x25)			2011	2012	2013

Burimet e informacionit

Duke qenë se ndërtimi i tabelave burim-përdorim dhe input-output kërkon një informacion mjaft të gjerë dhe të hollësishëm, është shumë e nevojshme që edhe institucionet e tjera prodhuese të të dhënave, apo sektorët e INSTAT dhe të drejtorisë së Llogarive Kombëtare, të përfshihen në kuadër të këtyre kërkesave. Ndër institucionet më kryesore të cilët konsiderohen si burime informacioni, përmendim Ministrinë e Financave, Bankën e Shqipërisë, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Moduli 2.01.06 Llogaritë rajonale

Përshkrimi i situatës aktuale

Aktualisht INSTAT vlerëson dhe publikon PBB-në², me metodën e prodhimit, sipas Nomenklaturës së Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS II). Të dhënat e PBB-së janë të grupuara sipas degëve kryesore të ekonomisë, të shprehura edhe në termat e Paritetit të Fuqisë Blerëse (PPS) i cili merr në konsideratë diferencat e çmimeve në Bashkimin Evropian. Sigurimi i vlerësimit të këtij treguesi erdhi si përmbushje e detyrimeve të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit si dhe në përputhje me detyrimet e sanksionuara në nenin 37 të Marrëveshjes së Përkohshme (Neni 71 i MSA)³. Statistikat Rajonale sigurojnë informacion statistikor në nivel rajonal, në periudhë vjetore.

Në 28 Prill 2011 EUROSTAT konfirmoi propozimin e Institutit të Statistikave, të aprovuar me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave⁴, për përcaktimin e 3 rajoneve statistikore (niveli 2) dhe 12 rajone statistikore (niveli 3). Përcaktimi i rajoneve statistikore për Shqipërinë është në përputhje me rregulloren e Komisionit Evropian nr 1059/2003 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Evropës më datë 26 maj 2003 mbi vendosjen e klasifikimit të përbashkët të njësive territoriale për statistikat (NUTS). Prodhimi i statistikave rajonale ekonomike ka rëndësi të madhe në marrjen e vendimeve të rëndësishme në nivel kombëtar por edhe në politikën rajonale të BE - së për shpërndarjen e fondeve strukturore për zhvillim.

Objektivi Strategjik

Objektivi kryesor i statistikave rajonale është vlerësimi në përputhje me metodologjinë e ESA95, të treguesit të PBB për frymë sipas Nomenklaturës të Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS II) të Bashkimit Evropian. Në planin strategjik, synohet zgjerimi i mëtejshëm i treguesve të Llogarive Rajonale, kryesisht në vlerësimin e treguesve rajonalë dhe të treguesve të Formimit Bruto të Kapitalit Fiks, të Vlerës së Shtuar Bruto, duke përdorur metodën e të ardhurave sipas rajoneve, si dhe ndërtimit të Llogarive të sektorit institucional të popullsisë (familjeve) sipas rajoneve statistikore.

Aktivitetet zbatuese

Realizimi i objektivave të mësipërme do të arrihet duke:

² Publikimi i parë i PBB rajonale u realizua nga INSTAT në muajin Shtator 2011.

³ Shqipëria duhet t'i paraqesë Komisionit Evropian shifrat e PBB-së së saj për frymë të harmonizuar në nivelin NUTS II.

⁴ Vendimi i KM nr.1037 date 15.12.2010, "Mbi Implementimin e Nomenklaturës "Shqipëria në 3 (tri) rajone NUTS II" sipas nomenklaturës mbi Njësitet Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Evropian"

- Përmirësuar burimet e të dhënave. Vëmendje do ti kushtohet përgatitjes për rishikimin e serive kohore me të dhëna të dala nga Regjistrimi i Përgjithshëm i Njësive Ekonomike Jobujqësore;
- Propozuar zgjerimin e Anketës Strukture të Ndërmarrjeve për informacione të detajuara për njësitë lokale, pagat, punësimin, aktivitetin ndërtimor, etj;
- Bashkëpunuar me agjencitë statistikore që lidhen me institucionet financiare, si Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për marrjen e të dhënave më të detajuara rajonale për vlerësimin e sektorit financiar, alokimin e treguesit të Shërbimeve të Ndërmjetësimit Financiar matur Indirekt (shkurt FISIM-Termi Angl.) sipas rajoneve statistikore;
- Konsoliduar dhe detajuar të dhënat rajonale të marra nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave mbi detajimin e të dhënave sipas prefekturave;
- Bashkëpunuar me zyrat rajonale statistikore mbi përpunimin e informacionit statistikor.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Vlerësim i treguesve rajonalë duke përdorur të dhënat e Census-Al 2011, nga i cili do të sigurohen të dhëna të punësimit sipas sektorëve si dhe do të shërbejë si një bazë krahasuese me të dhënat aktuale;
- ✓ Shpërndarje e treguesit të Vlerës së Shtuar Bruto sipas rajoneve statistikore për sektorin e Bujqësisë dhe Peshkimit me të dhënat e marra nga Censusi i Bujqësisë 2012;
- ✓ Vlerësim i PBB-së sipas rajoneve statistikore, niveli 2 dhe 3, dhe degëve kryesore të ekonomisë në seri kohore;
- ✓ Vlerësim i PBB-së për frymë sipas rajoneve statistikore, niveli 2 dhe 3, si dhe të shprehura në termat e Paritetit të Fuqisë Blerëse (PPS).

Burimet e informacionit

Vlerësimi i Llogarive Rajonale bazohet në burimet e disponueshme të të dhënave pranë INSTAT-it, ku përfshihen: burime statistikore dhe burime administrative. Llogaritë Rajonale në Republikën e Shqipërisë bazohen në të njëjtat koncepte të ESA 95 si dhe me klasifikimet e NVE Rev 1.1 respektivisht.

Institucionet e tjera të përfshira në sigurimin e informacionit statistikor janë: Ministria e Financës, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, etj. të përfshira në mbledhjen e të dhënave administrative dhe statistikore për treguesit rajonalë.

Tema 2.02. Llogaritë Kombëtare tremujore

Përshkrimi

Llogaritë Kombëtare tremujore luajnë një rol të rëndësishëm për analizën ekonomike të vendit dhe ndikojnë në veçanti për përcaktimin e politikave ekonomike, monetare, etj. Të dhënat e llogarive kombëtare tremujore janë gjithashtu të rëndësishme për përdoruesit e tjerë të rëndësishëm publikë, privatë, studiues të ndryshëm, etj. Për të plotësuar nevojat e përdoruesve, rëndësi e madhe i kushtohet cilësisë dhe afateve kohore. Llogaritë Kombëtare Tremujore përfshijnë treguesit kryesorë, të vlerësuar mbi bazën e Rregullores së Këshillit (BE) Nr. 2223/96 (*Council Regulation* (EC) No 2223/96) amenduar së fundi nga Rregullorja (BE) Nr. 400/2009 (*Regulation* (EC) No 400/2009). Përdoruesit kryesorë janë Qeveria, Ministria e Financave, Ministritë teknike, Banka e Shqipërisë, Eurostat, tregjet financiare, analistët, media dhe publiku i gjerë.

Moduli 2.02.01 Llogaritë kombëtare tremujore

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT aktualisht kryen vlerësimin sipas metodës indirekte dhe publikimin periodik në nivel kombëtar të PBB-së me çmime bazë (nuk përfshihen taksat dhe subvencionet), sipas metodës të prodhimit, me çmime konstante, viti bazë 2005=100, dhe me çmimet e vitit të mëparshëm, duke përdorur metodën Chain-link (Annual overlap technique). PBB tremujor publikohet në seri kohore sipas 7 degëve kryesore të ekonomisë të përshtatura dhe jo sezonalisht. Një sërë studimesh dhe punimesh eksperimentale janë kryer për vlerësimin dhe përcaktimin e burimeve të të dhënave si dhe aplikimin e metodikave të rekomanduara për vlerësimin e PBB-së edhe me metodën e shpenzimeve.

Objektivi Strategjik

Llogaritë Kombëtare Tremujore kanë si objektivi kryesor vlerësimin dhe publikimin e PBB-së tremujore me mënyrën e shpenzimeve sipas komponentëve përkatës si dhe vazhdimin e publikimit të treguesve ekzistues, duke përmirësuar cilësinë e llogaritjes së tyre si dhe shtimin e disa treguesve të tjerë, në përputhje të plotë me konceptet e ESA95 dhe SNA93 si dhe legjislacionin e BE-së. Vlerësimet e këtyre treguesve do të bëhen duke synuar përmirësimin e metodave ekzistuese dhe potenciale për vlerësimin sa më të mirë në përputhje me kërkesat e manualëve të

ndryshëm ku bazohen këto vlerësime, si: (i) Eurostat, ESA 1995; (ii) FMN, SNA 1993; (iii) Eurostat, *Handbook on Quarterly National Accounts*, 1999; (iv) FMN, *Quarterly National Accounts Manual*.

Aktivitetet zbatuese

Objektivat e mësipërme do të sigurohen nëpërmjet:

- Forcimit të marrëdhënieve institucionale me Ministrinë e Financave (përfshirë institucionet vartëse), Bankën e Shqipërisë, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, ministritë e tjera linjës si dhe me institucione e kompani të tjera të rëndësishme (ISKSH, KESH, etj), për sigurimin në kohë dhe me cilësi të informacionit;
- Implementimit të vazhdueshëm të metodologjive të rishikuara të llogaritjes së PBB-së tremujore, mbështetur në manualet dhe rregulloret e vazhdueshme që miraton Eurostat-i si dhe sipas rekomandimeve të ekspertëve që asistojnë në kuadër të misioneve të projektit IPA 2007 dhe FMN;
- Implementimit të mënyrave më të avancuara të grumbullimit dhe kontrollit të informacionit për të qenë koherent dhe të saktë në llogaritjen e treguesve, duke bërë të mundur të qenit sa më afër plotësisht të kërkesave të përdoruesve të ndryshëm;
- Përmirësimit të vazhdueshëm të ecurisë së punës në drejtimin e mbledhjes dhe kontrollit të të dhënave, vlerësimit dhe publikimit të serisë kohore të PBB-së vlerësuar me mënyrën e prodhimit, me çmime konstante vit bazë 2005 (2005=100) dhe të vitit të mëparshëm, duke përdorur metodat statistikore mbështetur në metodologjinë përkatëse;
- Analizës së deflatorëve të përdorur për llogaritjen e PBB-së tremujore me çmime konstante me metodën e prodhimit;
- Analizës, vlerësimit dhe përzgjedhjes së burimeve të të dhënave që do përdoren për llogaritjen e PBB-së tremujore me metodën e shpenzimeve si dhe përcaktimit të metodologjisë bazuar në këto të dhëna.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Vlerësimi dhe publikimi i komponentëve të PBB-së me metodën e shpenzimeve, si: Konsumi individual i popullsisë, Konsumi i Administratës Publike i ndarë në konsum individual dhe kolektiv, Konsumi i Institucioneve Jofitimprurëse, Formimi Bruto i Kapitalit Fiks, Eksportet neto, Ndryshimi i gjendjeve me çmime korrente dhe konstante;
- ✓ Përmirësimi i vlerësimit të PBB-së me metodën e prodhimit me çmime korrente;

- ✓ Vlerësim eksperimental në nivel më të detajuar të PBB-së në vitet në vazhdim, nga niveli aktual i llogaritjeve me 25 degë në 60 degë me çmime korente dhe konstante;
- ✓ Përmirësimi i procesit të përshtatjeve sezonale të serive kohore;
- ✓ Vlerësimi i taksave dhe subvencioneve mbi produktet

Treguesit	VITI				
	2012	2013	2014	2015	2016
Vlerësimi i PBB-së me metodën e prodhimit me çmime korente të pa zhveshura nga efektet sezonale në 7 degë		2013	2013 dhe 2014		
Vlerësimi i PBB-së me metodën e prodhimit me çmime korente të pa zhveshura nga efektet sezonale në 25 degë				2014 dhe 2015	2015 dhe 2016
Përfshirja e taksave dhe subvencioneve në vlerësimin e PBB-së me metodën e prodhimit.		2013	2013 dhe 2014	2014 dhe 2015	2015 dhe 2016
Vlerësimi i PBB-së me metodën e prodhimit me çmime korente me efektet sezonale në 7 degë				2014 dhe 2015	2015 dhe 2016
Vlerësimi i PBB-së me metodën e prodhimit me çmime konstante të pa zhveshura nga efektet sezonale në 25 degë				2014 dhe 2015	2015 dhe 2016
Vlerësime te PBB metoda shpenzimeve me çmime korrente		2007-2012	2013 dhe 2014	2014 dhe 2015	2015 dhe 2016
Vlerësime te PBB metoda shpenzimeve me çmime konstante		2007-2012	2013 dhe 2014	2014 dhe 2015	2015 dhe 2016

Burimet e informacionit

Institucionet kryesore të përfshira në sigurimin e informacionit statistikor për vlerësimin e këtyre treguesve janë:

- Ministria e Financave (të dhëna mbi buxhetin e shtetit);
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), (të dhënat që deklarojnë subjektet ne formularin e pagesës së TVSH, etj);
- Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (të dhëna për sektorin Bujqësor);
- Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (të dhëna për aktivitetin financiar dhe për vlerësimin e Shërbimit të Ndërmjetësuesve Financiar të Matura Indirekt (FISIM));

- Enti Rregullator i Energjetikes dhe KESH (të dhëna për sektorin energjitik);
- Sektorë të ndryshëm në INSTAT.

Tema 2.03 Statistikat monetare dhe financiare

Objektivat dhe produktet e Bankës së Shqipërisë si agjenci statistikore parashikohen në planet vjetore të punës, në strategjitë afatmesme (3-vjeçare) të Bankës së Shqipërisë dhe në Programin Afatmesëm të Statistikave Zyrtare. Marrëdhëniet midis Bankës së Shqipërisë dhe agjencive të tjera statistikore për dhënien dhe marrjen e të dhënave të përpunuara, parashikohen në Programin Afatmesëm të Statistikave Zyrtare.

Banka e Shqipërisë është përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin, hartimin dhe shpërndarjen e statistikave monetare. Ajo është agjencia e vetme në Shqipëri që prodhon dhe shpërndan statistika monetare dhe financiare. Korniza metodologjike për hartimin e statistikave monetare është në përputhje të plotë me rekomandimet e Manualit të Statistikave Monetare dhe Financiare (MFSM) të FMN, 2000. Konceptet, përkufizimet, sektorizimi dhe klasifikimi i instrumenteve financiarë është në përputhje të plotë me Manualin dhe Sistemin e Llogarive Kombëtare (SNA,1993). Në përgatitjen e statistikave monetare, Banka e Shqipërisë punon në vazhdimësi në dy drejtime themelore: (a) përmirësimin dhe përafrimin e metodologjive përkatëse me normat dhe standardet ndërkombëtare dhe (b) zgjerimin dhe përmirësimin e bazës së informacionit statistikor në drejtim të shtimit të numrit të treguesve, nivelit të disagregimit, kohëvonesës së publikimit dhe periodicitetit.

Deri në fund të vitit 2011 Banka e Shqipërisë ka plotësuar të gjitha kërkesat e SDDS-it për statistikën e sektorit monetar në drejtim të mbulimit, periodicitetit dhe kohëvonesës. Statistikat monetare prodhohen në frekuencë mujore, me një kohëvonesë mujore dhe mbulojnë korporatat depozituese. Statistikat monetare publikohen në faqen e Bankës së Shqipërisë sipas kalendarit paraprak të publikimeve, në Raportin Statistikor Mujor (në CD) si edhe në shtojcat e statistikore të përfshira në publikime periodike të Bankës së Shqipërisë si Raporti Tremujor i Politikës Monetare, Deklaratat Gjashtëmujore dhe Raporti Vjetor i Bankës së Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë e realizon prodhimin statistikor nëpërmjet Departamentit të Statistikave, i cili ka një personel prej 26 personash dhe është i ndarë në Sektorin e Statistikave Monetare dhe Financiare dhe Sektorin e Bilancit të Pagesave. Drejtori i Departamentit të Statistikave të Bankës së Shqipërisë është njëkohësisht anëtar i Këshillit të Statistikave. Departamenti i Statistikave të Bankës

së Shqipërisë është përgjegjës për mbledhjen e informacionit nga subjektet raportuese, hartimin dhe miratimin e metodologjisë përkatëse, hartimin dhe vënien në përdorim të formave të raportimit, përpunimin e informacionit dhe shpërndarjen e statistikave monetare dhe statistikave të sektorit të jashtëm. Departamenti i Statistikave gjithashtu prodhon statistika të detajuara të mbikëqyrjes bankare në shërbim të funksionit të Bankës së Shqipërisë për mbikëqyrjen e sistemit bankar dhe ruajtjen e stabilitetit financiar.

Moduli 2.03.01 Llogaritë financiare – Metodologjia

Përshkrimi i situatës aktuale

Aktualisht, në kushtet e mungesës së Sistemit të Llogarive nuk hartohen Llogaritë Financiare (Shih Llogaritë Kombëtare – INSTAT).

Objektivat strategjikë

Sfida afatgjatë në drejtim të prodhimit të statistikave monetare dhe financiare është ngritja e strukturës, hartimi i metodologjisë, identifikimi i burimeve, dhe prodhimi i statistikave të Llogarive Financiare, të cilat aktualisht nuk mbulohen nga asnjë agjenci statistikore në vend.

Aktivitetet zbatuese

- Hartimi i akteve nënligjore në drejtim të mbështetjes së objektivit strategjik.
- Përmirësimi i kapaciteteve njerëzore nëpërmjet pjesëmarrjes në seminare, kurse trajnimi të ofruara nga institucione kombëtare e ndërkombëtare dhe vizita pune në institucione homologe.
- Forcimi i bashkëpunimit me agjencitë e tjera statistikore, përdoruesit dhe subjektet raportuese nëpërmjet aktiviteteve dhe projekteve të përbashkëta.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Ngritja e modelit pilot dhe dokumenteve metodologjike për ndërtimin e llogarisë financiare të institucioneve monetare financiare dhe institucioneve të tjera financiare.

Moduli 2.03.02 Llogaritë financiare – Prodhimi i të dhënave

Shih “Moduli 2.03.01 – Llogaritë financiare – Metodologjia”

Moduli 2.03.03 Treguesit monetarë dhe financiarë

Përshkrimi i situatës aktuale

Banka e Shqipërisë prodhon dhe publikon treguesit monetarë me frekuencë mujore dhe tremujore, që lidhen me agregatët monetarë, depozitat, kreditë, normat e interesit, kursin e këmbimit si dhe bilancet sektorialë dhe paraqitjet monetare, duke ndjekur rigorozisht kalendarin e statistikave të paraqitur në faqen zyrtare të BSH.

Për përgatitjen e statistikave monetare e financiare si burim informacioni shërbejnë pasqyrat financiare të Bankës së Shqipërisë, sistemi raportues i unifikuar për bankat para-depozituese dhe sistemi raportues për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre.

Për hartimin e të dhënave të Bankës Qendrore, shërben Bilanci Kontabël i Bankës së Shqipërisë, i cili përgatitet çdo muaj nga Departamenti i Kontabilitetit dhe Financës, jo më vonë se 10 ditë pas periudhës reference.

Për hartimin e statistikave monetare shërbejnë pasqyrat e sistemit raportuese që bankat para-depozituese raportojnë periodikisht çdo muaj, 10 ditë pas periudhës reference, pranë BSH. Gjithashtu, shoqëritë e kursim-kreditit raportojnë pranë Bankës së Shqipërisë çdo tremujor, 50 ditë pas periudhës reference.

Për statistikave monetare, parimet e vlerësimit të instrumenteve financiarë ndjekin rekomandimet e Manualit të Statistikave Monetare e Financiare, FMN 2000. Regjistrimet kontabël të Bankës së Shqipërisë dhe bankave tregtare bëhen në bazë të kontabilitetit rrjedhës (*accrual basis*). Interesi i arkëtueshëm dhe i pagueshëm i instrumenteve financiarë, klasifikohet sipas sektorit dhe kategorisë së instrumentit. Edhe shoqëritë e kursim-kreditit i realizojnë regjistrimet kontabël sipas kontabilitetit rrjedhës, më përjashtim të huave, të cilat raportohen mbi baza cash-i (*cash basis*).

Të dhënat e bankës qendrore publikohen çdo muaj, në ditën e15-të pas muajit reference. Ndërsa, të dhënat e bankave para depozituese publikohen çdo muaj, në ditën e 30-të të muajit, pas periudhës reference. Të dhënat e shoqërive të kursim-kreditit publikohen çdo tremujor, dy muaj pas periudhës reference.

Objektivat strategjikë

- Zgjerimi i mbulimit të agjencive të tjera raportuese, duke përfshirë në prodhimin e rregullt statistikor institucionet financiare jo-banka.
- Shtimi i numrit të treguesve të rinj statistikorë, në përputhje me kërkesat dhe standardet e raportimit të Institucioneve përkatëse Evropiane (ECB, EUROSTAT, etj.).

Aktivitetet zbatuese

- Hartimi i akteve nënligjore në drejtim të mbështetjes së objektivave strategjike e për të lehtësuar procesin e përmirësimit të prodhimit statistikor si në drejtim të rritjes së mbulimit të agjencive të tjera raportuese, ashtu dhe në drejtim të shtimit të numrit treguesve të tjerë statistikorë.
- Përmirësimi i kapaciteteve teknologjike nëpërmjet automatizimit të infrastrukturës së mbledhjes, kontrollit, validimit e kompilimit të statistikave monetare e financiare.
- Përmirësimi i kapaciteteve njerëzore nëpërmjet pjesëmarrjes në seminare, kurse trajnimi të ofruara nga institucione kombëtare e ndërkombëtare dhe vizita pune në institucione homologe.
- Forcimi i bashkëpunimit me agjencitë e tjera statistikore, përdoruesit dhe subjektet raportuese nëpërmjet aktiviteteve dhe projekteve të përbashkëta.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Përgatitja dhe shpërndarja e tabelave statistikore për institucionet financiare jo banka, duke plotësuar spektrin e nën-sektorëve të sektorit të korporatave financiare.
- ✓ Përgatitja dhe shpërndarja e treguesve të rinj monetarë e financiarë, mbështetur në metodologjitë dhe standardet ndërkombëtare.
- ✓ Akte nënligjore në mbështetje të zgjerimit të mbulimit statistikor dhe rritjes së numrit të treguesve monetarë e financiarë.

Tema 2.04 Statistikat financiare të qeverisë

Ministria e Financave në Republikën e Shqipërisë është përgjegjëse për përgatitjen e raporteve të të ardhurave dhe shpenzimeve për administratën e qeverisjes së përgjithshme në Republikën e Shqipërisë. Raportet e të ardhurave dhe shpenzimeve prodhohen për konsolidimin e buxhetit të qeverisjes në nivel lokal dhe qendror.

Tabelat fiskale aktualisht ndjek pjesërisht GFSM2001 – llogaritë përpilohen mbi një bazë të modifikuar *accrual* (të detyrimeve dhe të drejtave të konstatuara) dhe gjerësisht ndjekin klasifikimin ekonomik GFSM2001.

Tabelat e shpenzimeve përpilohen mbi bazën e GFOG. Asetet fikse vlerësohen nga kosto historike dhe huatë e obligacionet regjistrohen me vlerën korrente. Tabelat fiskale përpilohen çdo muaj. Tashmë një sistem raportimi financiar po zbatohet në të gjitha degët e Thesarit. Sistemi i ri është operacional që nga muaji Shtator 2010.

Sistemi i ri përfshin llogaritë me bazë *accrual* dhe *cash* (te likuiditetit) dhe transaksionet në planin kontabël (*chart of accounts*) të llogarive janë sipas klasifikimit ekonomik të GFS2001. Në sistem është aplikuar dhe një klasifikim i përmbledhur i funksioneve (10 funksioneve) të qeverisjes (COFOG).

Statistikat financiare të qeverisë mbulojnë të dhënat financiare dhe jo-financiare lidhur me shpenzimet, të ardhurat dhe financimet qeveritare. Këto të dhëna raportohen mbi një frekuencë mujore, tremujore dhe vjetore, publikohen të detajuara çdo muaj për përdorues të ndryshëm dhe aprovohen nga Parlamenti çdo vit.

Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë kanë rolin kryesor në vlerësimin e defiçitit të përgjithshëm qeveritar dhe në vlerësimin e borxhi qendror të qeverisë.

Moduli 2.04.01 Statistikat financiare të qeverisë – Metodologjia

Përshkrimi i situatës aktuale

Ministria e Financave e Shqipërisë përgatit pasqyrat financiare të Qeverisë mbi një bazë “accrual” të modifikuar, e cila përputhet pjesërisht me GFSM2001.

Statistikat përfshijnë konsolidimin e detajuar të qeverisjes së përgjithshme për:

- (i) njësitë e qeverisjes qendrore (njësitë publike te ekzekutivit, legjislativit dhe gjyqësorit te krijuara me ligj, përfshirë edhe njësitë shpenzuese të krijuar prej tyre).
- (ii) njësitë e qeverisjes vendore (13 rajone, 36 rrethe, 64 bashki dhe 318 komuna, duke përfshirë edhe njësitë shpenzuese të krijuar prej tyre).
- (iii) fondet speciale (Institutin e Sigurimeve Shëndetësore, Institutin e Kujdesit Shëndetësor dhe fondin e kompensimit te pronareve).

Objektivat strategjikë

- Gjenerimi i të dhënave statistikore sipas Manualit të vitit 2001 për statistikat financiare të qeverisë (GFS) të FMN-së;
- Hartimi i Bilancit Patrimonial të Shtetit në përputhje me standardet ndërkombëtare, të cilat do të implementohen gradualisht në vite.

Aktivitetet zbatuese

- Përmirësimin e akteve nënligjore mbi përpunimin e të dhënave financiare dhe raportimin statistikor;

- Përmirësimin e kapaciteteve njerëzore dhe teknologjike nëpërmjet investimit në trajnime mbi menaxhimin e të dhënave statistikore (sipas aplikimit në projektet e IPA 2013);
- Forcimi i bashkëpunimit midis agjencive statistikore dhe përdoruesve të statistikave zyrtare nëpërmjet aktiviteteve dhe projekteve të përbashkëta.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Akte nënligjorë të përmirësuara në fushën e kontabilitetit;
- ✓ Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduar të qeverisjes së përgjithshme sipas standardit IPSAS 1,2 dhe 24 (duke zbatuar kontabilizimin mbi bazën *accrual* të modifikuar);
- ✓ Tabelat sipas GFSM2001 mbi bazën *accrual* të modifikuar.

Moduli 2.04.02 Statistikat financiare të Qeverisë – Përgatitja e të dhënave

Përshkrimi i situatës aktuale

Njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore janë përgjegjëse me ligj për menaxhimin e fondeve publike dhe paraqesin fizikisht çdo ditë në Thesar dokumentacionin justifikues pas marrjes përsipër të angazhimit financiar dhe përpara pagesës së shpenzimeve. Thesari kryen kontrollet e nevojshme nëpërmjet regjistrimit në sistemin informatik financiar të qeverisë të të gjitha transaksioneve të ekzekutimit të buxhetit të qeverisjes së përgjithshme. Këto të dhëna janë të përpunueshme dhe të raportueshme në çdo kohë.

Çdo muaj përgatitet baza e të dhënave të qeverisjes së përgjithshme, duke përfshirë të dhënat sipas paragrafit të mësipërm dhe të dhënat e përfutuara nga importimi i raportimeve mujore të gjeneruar nga sistemi i tatimeve, doganave, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si të projekteve të financimeve të huaja në sistemin informatik financiar të qeverisë.

Të dhënat rakordohen me sistemet manuale për një periudhë kohore prej 10-20 ditësh pas përfundimit të muajit raportues. Raportimet statistikore raportohen në: (i) faqen zyrtare të Ministrisë së Financave (www.minfin.gov.al); (ii) Departamentin Evropian të FMN-së; (iii) në Bordin e Buletinit të Standardeve të Shpërndarjes (DSBB) të FMN sipas GDDS dhe (iv) Departamentin e Statistikave të FMN-së në formatin e Manualit GFSM86/2001 për tu publikuar në librin vjetor të statistikave financiare të qeverive të vendeve të ndryshme.

Objektivat strategjikë

- Integrimi i sistemeve të informacionit të qeverisjes së përgjithshme;

- Raportimi komprehensiv të pozicionit financiar të Qeverisë nëpërmjet aksesimit direkt (*online*) të të gjitha njësive të qeverisjes përgjithshme në sistemin informatik financiar të qeverisë (i cili sot aksesohet vetëm nga Thesari);
- Rritja e nivelit të sigurisë së arsyeshme që ofron sistemi informatik financiar i qeverisë për prodhimin e të dhënave të krahasueshme, të besueshme, transparente dhe objektive për mirëqeverisjen qendrore dhe lokale;
- Përmirësimi i niveleve të regjistrimit për të pasqyruar të gjitha fazat e mbledhjes së të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme.

Aktivitetet zbatuese

- Zgjerimi i sistemit informatik të qeverisë për regjistrimin e transaksioneve të ekzekutimit të buxhetit për të bërë të mundur aksesimin direkt të të gjitha njësive të qeverisjes së përgjithshme (nëpërmjet implementimit të projektit SETS të Agjencisë Austriake të Zhvillimit);
- Centralizimi i arkëtimit të të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme direkt në llogarinë e unifikuar të Thesarit në Bankën e Shqipërisë;
- Përmirësimi i procedurave të kontrollit ex-ante/ex-post (parandaluese dhe zbuluese) nëpërmjet implementimit të kërkesave të standardeve ndërkombëtare për kontrollin e brendshëm;
- Trajnim teknik të përdoruesve të sistemit financiar informatik të qeverisë.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Baza e përmirësuar dhe e kompletuar e të dhënave fiskale e detajuar sipas klasifikimit ekonomik, funksional dhe institucional për ofrimin e raporteve sipas standardeve të përcaktuara në modulin 2.04.01.

Moduli 2.04.03 Statistikat mbi deficitin dhe borxhin publik

a) Statistikat mbi Deficitin Publik

Ministria e Financave përgatit pasqyrën e përgjithshme të deficitit qeveritar. Pasqyrat përfshijnë konsolidimin e përgjithshëm qeveritar. Metodologjia e përdorur është e njëjtë me metodologjinë referuar në modulin e mësipërm. Të dhënat e defiçitit raportohen dhe publikohen siç përshkruhen më modulet e mësipërm.

b) Statistikat e Borxhit

Lidhur me statistikën e borxhit publik të Republikës së Shqipërisë, dy janë institucionet përgjegjëse: Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave.

Përshkrimi i situatës aktuale

Banka e Shqipërisë është përgjegjëse për përpilimin e statistikave të borxhit të jashtëm të vendit. Të dhënat për përpilimin e borxhit të jashtëm përpunohen në përputhje me standardet ndërkombëtare, të përshkruara në “Manuali i statistikave të bilancit të pagesave, edicioni i pestë” (FMN, 1993) dhe në “Statistikat e borxhit të jashtëm: Udhëzues për Përpiluesit e Përdoruesit”(FMN, 2003), duke siguruar pajtueshmëri dhe konsistencë midis statistikave të borxhit të jashtëm dhe atyre të bilancit të pagesave dhe pozicionit ndërkombëtar të investimeve.

Stoku i detyrimeve regjistrohet në vlerë nominale dhe jo në vlerë tregu dhe borxhi i jashtëm bruto i Shqipërisë raportohet në lekë. Për stokun e detyrimeve në monedha të tjera, konvertimi në lekë bëhet me kursin zyrtar të këmbimit të datës së fundit të periudhës së raportimit. Efekti i ndryshimit të kurseve të këmbimit përfshihet në vlerësimin e stokut të detyrimeve.

Klasifikimi kryesor i të dhënave të borxhit të jashtëm bruto bëhet sipas sektorëve institucionalë. Përbërësit e kësaj strukture janë Qeveria e Përgjithshme, Autoriteti Monetar, Bankat dhe Sektorë të tjerë. Qeveria e Përgjithshme përfshin qeverinë e përgjithshme qendrore dhe atë lokale. Burim i të dhënave për huatë e këtij sektori është Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit në Ministrinë e Financave.

Publikimi i borxhit të jashtëm bruto të Shqipërisë bëhet rregullisht mbi baza tremujore në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë, sipas Modullit të SDDS. Shqipëria është anëtare e Projektit të GDDS-së që prej vitit 1999. Metadatat (të dhënat e detajuara) e statistikave të prodhuara në Shqipëri janë botuar në Bordin e Buletinit të Standardeve të Shpërndarjes të FMN-së (DSBB). Që prej vitit 2006 Banka e Shqipërisë po koordinon punën midis të njëjtëve institucione për anëtarësimin në SDDS. Të dhënat e borxhit të jashtëm dërgohen rregullisht në frekuencë tremujore në bazën e të dhënave të Bankës Botërore – Statistika Tremujore të Borxhit të Jashtëm (*Quarterly External Debt Statistics database-QEDS*).

Ministria e Financave është përgjegjëse për regjistrimin dhe raportimin e të dhënave për borxhin e brendshëm dhe borxhin e jashtëm të Qeverisë së përgjithshme. Të dhënat e borxhit regjistrohen mbi baza ditore dhe publikohen rregullisht në baza tremujore në faqen e internetit të Ministrisë së Financave (www.minfin.gov.al).

Stoku i borxhit të brendshëm regjistrohet në vlerë nominale. Stoku i borxhit të brendshëm të emetuar në një monedhë të ndryshme nga monedha kombëtare, konvertohet në lekë me kursin e këmbimit të datës së fundit të periudhës së raportimit.

Krahas borxhit të brendshëm, Ministria e Financave regjistron dhe publikon edhe borxhin e jashtëm të Qeverisë Qendrore (ku përfshihet edhe borxhi i garantuar), si edhe borxhin e pushtetit lokal.

Regjistrimi i borxhit të jashtëm (të hyrat e borxhit dhe pagesat e tij) të Qeverisë Qendrore bëhet mbi baza ditore, ndërsa publikimi i tij në faqen e internetit të Ministrisë së Financave bëhet rregullisht mbi baza tremujore. Regjistrimi i borxhit të jashtëm bëhet në monedhën origjinale. Raportimi i stokut të borxhit të jashtëm në një moment të dhënë, bëhet në EUR dhe në lekë duke përdorur me kursin zyrtar të këmbimit të datës së fundit të periudhës së raportimit.

Borxhi i brendshëm dhe i jashtëm klasifikohet sipas maturimit, sipas rezidencës së kreditorëve dhe monedhës.

Huamarrja e qeverisë lokale ka filluar në vitin 2010. Ky borxh është pjesë e raportimit të borxhit publik dhe raportohet çdo tre muaj.

Të dhënat e borxhit të jashtëm raportohen rregullisht nga Ministria e Financave në Bankën Botërore. Që në Tetor 2010 Ministria e Financave është pjesë e iniciativës së Bankës Botërore / FMN për Raportimin e Borxhit të Sektorit Publik.

Objektivat strategjikë

Banka e Shqipërisë: Për të ardhmen mbetet prioritarë zgjerimi i informacionit mbi huamarrjen private afatgjatë dhe marrëdhëniet e borxhit mes kompanive në një lidhje investimi të huaj direkt, si dhe përmirësimi i infrastrukturës në mbledhjen dhe përpunimin e borxhit të jashtëm bruto.

Ministria e Financave: Në drejtim të përmirësimit të punës në të ardhmen, synon përdorimin e një programi të unifikuar të të dhënave të borxhit (bazë të dhënash), që të përfshijë borxhin e jashtëm dhe borxhin e brendshëm, pasi aktualisht të dhënat mbahen në dy programe të ndryshme.

Aktivitetet zbatuese

- Marrja e asistencës teknike dhe organizimi i trajnimeve për të kaluar në raportimin e të dhënave të borxhit sipas standardeve të BE-së.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Raportimi i të dhënave të borxhit sipas standardeve të BE-së.

Tema 2.06 Statistikat e Çmimeve të Konsumit dhe Matja e fuqisë Blerëse

Përshkrimi

Fushat e aktiviteteve të mbuluara në këtë temë janë:

- Prodhimi dhe zhvillimi i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (dhe HICP)
- Prodhimi dhe zhvillimi i Matjes së Fuqisë Blerëse

INSTAT-i nuk llogarit Indeksën e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit dhe mat ndryshimin e kostos së jetesës nëpërmjet Indeksit të Çmimeve të Konsumit (IÇK).

IÇK mat ndryshimin e çmimeve të konsumit të një shporte fikse mallrash e shërbimesh në periudhën korente, krahasuar me një periudhë tjetër e konsideruar si periudha bazë. Periudha bazë e indeksit është muaji Dhjetor 2007.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit përdoret si:

- Matës zyrtar i inflacionit në Shqipëri;
- Deflator vlerash për sektorin e Llogarive Kombëtare;
- Deflator për llogaritjen e indekseve të volumit;
- Variabël për analizat makro ekonomike;
- Deflator për indeksimin e pagave, pensioneve dhe të ardhurave kur është e nevojshme;
- Për hartimin e politikave monetare për Bankën e Shqipërisë.

Barazia e Fuqisë Blerëse (PPP) është një projekt i organizuar dhe financuar nga Eurostat-i në kuadrin e Programit Evropian të Krahasimit. Projekti i PPP-së bazohet në Rregulloren 1445/2007 të Parlamentit Evropian dhe ligjit të muajit Dhjetor 2007 (Rregullorja e PPP-së). Zyrat Kombëtare të Statistikave të vendeve pjesëmarrëse në Projekt janë përgjegjëse për kryerjen e vrojtimit statistikore të çdo cikli tre-vjeçar të projektit, si dhe për sigurimin e të dhënave shtesë sipas afateve të përcaktuara nga Eurostat-i.

Treguesit specifikë, si koeficienti i korrektimit dhe përqindja e kontributeve për pensione për stafin e BE-së, nuk janë të detyrueshëm të prodhohen nga vendi ynë, sa kohë nuk është anëtar i BE-së.

Prioritetet

Ndër prioritetet kryesore që do merren parasysh për zhvillimin e statistikave të kësaj kategorie, veçohen:

- Implementimi i programit të ri informatik për llogaritjen e IÇK-së duke përdorur aplikimin SQL;
- Rinovimi i shportës së mallrave dhe peshave të tyre si dhe rinovimi i njësive tregtare mbi baza vjetore;

- Kryerja në kohë dhe me cilësi i të gjitha fazave të punës të vrojtimit të çmimeve të konsumit të planifikuara nga Eurostat-i, bazuar në Rregulloren e PPP-së;
- Plotësimi në kohë i të gjithë të dhënave shtesë të kërkuara për llogaritjet e treguesve të PPP-së.

Moduli 2.06.01.01 Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK)

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT aktualisht llogarit IÇK-në, që është një nga treguesit më të rëndësishëm me të cilin matet tendenca e çmimeve të konsumit në tregun vendas. Indeksi mujor i çmimeve të konsumit ka filluar të llogaritet që në vitin 1992.

Burimi kryesor për llogaritjen e peshave të IÇK-së janë shpenzimet e familjeve shqiptare të përfuara nga Anketa e Buxhetit të Familjeve (ABF) të kryer nga INSTAT.

IÇK llogaritet me formulën e *Laspeyr*-it duke përdorur mesataren gjeometrike për llogaritjen e çmimit relativ për çdo produkt. Shporta e produkteve të zgjedhura për llogaritjen e indeksit përmban rreth 272 produkte dhe shërbime. Produktet dhe shërbimet e zgjedhura për llogaritjen e indeksit përbëhen nga produktet dhe shërbimet të cilat zënë pjesën më të madhe të konsumit personal të familjeve.

Çmimet mblidhen vetëm në 11 qytete nga Zyrrat rajonale të statistikave që janë përgjegjëse për mbledhjen e çmimeve. Çmimet mblidhen nga data 10-25 e çdo muaji, në 6-8 ose 10 dyqane për çdo produkt. Çdo muaj, afërsisht, mblidhen rreth 18,000 çmime individuale, në rreth 500 dyqane të zgjedhura për këtë qëllim. Çmimet e mbledhura hidhen në një format Excel nga personi përgjegjës i zyrës rajonale të statistikës në rreth, të cilët llogarisin edhe çmimin relativ për çdo produkt (mesatarja gjeometrike) dhe dërgojnë informacionin në INSTAT brenda datës 30 të çdo muaji.

Shporta e mallrave dhe ponderacionet janë azhornuar sa herë INSTAT ka realizuar Anketën e Buxhetit të Familjeve. Për herë të fundit rinovimi i shportës u krye në vitin 2008 dhe, nga muaji Janar 2008, indeksi llogaritet duke konsideruar muajin Dhjetor 2007 si periudhë bazë.

Objektivat Strategjikë

- Prodhimi në kohë e me cilësi i treguesve ekzistues të çmimeve të konsumit në përputhje të plotë me metodologjinë e Eurostat-it.

- Përmirësimi i vazhdueshëm metodologjik, mbështetur në manualët dhe rregulloret që Eurostat përditëson për këtë fushë statistikore.
- Përdorimi i teknikave të avancuara të grumbullimit dhe editimit të të dhënave të cilat çojnë në rritjen e cilësisë së informacionit.

Aktivitetet zbatuese

- Prodhimi mujor i indeksit bazuar në klasifikimin e shpenzimeve COICOP sipas nivelit të detajimit që përdor Eurostat-i;
- Implementimi i një programi të ri për llogaritjen e indeksit, duke përdorur aplikimin SQL. Implementimi i këtij programi do të shoqërohet edhe me përmirësime metodologjike të llogaritjes.
- Rinovimi i shportës së produkteve, peshave të tyre si dhe rinovimi i njësive tregtare në bazë vjetore.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Llogaritja e Indeksit mujor të Çmimeve të Konsumit të përputhshëm me kërkesat e EU-së sipas hierarkisë së mëposhtme:
 - Indeksi Total;
 - Indeksi sipas grupeve kryesore;
 - Indeksi sipas grup-mallrave;
 - Indeksi në nivel të detajuar sipas artikujve.

Burimi i Informacionit

Burimi i të dhënave statistikore për përllogaritjen e ICK-së janë njësitë e tregtimit me pakicë të artikujve të konsumit.

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Llogaritja e Indeksit të Çmimeve të Konsumit nga vrojtimi statistikor	2012	2013	2014	2015	2016

Moduli 2.06.01.02 Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (HIÇP)

Përshkrimi i situatës aktuale

HIÇP është treguesi bazë për matjen e inflacionit në vendet e Eurozonës. Aktualisht, Instituti i Statistikave të Shqipërisë nuk llogarit Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit, por mat ndryshimin e kostos së jetesës nëpërmjet llogaritjes së Indeksit të Çmimeve të Konsumit.

Objektivi Strategjik

Llogaritja e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit deri në fund të vitit 2014.

Aktivitetet zbatuese

- Përcaktimi i shportës së mallrave që do të përdoret për llogaritjen e HIÇP-së;
- Llogaritja e peshave të produkteve të shportës sipas konceptit të HIÇP-së;
- Ndërtimi i programit informatik për llogaritjen e indeksit nëpërmjet ndërtimit të një moduli të veçantë në programin e llogaritjes së Indeksit të Çmimeve të Konsumit.

Rezultatet e pritshme

- ✓ HIÇP i llogaritur në përputhje të plotë me kërkesat e EU sipas hierarkisë së mëposhtme:
 - Indeksi Total;
 - Indeksi sipas grupeve kryesore;
 - Indeksi sipas grup-mallrave;
 - Indeksi në nivel të detajuar sipas artikujve.

Burimi i Informacionit

Si burim të dhënash statistikore do të shërbejnë çmimet e konsumit që përdoren për llogaritjen e Indeksit të Çmimeve të Konsumit si dhe disa të dhëna shtesë nëse është e nevojshme.

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Llogaritja e IHÇK nga vrojtimi statistikor	-	-	2014	2015	2016

Moduli 2.06.02 Matja e Fuqisë Blerëse (PPP)

Përshkrimi i situatës aktuale

Republika e Shqipërisë është përfshirë në Projektin Pilot të Programit Evropian të Krahasimit për PPP-në që në vitin 2003, nën drejtimin e Statistikës së Sllovenisë. INSTAT-i është përgjegjës për kryerjen e gjashtë vrojtimit të çmimeve të konsumit dhe dy vrojtimit të tjera të makinerive e pajisjeve dhe çmimeve të ndërtimit, brenda një cikli tre vjeçar. INSTAT-i, gjithashtu, është përgjegjës për të siguruar një herë në vit për Eurostat-in disa të dhëna të tjera shtesë për nevojat e projektit (Pariteti i Fuqisë Blerëse) që përdoren për krahasimin e volumit të PBB-së ndërmjet vendeve.

INSTAT-i përgatit dhe dërgon në Eurostat një raport pune për çdo vrojtim çmimesh si dhe një raport të përgjithshëm pas përfundimit të një kontrate një vjeçare. Të gjitha të dhënat e vrojtitimit, raportet e punës si dhe informacionet e tjera shtesë dërgohen në Eurostat duke përdorur E-Damis. Hapat e punës dhe afatet respektive janë përcaktuar nga Eurostat.

Aktualisht, INSTAT-i, bazuar në *Contract. ref. at. ICON-INSTITUTE Public Sector 6642400-PPP-SerCon-Albania-i*, është duke realizuar aktivitetet e vrojtitimit të çmimeve të produkteve dhe shërbimeve të ciklit të Programit Evropian të Krahasimit për vitin 2012. Çmimet e produkteve dhe shërbimeve po mbledhen vazhdimisht në harmonizim të plotë me listën e produkteve dhe specifikimeve të caktuara nga programi.

Gjithashtu, është duke përgatitur PPP *Inventory* (kapitullin 1- dhe 2.1). *Inventory* është një raport ku përshkruhet në mënyrë të detajuar shpjegimi, burimet dhe metodat e përdorura në realizimin e projektit të PPP-së. Ky raport duhet të dorëzohet në Eurostat në fund të muajit Janar të çdo viti.

Objektivat Strategjikë

Për matjen e PPP-së, INSTAT-i do të vazhdojë realizimin e aktiviteteve të vrojtitimit të çmimeve të produkteve dhe shërbimeve të ciklit të Programit Evropian të Krahasimit për vitin 2012. Çmimet e produkteve dhe shërbimeve do të mbledhen vazhdimisht në harmonizim të plotë me listën e produkteve dhe specifikimeve të përcaktuara në Program. Gjithashtu, INSTAT do të ndjekë të gjitha hapat e punës dhe afatet respektive të përcaktuara nga Eurostat për dërgimin e të dhënave sipas afateve të paracaktuara.

Kryerja në kohë e me cilësi e të gjitha vrojtimeve të çmimeve dhe mbledhja e dërgimi i të dhënave shtesë sipas afateve të paracaktuara nga Eurostat, është objektivi kryesor që INSTAT duhet të përmbushë gjatë zbatimit të këtij Programi.

Aktivitetet zbatuese

- Vazhdimi i punës në përputhje me metodologjinë e Eurostat-it, 2012;
- Mbledhja e çmimeve të konsumit, çmimeve të preventivave të ndërtimit dhe çmimeve për makineri e pajisje, sipas programit të miratuar nga Eurostat-i;
- Plotësimi i gjithë të dhënave shtesë për llogari të matjes së fuqisë blerëse, të kërkuar nga Eurostat-i.

Rezultatet e pritshme

Eurostat-i llogarit barazinë e fuqisë blerëse të parasë dhe treguesin e PBB-së për frymë të popullsisë në PPP, bazuar në të dhënat e vrojtimeve të çmimeve të konsumit, materialeve të ndërtimit dhe çmimeve për makineri e pajisje si dhe në të dhëna shtesë të dërguara nga Institutet e Statistikave pjesëmarrëse në projekt.

Burimi i informacionit

Si burim të dhënash statistikore do të shërbejnë njësitë e tregtimit me pakicë të artikujve të ndryshëm të konsumit, ndërmarrjet e ndërtimit dhe distributorët e ndryshëm të makinerive dhe pajisjeve.

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Matja e Fuqisë Blerëse nga vrojtimi statistikor	2012	2013	2014	2015	2016

Moduli 2.06.02.01 Shitjet e ndërmarrjeve që paguajnë Tatimin e Vlerës së Shtuar (TVSH)

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT grumbullon çdo muaj në mënyrë elektronike të dhënat mbi shitjet që realizojnë subjektet që i nënshtrohen regjimit të taksave mbi vlerën e shtuar (subjektet që realizojnë gjatë vitit një shifër afarizmi mbi 5 milionë lek). Grumbullimi dhe përpunimi i këtyre të dhënave ka filluar që nga viti 2001 e në vazhdim. Shitjet mbahen me kodin e aktivitetit në nivel 4 shifror dhe mbi këtë bazë bëhet përlllogaritja e shitjeve në nivel dege. Kodi i aktivitetit që merret nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve përditësohet me kodin e aktivitetit të Regjistrit Statistikor të rezultuar nga viti i mëparshëm.

Shitjet përlllogariten dhe në nivel rrethi.

Objektivat Strategjikë

Prioritet në statistikat e shitjeve në periudhën 2012-2016 do të vazhdojë të jetë grumbullimi dhe përpunimi në kohë dhe me cilësi të dhënave dhe shpërndarja e tyre në kohë tek përdoruesit, në mënyrë që të prodhohen statistika të rregullta mujore, tremujore dhe vjetore dhe indekset e vlerës.

Një tjetër prioritet kryesor mbetet forcimi i bashkëpunimit të INSTAT-it me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në mënyrë që të sigurohet prodhimi i statistikave koherente dhe cilësore.

Aktivitetet zbatuese

- Marrja e skedarit të TVSH-së nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë e Tatimeve në rrethe;
- Përpunimi i të dhënave të skedarit sipas aktiviteteve ekonomike;

- Përdorimi i këtyre të dhënave në varësi të kërkesave të sektorëve të tjerë të INSTAT-it (si sektori i Llogarive Kombëtare, sektori i Statistikave afatshkurtra, Sektori i regjistrave etj) për periudhën në vazhdim.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Prodhimi i treguesit të shitjeve në vlerë absolute sipas aktivitetit ekonomik dhe në nivel rrethi e prefekturë.

Burimi i Informacionit

Burimi i informacionit do të jetë të dhënat administrative të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Skedari i Taksës së Vlerës së Shtuar (TVSH) nga burimi administrativ	2012	2013	2014	2015	2016

Tema 2.07 Tregtia e mallrave

Përshkrimi

Statistikat e tregtisë se jashtme të mallrave përfshijnë të dhëna mbi tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe pjesës tjetër të botës. Informacioni statistikor është i një rëndësie thelbësore për ekonominë shqiptare dhe politikat ekonomike, si dhe për analizën e zhvillimeve të tregut të mallrave individuale.

Statistikat përmbajnë të dhëna të cilat ndahen sipas vendeve partnere, grupvendeve, kapitujve dhe seksioneve të Nomenklaturës së Kombinuar dhe seksioneve të Klasifikimit Ndërkombëtar Standard i Tregtisë (SITC). Zhvillimi i punës përqendrohet në vënien në dispozicion të përdoruesve të statistikave të harmonizuara të cilat plotësojnë kërkesat në aspektin e cilësisë, afateve kohore dhe që janë të rëndësishme për t'iu përshtatur nevojave të përdoruesve. Konceptet dhe metodat janë përshtatur për të integruar statistikat e tregtisë së jashtme të mallrave në nivel ndërkombëtar. Të dhënat janë mbledhur, përpunuar dhe shpërndahen në bazë të Ligjit Doganor dhe Ligjit Statistikor të Shqipërisë, si dhe bazuar në metodologjitë e ditëve të sotme.

Prioritetet

Prioritetet në statistikat e tregtisë se mallrave janë mbledhja e rregullt dhe cilësore dhe shpërndarja e të dhënave të tregtisë së mallrave, në mënyrë që të

prodhojnë statistika të rregullta mujore, tremujore dhe vjetore, si dhe Indekset e Vlerës Njësi për baza tremujore për eksport-importet.

Përpjekjet do të vazhdojnë për të siguruar që afatet e transmetimit të të dhënave mujore, të grupuara dhe të detajuara nga Shqipëria në Eurostat, të jenë përmbushur plotësisht.

Një tjetër prioritet kryesor mbetet forcimi i bashkëpunimit të INSTAT-it me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, në mënyrë që të sigurojë prodhimin e statistikave koherente dhe cilësore.

Aktivitetet e bashkëpunimit (shkëmbimit të përvojave nëpërmjet takimeve, seminareve etj) me vendet e tjera do të vazhdojë në kuadër të programeve të bashkëpunimit statistikor.

Prioritet tjetër është dhe transferimi nga SITC, Rev.3, në SITC, Rev.4 dhe përpilimin e statistikave të tregtisë së jashtme me këtë klasifikim, të detajuara dhe të agreguara mujore të eksportit e importit në Eurostat.

Prioritetet janë llogaritja e saktë dhe në mënyrë të vazhdueshme e Indekseve të Vlerës Njësi sipas 21 seksioneve të Sistemit të Harmonizuar të mallrave dhe kodeve (HS).

Një tjetër prioritet kryesor është llogaritja e Indekseve të Vlerës Njësi sipas nomenklaturave të tjera të përdorura nga Drejtoria e Llogarive kombëtare, si p.sh. CPA, NACE, etj.

Një tjetër prioritet kryesor mbetet forcimi i bashkëpunimit me Drejtorinë e Llogarive kombëtare si një nga sektorët kryesorë që përdorin këto indekse.

Moduli 2.07.04.01 Tregtia e mallrave – Prodhimi i të dhënave

Përshkrimi i situatës aktuale

Statistikat e tregtisë së mallrave kanë qëllim të japin të dhëna mbi tregtinë e mallrave, eksport-importin e mallrave në Shqipëri. Për këtë qëllim statistikave të tregtisë së mallrave llogarisin treguesit e eksportit (FOB) dhe importit (CIF) në total si dhe disa tregues të tjerë më të detajuar, si p.sh. eksport-importi sipas vendeve, grupvendeve, grupmallrave, etj.

INSTAT-i përpilon statistikave të tregtisë së jashtme sipas rekomandimeve të Kombeve të Bashkuara të përshkruara në Manualin “Konceptet dhe Definicionet e Statistikave të Tregtisë së Jashtme”, publikuar në vitin 1998, në të cilin mbështetet edhe metodologjia e Eurostat-it.

Burimi i sigurimit të të dhënave statistikore të tregtisë së jashtme të mallrave është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (burim administrativ). Të dhënat grumbullohen nëpërmjet dokumentit administrativ të vetëm (deklarata doganore), i cili është sipas standardeve të BE-së.

Të dhënat e tregtisë së jashtme të mallrave përpunohen duke u mbështetur në principet e sistemit të tregtisë speciale.

Nomenklaturat e përdorura për llogaritjen e statistikave të tregtisë së mallrave janë:

- Sistemi i Harmonizuar i mallrave dhe kodeve (HS)
- Nomenklatura e Kombinuar e Mallrave (CN),
- Klasifikimi Standard i Tregtisë Ndërkombëtare SITC, rev.3,
- Klasifikimi i vendeve dhe territoreve ISO – 3166 alpha-2code
- Nomenklatura të tjera që përdoren për nevoja të brendshme të INSTAT-it, si p.sh. Klasifikimi i Produkteve (CPA) dhe i Aktiviteteve (NACE) për nevojat e drejtorisë së llogarive kombëtare dhe statistikave të biznesit.

Të dhënat përpunohen në bazë mujore duke u mbështetur në kontrollet që aplikohen në DPD, e cila përdor sistemin *Asycuda World*, që lejon një sërë kontrollesh cilësore për të dhënat, si edhe disa kontrolle vizuale nga ana e INSTAT-it.

Statistikat e përfutuara publikohen në bazë mujore, tremujore dhe vjetore (publikime të veçanta dhe specifike për tregtinë e jashtme të mallrave dhe publikime të tjera të INSTAT-it) si edhe në faqen elektronike www.instat.gov.al.

Të dhënat mujore të detajuara të eksport-importit dërgohen në Eurostat në bazë të formatit të përcaktuar në dokumentin Doc. Coop 400 Rev 1.2 që nga viti 1998. Këto të dhëna tani dërgohen nëpërmjet aplikacionit E-Damis.

Objektivi strategjik

Në periudhën 2012-2016, objektivat strategjike për këtë fushë do të jenë:

- Publikimi nga INSTAT i statistikave të tregtisë së mallrave të cilat kanë për qëllim të japin informacion të përgjithshëm dhe të detajuar mbi tregtinë e mallrave, eksport-importin e mallrave me vendet e tjera të botës;
- Përmirësimi i mënyrës së marrjes së informacionit nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në periudha mujore.

Aktivitetet zbatuese

Treguesit ekzistues do të vazhdojnë të publikohen në vazhdimësi gjatë periudhës 2012-2016.

Gjithashtu, do të vazhdojë forcimi i marrëdhënieve me institucionet e tjera për përmirësimin e vazhdueshëm të statistikave të tregtisë së mallrave. Aktivitete të tjera janë:

- Instalimi i sistemit *Eurotrace*, gjatë 2012;
- Testim i programit, 2012-2013;
- Përdorimi i programit *Eurotrace* për përpunimin e të dhënave të import-eksportit, 2013-2016.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Prodhimi i statistikave të tregtisë së jashtme në periudha mujore, tremujore, vjetore;
- ✓ Publikimi në kohë dhe me cilësi sipas kalendarit të publikimeve;

Burimi i Informacionit

Burimi statistikor për prodhimin e treguesve të kësaj fushe do të jetë ai i marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Prodhimi të dhënave të tregtisë së mallrave nga burimi administrativ	2012	2013	2014	2015	2016

Moduli 2.07.04.02 Indekset e Vlerës Njësi

Përshkrimi i situatës aktuale

Indekset e Vlerës Njësi tregojnë ndryshimet në çmimet mesatare të importeve dhe eksporteve të agreguara duke supozuar që sasi të importuara ose të eksportuara mbeten të pa ndryshuara. Pra, këto indekse masin çmimet mesatare të importit dhe eksportit pa marrë parasysh ndryshimet në sasi të mallrave të tregtuara edhe pse shpesh quhen si indekse çmimesh, në fakt janë indekse të çmimeve mesatare ndërmjet disa mallrave.

Burimi i të dhënave statistikore për llogaritjen e Indekseve të Vlerës Njësi është skedari i të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (burim administrativ). Të dhënat grumbullohen nëpërmjet Dokumentit Administrativ të Vetëm (deklarata doganore), i cili është sipas standardeve të BE-së.

Nomenklaturat e përdorura për llogaritjen e Indekseve të Vlerës Njësi janë:

- 21 seksionet e Sistemit të Harmonizuar të mallrave dhe kodeve (HS);
- Nomenklatura të tjera që përdoren për nevoja të brendshme të INSTAT-it, si p.sh. Klasifikimi i Produkteve (CPA) dhe i Aktiviteteve (NACE) për nevojat e llogarive kombëtare dhe statistikave të biznesit.

Indekset e Vlerës Njësi llogariten dhe publikohen në baza tremujore dhe vjetore.

Objektivi strategjik

Në periudhën 2012-2016, objektivi strategjik për këtë fushë do të jetë publikimi nga INSTAT i Indekseve të Vlerës Njësi tremujore dhe vjetore sipas 21 seksioneve të Sistemit të Harmonizuar të mallrave dhe kodeve (HS).

Aktivitetet zbatuese

Treguesit ekzistues do të vazhdojnë të publikohen në vazhdimësi gjatë periudhës 2012-2016.

Gjithashtu, do të vazhdojë forcimi i marrëdhënieve me sektorin e llogarive kombëtare për përmirësimin dhe llogaritjen e këtyre indekseve sipas kërkesave të këtij sektori.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Llogaritja e Indekseve të Vlerës Njësi në periudha tremujore, vjetore;
- ✓ Publikimi në kohë dhe me cilësi sipas kalendarit të publikimeve;

Burimi i Informacionit

Burimi statistikor për prodhimin e treguesve të kësaj fushe do të jetë informacioni i marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Llogaritja e Indekseve të Vlerës Njësi nga burimi administrativ	2012	2013	2014	2015	2016

Tema 2.08 Statistikat e bilancit të pagesave dhe tregtia ndërkombëtare e shërbimeve

Objektivat dhe produktet e Bankës së Shqipërisë si agjenci statistikore parashikohen në planet vjetore të punës, në strategjitë afatmesme (3-vjeçare) të Bankës së Shqipërisë dhe në Programin Afatmesëm të Statistikave Zyrtare. Marrëdhëniet midis Bankës së Shqipërisë dhe agjencive të tjera statistikore për dhënien dhe marrjen e të dhënave të përpunuara, parashikohen në Programin Afatmesëm të Statistikave Zyrtare.

Në temën 2.08, sipas përshkrimit në “Statistical Compendium 2010” janë të përfshira këto blloqe statistikore:

1. Tregtia ndërkombëtare e shërbimeve;
2. Investimet direkte të huaja (fluks dhe stok);

3. Statistikat e FATS (*Foreign Affiliates Trade Statistics*);
4. Bilanci i pagesave (për BE, për vendet kandidate);
5. Bilanci i pagesave për institucionet Evropiane;

Banka e Shqipërisë është institucioni përgjegjës që prodhon dhe publikon statistikën e sektorit të jashtëm, ku përfshihen: (a) statistikën e bilancit të pagesave, (b) statistikën e tregtisë ndërkombëtare të shërbimeve, (c) statistikën e investimeve të huaja (fluks dhe stok), dhe d) statistikën e borxhit të jashtëm. Statistikat e sektorit të jashtëm prodhohen në bazë të manualeve metodologjike të FMN-së (BPM5-1993 dhe EDS-2003) dhe OECD (BD3).

Në përgatitjen e statistikave të sektorit të jashtëm, Banka e Shqipërisë punon në vazhdimësi në dy drejtime themelore: (a) përmirësimin dhe përafrimin e metodologjive përkatëse me normat dhe standardet ndërkombëtare dhe (b) zgjerimin dhe përmirësimin e bazës së informacionit statistikor në drejtim të shtimit të numrit të treguesve, nivelit të disagregimit, kohëvonesës së publikimit dhe periodicitetit.

Statistikat e sektorit të jashtëm publikohen me frekuencë tremujore në respekt të afateve kohore të kalendarit zyrtar të statistikave të Bankës së Shqipërisë. Formatet e publikimit të tyre janë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe statistikën janë të disponueshme për përdoruesit, në faqen e web-it të Bankës së Shqipërisë si dhe publikime në letër apo CD. Rritja e transparencës në komunikimin dhe shpërndarjen e të dhënave në drejtim të detajimit të treguesve ekzistues, shtimit të treguesve të rinj dhe përmirësimit të afateve të publikimit është një objektivi i vazhdueshëm i Bankës së Shqipërisë.

Deri në fund të vitit 2011 Banka e Shqipërisë ka plotësuar të gjitha kërkesat e SDDS-it për statistikën e sektorit të jashtëm, në drejtim të mbulimit, periodicitetit dhe kohëvonesës me përjashtim të kohëvonesës së statistikave të pozicionit të investimeve ndërkombëtare.

Asistenca teknike e përfitur deri në fund të vitit 2011 është ofruar kryesisht nga FMN, ndërsa trainimi i burimeve njerëzore është realizuar nëpërmjet pjesëmarrjes në aktivitete trainuese nga FMN, BQE, Eurostat dhe banka të tjera qendrore.

Moduli 2.08.02 Bilanci i pagesave

Përshkrimi i situatës aktuale

Statistikat e bilancit të pagesave prodhohen në bazë të manualeve metodologjike të FMN-së (BPM5-1993) dhe OECD (BD3). Në përgatitjen e këtyre statistikave, Banka e Shqipërisë mbledh informacion nëpërmjet raportimit direkt

nga institucionet financiare; raportimit direkt nga burime administrative si: METE, MF, DPD, AMF, MB, QKR, si edhe vrojttimeve të realizuara me kompani private dhe individë. Për vrojtmet statistikore, çdo vit Banka e Shqipërisë nënshkruan një kontratë me INSTAT-in, i cili realizon kundrejt pagesës intervistimin në terren të ndërmarrjeve dhe individëve ose familjeve. Të dhënat e grumbulluara nga burimet e mësipërme raportohen pjesërisht me frekuencë mujore dhe në pjesën më të madhe me frekuencë tremujore duke mundësuar përgatitjen dhe publikimin e statistikave të bilancit të pagesave me frekuencë tremujore, me një kohëvonesë prej 70 ditësh.

Sfida afatshkurtër në drejtim të statistikave të bilancit të pagesave lidhet me përmirësimin cilësor të statistikave të investimeve të huaja direkte, investimeve të portofolit dhe shërbimeve të udhëtimit.

Në horizontin afatmesëm sfida për statistikave të bilancit të pagesave dhe shërbimeve ndërkombëtare është plotësimi i kërkesave të Manualit të Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare, Edicioni i gjashtë, FMN 2010 (BPM6), OECD-BD4 (manuali për investimet e huaja –edicioni 4) si edhe plotësimi i kërkesave të Eurostat dhe BQE-së mbi detajimin e statistikave të bilancit të pagesave sipas shteteve dhe sektorëve ekonomikë.

Objektivi strategjik

Prodhimi i statistikave të bilancit të pagesave , të krahasueshme, të besueshme, objektive dhe të sakta, që nevojiten për të mbështetur analizat dhe vendimmarrjen në Bankën e Shqipërisë, në raport me objektivat strategjike të vendit në fushën e ekonomisë dhe financave.

Aktivite zbatuese

- Përgatitja e Programit Afatmesëm të Statistikave Zyrtare, për prodhimin e statistikave të sektorit të jashtëm, (statistikave të bilancit të pagesave, të pozicionit të investimeve ndërkombëtare dhe të borxhit të jashtëm)
- Përmirësimi i legjislacionit mbi raportimin për nevoja statistikore, përfshirë këtu përshtatjen e manualeve metodologjike ndërkombëtare si dhe format e raportimit të të dhënave për nevoja statistikore.
- Shtim (rritje) të numrit të vrojtmeve statistikore tremujore dhe vjetore.
- Përforsimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknologjike nëpërmjet investimit në trajnime dhe në programe bashkëkohore për menaxhimin e të dhënave statistikore.
- Forcimi i bashkëpunimit midis agjencive statistikore dhe përdoruesve të statistikave zyrtare nëpërmjet marrëveshjeve bilaterale të bashkëpunimit, aktiviteteve dhe projekteve të fokusuara në sektorë të veçantë të statistikave.

Rezultate të pritshme

- ✓ Program kombëtar statistikor për statistikat zyrtare, pjesë e të cilit do të jenë statistikat e bilancit të pagesave, të pozicionit të investimeve ndërkombëtare dhe të borxhit të jashtëm.
- ✓ Manuale metodike ndërkombëtare të përshtatura në shqip.
- ✓ Tregues statistikorë të bilancit të pagesave të shtuar në numër dhe të detajuar, sipas standardeve ndërkombëtare (BPM6 dhe *Vademecum* 2011).

Moduli 2.08.03 Investimet e huaja direkte (fluks dhe stok)

Përshkrimi i situatës aktuale

Statistikat e investimeve të huaja janë pjesë integrale e statistikave të bilancit të pagesave. Ato përfshijnë vlera të realizuara nga transaksionet e krijimit, mbajtjes, zgjerimit ose reduktimit të kapitalit të të gjithë operatorëve ekonomike në ekonominë e vendit, kur përqindja e pronësisë të kapitalit të huaj është 10 përqind ose më shumë. Në përgatitjen e statistikave të investimeve të huaja, Banka e Shqipërisë zbaton kërkesat dhe standardet e manualeve metodologjike të FMN-së (BPM5-1993) dhe OECD (BD3). Detajimi dhe klasifikimi i statistikave për investimet e huaja, është konform formës standarde të bilancit të pagesave, paraqitur në manualin e BPM5 të FMN dhe përfshin detajimin e tyre në: (a) investime kapitale (b) investime të fitimit të riinvestuar dhe (c) investime të tjera.

Të dhënat elementare për kompilimin e statistikave të investimeve të huaja, sigurohen nga raportimet mujore të sistemit bankar, nga bilancet mujore dhe tremujore të institucioneve financiare (banka dhe jobanka), nga raportimet direkte të disa prej kompanive me kapital të huaj, nga institucione të tjera administrative, si METE dhe MF si dhe nga vrojtimi vjetor statistikor për investimet e huaja. Statistikat e investimeve të huaja (flukset) përgatiten dhe publikohen me frekuencë tremujore, njëkohësisht me statistikat e bilancit të pagesave, me një kohëvonesë prej 70 ditësh.

Sfida afatshkurtër për statistikat e investimeve të huaja, është zgjerimi i fushës së mbulimit të sektorit privat dhe përfshirjen e tij në raportimet direkte të transaksioneve tremujore.

Sfida afatmesme është, plotësimi i kërkesave të BPM6, Eurostat (*Vademecum*) dhe BQE për statistika të investimeve të huaja të detajuara sipas shteteve dhe aktivitetit ekonomik.

Statistikat e stokut të investimeve të huaja janë pjesë e statistikave të pozicionit të investimeve ndërkombëtare (PIN). Në përgatitjen e statistikave të pozicionit të investimeve ndërkombëtare përdoren të gjitha të dhënat nga burimet

e përshkruara për statistikat e fluksit të investimeve të huaja, por rëndësi prioritare kanë të dhënat e siguruara nga anketa statistikore e kompanive me kapital të huaj.

Sfida afatshkurtër për statistikat e pozicionit të investimeve ndërkombëtare, është përshpejtimi i afatit të përgatitjes dhe publikimit të tyre, nga 15 muaj në një afat 12 muaj.

Sfida afatmesme për këto statistika është plotësimi i kërkesave të BPM6, Eurostat (*Vademecum*) dhe BQE për statistika të pozicionit të investimeve të huaja me frekuencë tremujore.

Objektivi strategjik

Prodhimi i statistikave të investimeve të huaja dhe të pozicionit të investimeve ndërkombëtare, të krahasueshme, të besueshme, objektive dhe të sakta, konform standardeve ndërkombëtare .

Aktivite zbatuese

- Përmirësimi i legjislacionit për të forcuar dhe zgjeruar numrin e subjekteve raportuese për të dhëna statistikore,
- Përshtatja e manualeve metodologjike ndërkombëtare si dhe format e raportimit të të dhënave për nevoja statistikore.
- Forcimi i bashkëpunimit midis agjencive statistikore dhe përdoruesve të statistikave zyrtare nëpërmjet marrëveshjeve bilaterale të bashkëpunimit, aktiviteteve dhe projekteve të fokusuara në fushën e statistikave për investimet e huaja.
- Vrojtim tremujor për stokun dhe fluksin hyrës të investimeve të huaja si dhe vrojtim vjetor për fluksin dalës të investimeve të kompanive rezidente.
- Përforcimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknologjike nëpërmjet investimit në trajnime dhe në programe bashkëkohore për menaxhimin e të dhënave statistikore.

Rezultate të pritshme

- ✓ Manuale metodike ndërkombëtare të përshtatura në shqip.
- ✓ Tregues statistikorë të investimeve të huaja dhe të pozicionit të investimeve ndërkombëtare në numër dhe të detajuar, sipas standardeve ndërkombëtare, (BPM6 dhe *Vademecum* 2011)

Moduli: 2.08.04 Tregtia ndërkombëtare e shërbimeve

Përshkrimi i situatës aktuale

Statistikat e shërbimeve janë pjesë integrale e statistikave të bilancit të pagesave. Llogaria shërbime mbulon të gjitha shërbimet që rezidentët e një ekonomie u kryejnë për jorezidentëve (kredi) si dhe shërbimet të kryera nga jo rezidentët, për llogari të rezidentëve (debi). Në përgatitjen e statistikave të shërbimeve aplikohen rekomandimet e manualit për bilancin e pagesave (BPM5-FMN) si dhe rekomandimet e përshkruara në manualin e tregtisë ndërkombëtare të shërbimeve.

Aktualisht burimi kryesor i të dhënave për kompilimin e statistikave të shërbimeve janë raportimet mujore të bankave tregtare. Krahas tyre, Banka e Shqipërisë grumbullon të dhëna edhe nga shumë institucione të tjera dhe konkretisht për shërbimet e sigurimit nga AMF (Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare), për shërbimet qeveritare nga MF, për shërbimet e udhëtimit nga vrojtimi tremujor i turizmit dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, për shërbimet e transportit, nga vrojtimi i tregtisë së jashtme, etj. Statistikat e shërbimeve përgatiten dhe publikohen me frekuencë tremujore, si pjesë përbërëse e statistikave të bilancit të pagesave.

Sfida afatshkurtër për statistikat e shërbimeve është përmirësimi cilësor dhe zgjerimi fushës së mbulimit i të dhënave për shërbimet e udhëtimit.

Ndërsa sfida afatmesme për këto statistika është implementimi i rekomandimeve të manualit të BPM6.

Objektivi strategjik

Prodhimi i statistikave të shërbimeve, të krahasueshme, të besueshme, objektive dhe të sakta, në përputhje me standardet ndërkombëtare .

Aktivitetet zbatuese

- Përshtatja e manualeve metodologjike ndërkombëtare si dhe format e raportimit të të dhënave për nevoja statistikore.
- Forcimi i bashkëpunimit midis agjencive statistikore për projekte të fokusuara në fushën e statistikave të shërbimeve të udhëtimit (turizmit) .
- Përforcimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknologjike nëpërmjet investimit në trajnime dhe në programe bashkëkohore për menaxhimin e të dhënave statistikore.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Manuale metodike ndërkombëtare të përshtatura në shqip.
- ✓ Përmirësime cilësore të treguesve statistikorë të shërbimeve dhe detajim i tyre sipas standardeve ndërkombëtare, (BPM6 dhe *Vademecum* 2011).

Moduli: 2.08.06 Statistika të FATS

Përshkrimi i situatës aktuale

Përgatitja e statistikave ekonomike për kompanitë rezidente me pjesëmarrje të kapitalit të huaj aktualisht përgatiten nga Instituti i Statistikave në kuadër të anketës vjetore strukturore të ndërmarrjeve ekonomike. Në statistikave ekonomike përfshihen, tregues të shitjeve, prodhimit, vlerës së shtuar, punësimit etj. Është e rëndësishme të shënohet se statistikave ekonomike për ndërmarrjet me kapital të huaj nuk publikohen në mënyrë të veçantë por janë të përfshira në vlerat e treguesve ekonomike që publikon INSTAT në publikimin e tij vjetor “ Rezultate të anketës strukturore të ndërmarrjeve ekonomike”. Duke filluar nga viti 2010, në kuadër të përgatitjes së publikimit të raportit vjetor për “Investimet e huaja në Shqipëri”, Instituti i Statistikave ka përgatitur posaçërisht për këtë projekt edhe statistikave ekonomike për kompanitë me kapital të huaj.

Ngritja e sistemit për statistikave ekonomike (IHD) të kompanive shqiptare që kanë investime direkte jashtë vendit është i lidhur ngushtësisht me aktivitetin e përgatitjes së statistikave të investimeve direkte për të njëjtat kompani. Aktualisht Banka e Shqipërisë ka identifikuar si ndërmarrje të tilla (me asete jashtë vendit) institucionet financiare, të cilat raportojnë periodikisht të dhëna në lidhje me investimet e tyre jashtë vendit. Gjithashtu janë identifikuar edhe kompanitë e sigurimit që kanë asete jashtë vendit dhe po punohet për të siguruar informacion periodik prej tyre.

Sfida afatshkurtër për statistikave të huaja në formën e fluksit/stokut dalës është, identifikimi i kompanive private që operojnë në sektorët e tjerë të ekonomisë.

Ndërsa sfida afatmesme është realizimi i një vrojtimi vjetor pranë kompanive shqiptare me asete jashtë vendit për të grumbulluar të dhëna për investimet e kryera prej tyre.

Objektivi strategjik

Prodhimi i statistikave IHD, në përputhje me standardet ndërkombëtare .

Aktivitetet zbatuese

- Përmirësimi i legjislacionit, (akte normative—memorandume të bashkëpunimit), për të përcaktuar qartë përgjegjësitë në përgatitjen e statistikave IHD, ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Institutit të Statistikave .
- Përshtatja e manualeve metodologjike ndërkombëtare si dhe format e raportimit të të dhënave për nevoja statistikore.

- Përforcimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknologjike nëpërmjet investimit në trajnime dhe në programe bashkëkohore për menaxhimin e të dhënave statistikore.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Legjislacion i përmirësuar.
- ✓ Manuale metodike ndërkombëtare të përshtatura në shqip.
- ✓ Përmirësime cilësore të treguesve statistikorë të shërbimeve dhe detajim i tyre sipas standardeve ndërkombëtare (BPM6 dhe *Vademecum* 2011).

FUSHA 3 - STATISTIKAT E NDËRMARRJEVE

Tema 3.01 Statistikat Vjetore të e Ndërmarrjeve

Përshkrimi

Statistikat Strukturore vjetore të Ndërmarrjeve përmbajnë të dhëna të detajuara për aktivitetet ekonomike (jobujqësore), sipas degëve të ekonomisë dhe sipas madhësisë së ndërmarrjeve në nivel vendi. Një numër i madh variablash sigurohen nëpërmjet kryerjes së vrojtimit vjetor strukturor pranë ndërmarrjeve (ASN). Statistikat strukturore të ndërmarrjeve japin një përshkrim të ekonomisë nëpërmjet vrojtimit të aktiviteteve të njësive të angazhuara në një aktivitet ekonomik. Strategjia afatmesme e këtij aktiviteti statistikor mbetet përmirësimi i cilësisë së të dhënave, përmirësimi i metodave teknike dhe burimeve për grumbullimin e të dhënave.

Për zgjedhjen e këtyre ndërmarrjeve bazohemi në Regjistrin e Ndërmarrjeve, i cili përditësohet në vazhdimësi me të dhënat identifikuese të demografisë së ndërmarrjeve, që është pjesë përbërëse e këtij vrojtimi. Klasifikimi i ndërmarrjeve është bërë sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.1.1.

Prioritetet

Përcaktimi i prioriteteve bëhet në përputhje me Rregulloren e Këshillit (KE, *Euratom*) No.58/97, 20 dhjetor 1996, e ndryshuar me Rregulloren e Këshillit Evropian, Nr 295/2008 lidhur me Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve.

Për Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve, prioritetet kryesore janë përafrimi me Rregulloren e Eurostat-it për Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve,

riorganizimi i Anketës Strukturore në nivel aktiviteti dhe implementimi i Nomenklaturës së rishikuar të aktiviteteve, NVE Rev.2.

Programi i zhvillimit për këtë aktivitet statistikor do të fokusohet në zbatimin e një programi për riorganizimin e këtyre statistikave që do t’ju përgjigjet më mirë kërkesave të reja të përdoruesve. Pjesë e këtij programi do të jetë përmirësimi dhe koordinimi në vazhdimësi i mënyrave më efikase për grumbullimin e të dhënave si dhe përmirësimi i metodologjisë.

Moduli 3.01.01 Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT mbledh, përpunon dhe publikon statistikat vjetore strukturore të ndërmarrjeve ekonomike jo bujqësore me vrojtim vjetor me intervistë të drejtpërdrejtë me anketues. Popullsia bazohet në ndërmarrjet të cilat janë aktive sipas regjistrit statistikor. Klasifikimi i ndërmarrjeve është bërë sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.1.1. Fusha e mbulimit e këtij vrojtimi janë aktivitetet që u përkasin seksioneve nga B-Peshkimi deri P-Shërbime shtëpiake pranë familjeve dhe mjediseve të përbashkëta. Nuk përhshihen në vrojtim aktivitetet e seksioneve J-Ndërmjetësim Financiar, L-Administrim Publik, dhe Q-Organizma Ndërkombëtare. Seksionet M-Arsimi dhe N-Shëndetësi u përfshinë në vrojtimin ASN 2010, viti i referencës.

Vrojtimi përmban të dhëna mbi aktivitetet ekonomike, punësimin, të ardhurat e shpenzimet, investimet, dhe të dhëna specifike për ndërtimin, transportin rrugor, tregtinë, hotelet dhe bar-kafetë e restorantet.

Të dhënat i përkasin periudhës vjetore kalendarike. Viti fiskal korrespondon me vitin kalendarik.

Treguesit paraqiten për aktivitetet ekonomike gjithsej, sipas degëve dhe sipas madhësisë së ndërmarrjeve.

Objektivat strategjikë

Qëllimi kryesor i statistikave strukturore të ndërmarrjeve është të tregojë strukturën e aktiviteteve ekonomike nëpërmjet të dhënave ekonomike. Objektivi strategjik i ASN është përmirësimi i cilësisë së të dhënave, nëpërmjet:

- Riorganizimi i pyetësorit me standardet evropiane;
- Përdorimi i metodave të kombinuara të grumbullimit të informacionit statistikor;
- Përputhshmëria me standardet evropiane në drejtim të përdorimit të klasifikimeve të reja të rishikuara. Implementimi i NACE Rev.2.

- Organizimi i ASN-së në nivel rajonal bazuar në Regjistrin e Njësive Lokale. Kjo do të mundësojë publikimin e treguesve ekonomike në nivel rajonal, në 2013.
- Rritja e bashkëpunimit me institucionet e tjera për përmirësimin e metodave të transmetimit të të dhënave ekonomike nga institucionet e tjera në INSTAT dhe shfrytëzimin me efikasitet të të dhënave administrative.

Aktivitetet zbatuese

- Kryerja e vrojtimit statistikor vjetor pranë ndërmarrjeve ekonomike, me intervistim të drejtpërdrejtë. Aktivitetet ekonomike përfshijnë të gjitha ndërmarrjet aktive që prodhojnë të mira e shërbime për treg. Klasifikimi i ndërmarrjeve bëhet sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev 1.1.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Të dhëna bazë, (të ardhurat dhe shpenzimet, investimet) sipas aktivitetit ekonomik, madhësisë së ndërmarrjeve dhe pronësisë së ndërmarrjeve, për Prodhuesit e të mirave (Industri, Ndërtim) dhe për Prodhuesit e Shërbimeve (Transport & Komunikacion, Tregti dhe Shërbime të tjera);
- ✓ Treguesit kryesor makro-ekonomik (të llogaritur), sipas aktivitetit ekonomik, madhësisë së ndërmarrjeve dhe llojit të pronësisë së ndërmarrjeve për Prodhuesit e të mirave (Industri, Ndërtim) dhe për Prodhuesit e Shërbimeve (Transport & Komunikacion, Tregti dhe Shërbime të tjera);
- ✓ Të dhëna specifike për aktivitetet kryesore: Ndërtim, Transport, Tregti, Hotele dhe restorante;
- ✓ Të dhënat publikohen në botimin e veçantë Rezultate të Përgjithshme të Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve, në Vjetarin Statistikor dhe faqen Web të INSTAT.

Burimi i Informacionit

Burim i të dhënave statistikore janë të gjitha ndërmarrjet aktive në Shqipëri për të gjitha format legale.

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Anketë Vjetore pranë Ndërmarrjeve	2011	2012	2013	2014	2015

Moduli 3.01.03 Lista e Produkteve dhe shërbimeve (PRODCOM)

Përshkrimi i situatës aktuale

Në lidhje me zbatimin e *Prodcom* në vendin tonë, INSTAT në pyetësin e hartuar mbi Anketën Strukturore Vjetore, ka përfshirë në një rubrikë të veçantë Lista e produkteve industriale. Produktet janë të klasifikuara sipas Nomenklaturës së Produkteve, e njehsuar me Klasifikimin evropian të Produkteve, CPA. Treguesit e kërkuar dhe grumbulluar në këtë rubrikë, janë Sasia e prodhuar dhe e shitur e produkteve dhe Vlera e produkteve (pa TVSH). Aktualisht rezultatet e prodhuara nga anketa vjetore strukturore nuk plotësojnë kërkesat e përdoruesve për këtë lloj informacioni.

Objektivat strategjikë

Objektivat strategjikë janë:

- Grumbullimi, përpunimi dhe publikimi i të dhënave mbi produktet dhe shërbimet e kryera në të gjitha aktivitetet ekonomike;
- Plotësimi i nevojave të përdoruesve të brendshëm të INSTAT-it për këtë informacion dhe përdoruesve të jashtëm.

Aktivitetet zbatuese

- Organizimi i një vrojtim test në tremujorin e katër 2012.
- Organizimi i një vrojtimit test mbi produktet dhe shërbimet e kryera në të gjitha aktivitetet ekonomike, 2013;
- Grumbullimi dhe përpunimi të dhënave mbi produktet dhe shërbimet e kryera në Industri 2013-2014;
- Publikimi i rezultateve statistikore vjetore me baza tremujore duke filluar nga viti 2014.
- Në vitin 2013 do të vazhdojë kryerja e vrojtimit statistikor me periodicitet tremujor mbi ndërmarrjet ekonomike për produktet industriale dhe shërbimet. Periudhë bazë viti 2012. Intervista do të kryhet e kombinuar, ballë për ballë me pyetësor në letër dhe me postë.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Prodhimi i treguesve mbi produktet dhe shërbimet shqiptare në sasi dhe volum, për periudha tremujore.

Burim informacioni

Si burim të dhënash statistikore do të shërbejë vrojtimi statistikor tremujor pranë ndërmarrjeve ekonomike aktive.

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Anketa Tremujore pranë Ndërmarrjeve	-	-	2013	2014	2015

Tema 3.02 Statistikat afatshkurtra

Përshkrimi

Fushat e aktiviteteve të mbuluara nga kjo temë janë:

Prodhimi i statistikave afatshkurtër për aktivitetet Industri, Ndërtim, Tregti, Shërbime të tjera, përfshirë çmimet e prodhimit dhe importit në industri, kosto në ndërtim, lejet e ndërtimit.

INSTAT mbledh, përpunon dhe publikon të dhëna statistikore afatshkurtra në përputhje me rregulloren Evropiane të Statistikave Afatshkurtra, Nr1165/98 datë 19.05.1998, ndryshuar me Rregulloren Nr. 1503/2006.

Statistikat Afatshkurtra paraqesin ecurinë e ekonomisë së një vendi në periudha tremujore. Nëpërmjet tyre kuptohet zhvillimi i ciklit të ekonomisë si dhe mund të bëhen parashikime për të ardhmen e afërt.

Prioritetet

Për Statistikat Afatshkurtra të Ndërmarrjeve, prioritetet konsiderohen:

- Furnizimi me indikatorë të besueshme si dhe përmirësimi dhe konsolidimi i cilësisë së të dhënave;
- Implementimi i NACE Rev.2 dhe rishikimi i serisë kohore të indekseve bazuar në klasifikimin e ri;
- Përfshirja e aktiviteteve ekonomike të papërfshira në fushën e mbulimit, përmirësimi i sasisë dhe cilësisë së treguesve, përmirësimi i metodologjisë së përcaktimit të kampionit në mbështetje të plotësimit të kërkesave të përdoruesve të brendshëm dhe të jashtëm;
- Përdorimi i metodave të kombinuara të grumbullimit të informacionit statistikor.

Moduli 3.02.01.01 Statistikat afatshkurtra tremujore

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT kryen vrojtim tremujor pranë ndërmarrjeve ekonomike aktive. Popullata referuese është përcaktuar nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, për të gjitha format legale, ndërsa aktivitetet janë klasifikuar sipas Nomenklaturës së Aktiviteteve Ekonomike (NVE Rev.1.1) e njehsuar me Klasifikimin evropian NACE, Rev.1.1. Aktivitetet e përfshira në vrojtimin tremujor janë: Industri, Ndërtim,

Transport & Komunikacion, Tregti, Hotele, Shërbime arkitekturale dhe inxhinierike dhe Shërbime informatike.

Informacioni grumbullohet nëpërmjet anketuesve të cilët plotësojnë anketën bazuar në deklaratimet individuale të ndërmarrjeve.

Variablat statistikore të ciët shërbejnë për llogaritjen e këtyre treguesve janë përcaktuar në përputhje me Rregulloren Evropiane: Variabla dhe definicione Nr. 588/2001.

Statistikat afatshkurtra të ndërmarrjeve prodhojnë indikatorë si indekset e prodhimit industrial, indekset e të ardhurave nga shitja (shifra e afarizmit), indekset e punësimit, indekset e pagave, lejet e ndërtimit, etj në nivel vendi.

Për treguesit statistikore të prodhuar, të dhënat janë të disponueshme në formë indeksi dhe ndryshim përqindje. Seria kohore e të dhënave tremujore fillon prej vitit 2003.

INSTAT grumbullon lejet e ndërtimit nëpërmjet Drejtorive të Statistikave në rrethe, në numër, sipërfaqe dhe vlerë; sipas llojit dhe sipas tipit të klientit, në nivel rajoni dhe vendi.

Objektivat strategjikë

Objektiv i këtij moduli është prodhimi i treguesve me cilësi të lartë dhe në kohë, duke reduktuar raportimet problematike të ndërmarrjeve. Përmirësimi i metodave të grumbullimit të të dhënave; shfrytëzimit me efikasitet të burimeve administrative; përmirësimi i metodave të llogaritjes së deflatorëve; trajtimi në mënyrë të veçantë i ndërmarrjeve të mëdha.

Gjithashtu, implementimi i klasifikimit të rishikuar evropian NACE Rev.2 në statistikafatshkurtër, përmirësimi i publikimit sipas standarteve europiane dhe transmetimi i treguesve afatshkurtër në Eurostat, janë objektiva të këtij moduli.

Aktivitetet zbatuese

- Organizimi i vrojtimit tremujor mbi ndërmarrjet që kryejnë aktivitet ekonomik klasifikuar sipas NVE Rev1.1 në aktivitetet Industri, Ndërtim, Tregti, Shërbime (Hotele, Transport, Komunikacion, Shërbime arkitekturale, Shërbime Informatike) për grumbullimin e informacionit nga ndërmarrjet ekonomike. Procesi i grumbullimit kryhet me anketues, me intervistë të drejtpërdrejtë me pyetësor në format letër.

Rezultatet e pritshme

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i aktiviteteve të parashikuara janë prodhimi i treguesve të mëposhtëm:

- ✓ Indeksi i të ardhurave nga shitjet (Shifra e Afarizmit në vlerë/volum (i deflatuar) për aktivitetet e mbuluara në ATN;
- ✓ Indeksi i prodhimit në vlerë/volum (i deflatuar) në Industri dhe Ndërtim;
- ✓ Indeksi i punësimit, për aktivitetet e mbuluara në ATN;
- ✓ Indeksi i pagave për aktivitetet e mbuluara në ATN;
- ✓ Ndryshimet tremujore dhe vjetore në përqindje për të gjitha aktivitetet e përfshira në fushën e mbulimit të ATN-së;
- ✓ Lejet e ndërtimit në numër, sipërfaqe, vlerë sipas llojeve të ndërtimit, në nivel rajonal dhe vendi;
- ✓ Lejet e ndërtimit sipas llojit dhe klientit;
- ✓ Lejet e ndërtimit në numër dhe sipërfaqe në nivel rajonal;

Të dhënat bëhen të disponueshme 70 ditë pas mbylljes së tremujorit në publikimin “Buletini Statistikor tremujor”, “Shqipëria në Shifra”, “Vjetari statistikor”, web: www.instat.gov.al dhe publikimin specifik “Statistikat afatshkurtra”.

Burimi i informacionit

Burim statistikor do të jetë vrojtimi tremujor pranë të gjitha ndërmarrjeve aktive në Shqipëri për të gjitha format legale të përcaktuara në fushën e mbulimit të ATN, klasifikuar sipas Klasifikimit të Aktiviteteve Ekonomike, NVE Rev.1.1;

Burimet administrative nga zyrat urbanistike të bashkive dhe komunave në të gjithë territorin e vendit, me anë të Drejtorive të Statistikave në rrethe.

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Anketë tremujore pranë Ndërmarrjeve: Industri, Ndërtim, Tregti, Transport, Komunikacion, Hotele, Shërbime	2012	2013	2014	2015	2016

Moduli 3.02.01.02 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (IÇP)

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT aktualisht realizon vrojtimit tremujor pranë ndërmarrjeve ekonomike prodhuese që ushtrojnë aktivitetin e tyre në degën e industrisë. Qëllimi i këtij vrojtimi është mbledhja e informacionit mbi ecurinë e çmimeve të prodhimit të produkteve industriale të prodhuara nga ndërmarrjet prodhuese dhe të tregtuara prej tyre në tregun vendas dhe jo vendas. Të dhënat grumbullohen për ndërmarrjet me aktivitet prodhues në Industri nxjerrëse, Industri përpunuese, Energji elektrike, avull, ujë dhe gaz. Periodiciteti është tre mujor. Viti bazë - 2005.

Objektivat strategjikë

Objektivi kryesor i INSTAT-it për prodhimin e treguesit IÇP është llogaritja e saktë dhe në përputhje të plotë me metodologjinë e Eurostat-it të indekseve të çmimeve të prodhimit, mbështetur në rregulloren e Eurostat-it Nr. 1156 / 98 mbi Statistikat Afatshkurtra, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të metodologjisë ekzistuese duke iu referuar përdorimit të metodave dhe analizave statistikore më të avancuara që përdoren në llogaritjen dhe publikimin e statistikave evropiane.

Aktivitetet zbatuese

- Kryerja e vrojtimit tremujor pranë ndërmarrjeve industriale duke zbatuar kontrole të vazhdueshme të punës në terren, kontrollin e cilësisë së informacionit të mbledhur, editimit të të dhënave, etj;
- Përmirësim i cilësisë së llogaritjes së indikatorëve duke përdorur metodat statistikore mbështetur në metodologjitë përkatëse të secilit tregues.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Llogaritja e IÇP sipas aktiviteteve ekonomike;
- ✓ Llogaritja e deflatoreve për llogaritjen e treguesve të tjerë statistikorë në INSTAT;
- ✓ Të dhënat janë të disponueshme 50 ditë pas mbylljes së tremujorit në publikimin specifik "Indeksi i Çmimeve të Prodhimit", "Shqipëria në Shifra", "Vjetari statistikor", web: www.instat.gov.al.

Burimi informacionit

Burim informacioni janë:

- Ndërmarrjet ekonomike jobujqësore që ushtrojnë aktivitetin e tyre në prodhim dhe eksport;
- Të dhënat statistikore të Tregtisë së Jashtme të cilat përdoren për përditësimin e bazës së zgjedhjes së ndërmarrjeve dhe produkteve.

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Anketë tremujore pranë Ndërmarrjeve-Industri dhe Eksportuese Malli	2012	2013	2014	2015	2016

Moduli 3.02.01.03 Indeksi i Çmimeve të Importit (IÇI)

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT aktualisht nuk e llogarit Indeksin e Çmimeve të Importit dhe ky do të jetë një indikator i ri i cili do të jetë pjesë e këtij Programi. Llogaritja dhe publikimi i

këtij treguesi do të realizohet me asistencën e Sida-s (Agjencia Suedeze Ndërkombëtare për Zhvillim). Aktualisht ka filluar puna për ndërtimin e bazës së zgjedhjes së ndërmarrjeve dhe produkteve mbështetur në të dhënat statistikore të tregtisë së jashtme.

Objektivi strategjik

Objektivat kryesorë të INSTAT-it për këtë fushë janë kryesisht:

- Prodhimi i indeksit të çmimeve të importit sipas metodologjisë së Eurostatit.
- Sigurimi i një informacioni më të mirë dhe koherent për plotësimin në kohë të kërkesave të përdoruesve të ndryshëm;

Aktivitetet zbatuese

- Mbledhja e informacionit në terren me pyetësor me letër me anketues dhe metoda të tjera të kombinuara, si postë dhe webformë. Paralelisht llogariten peshat sipas grupeve dhe llogaritja e indeksit;
- Publikimi i Indekseve tremujore të tremujorit të parë në 2013 duke patur si vit bazë (2012 = 100);
- Mënyra e llogaritjes dhe e publikimit do të jetë e njëjtë si e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Llogaritja dhe publikimi i Indeksit të Çmimeve të Importit sipas aktiviteteve ekonomike;
- ✓ Llogaritja e deflatoreve të çmimeve të prodhimit me qëllim llogaritjen e PBB-së tremujore dhe vjetore me metodën e prodhimit.
- ✓ Të dhënat do të jenë të disponueshme 50 ditë pas mbylljes së tremujorit në publikim specifik "Indeksi i Çmimeve të Importit", web: www.instat.gov.al.

Burimi informacionit

Vrojtimi mbi çmimet e importit do të realizohet pranë ndërmarrjeve që kanë aktivitet të kryesor importin e mallrave në Shqipëri, të klasifikuara sipas Nomenklaturës së Aktiviteteve Ekonomike NVE Rev 1.1. Gjithashtu, një burim i rëndësishëm do të jetë edhe skedari i të dhënave të tregtisë së jashtme mbi import-eksportet.

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Anketë pranë ndërmarrjeve Industri dhe Importuese malli	-	2013	2014	2015	2016

Moduli 3.02.01.04 Indeksi i Kushtimit në Ndërtim, Gjithsej

Përshkrimi i situatës aktuale

Indeksi i kushtimit në ndërtim gjithsej përfshin koston në ndërtim për ndërtesat dhe punimet inxhinierike. INSTAT aktualisht llogarit koston në ndërtim për ndërtesat. Llogaritja në vitin 2012 e indeksit të koston për punimet inxhinierike do të mundësojë dhe llogaritjen e Indeksit të Kostos në Ndërtim Gjithsej.

Objektivi Strategjik

Objektivi kryesor i INSTAT-it është llogaritja e IKN-së gjithsej për koston e ndërtimit të ndërtesave për qëllime banimi dhe koston për punimet inxhinierike, në përputhje të plotë me rregulloren dhe metodologjinë e Eurostat-it.

Aktivitetet zbatuese

- Kryerja e vrojtimit tremujor mbi ndërmarrjet e ndërtimit që kryejnë punime inxhinierike në rrugë;
- Mbledhja e informacionit nga ndërmarrjet e ndërtimit që kanë për aktivitet kryesor ndërtimin e rrugëve, duke mbledhur projekt-preventivat nga ndërmarrjet e ndërtimit të rrugëve dhe duke marrë manualin e analizës teknike për punimet e ndërtimit të rrugëve;
- Kryerja e vrojtimit pilot nga INSTAT-i pranë një numri të kufizuar të ndërmarrjeve të ndërtimit të rrugëve për përcaktimin e shportës së materialeve dhe zërave të punimeve dhe llogaritjen e peshave të zërave;
- Llogaritja në periudha tremujore të indeksit, duke përdorur aplikacionin SQL.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Publikimi i indeksit tremujor i IKN-së gjithsej.
- ✓ Llogaritja e deflatoreve për llogaritjen e treguesve të tjerë statistikorë në INSTAT;

Burimi i Informacionit

Informacioni mblidhet pranë ndërmarrjeve tregtare që kanë aktivitetin kryesor tregtinë e materialeve të ndërtimit, pranë ndërmarrjeve të ndërtimit që për aktivitet kryesor kanë ndërtimin e ndërtesave për banim dhe pranë ndërmarrjeve që kanë aktivitet kryesor ndërtimin e rrugëve.

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
---------------------------------	-------------	-------------	-------------	-------------	-------------

Anketë pranë Ndërmarrjeve Tregtare- Material Ndërtimi	-	-	2014	2015	2016
--	---	---	------	------	------

Moduli 3.02.01.05 Indeksi i Kushtimit në Ndërtim, Ndërtesat

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT aktualisht llogarit IKN për ndërtesat, i cili mat ecurinë e çmimeve të materialeve të ndërtimit, fuqisë punëtore dhe shpenzimeve të tjera kapitale që përdoren në ndërtimin e një banese tip (8 – 10 kate). Periodiciteti i këtij treguesi është tremujor. Revizionimi i fundit i IKN-së është bërë në tremujorin e parë 2011. Duke filluar nga tremujori i parë i vitit 2011, IKN është llogaritur me shportën e re të materialeve dhe shpenzimeve. Peshat e këtyre materialeve janë llogaritur duke u bazuar në preventivat e shpenzimeve për ndërtimin e një banese shumëkatëshe, marrë nga firmat e ndërtimit.

Tremujori i parë i vitit 2011 shërben si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit (tremujori i parë 2011=100). Shporta e re përbëhet nga 73 zëra nga të cilat 68 janë materiale ndërtimi.

Çmimet për materialet e ndërtimit mbledhen nga 96 distributorë dhe shitës me shumicë të materialeve të ndërtimit. Ndërsa të dhënat për shpenzimet për pagat, makineritë dhe transportin merren nga 50 ndërmarrje të mëdha ndërtimi të përqendruara kryesisht në rrethin e Tiranës. Zgjedhja e ndërmarrjeve është bërë në bazë të volumit të ndërtimit që realizojnë ndërmarrjet gjatë një periudhe një vjeçare.

Shpenzimet janë klasifikuar në përputhje me klasifikimin që përdor Eurostat-i për IKN-n, në gjashtë grupe kryesore si më poshtë:

- Materiale ndërtimi;
- Shpenzime për paga;
- Shpenzime për makineri;
- Shpenzime transporti;
- Shpenzime për energji.

Objektivat Strategjikë

Objektivi kryesor i INSTAT-it për këtë fushë është prodhimi dhe publikimi i saktë dhe në kohë i IKN-së në përputhje të plotë me metodologjinë e Eurostat-it.

Gjithashtu, implementimi i mënyrave më të avancuara të grumbullimit dhe kontrollit të informacionit për plotësimin e kërkesave të përdoruesve të ndryshëm.

Aktivitetet zbatuese

- Kryerja e vrojtimit tremujor mbi ndërmarrjet tregtare të materialeve të ndërtimit dhe ndërmarrjeve të ndërtimit që kanë aktivitet kryesor ndërtimin e banesave tip;
- Vazhdimi i prodhimit të IKN-së bazuar në klasifikimin e shpenzimeve që përdor Eurostat-i;
- Llogaritja e indeksit me aplikacionin SQL, duke zëvendësuar llogaritjen në Excel që përdoret aktualisht.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Publikimi i indeksit tremujor të Indeksit të Kushtimit në Ndërtim për ndërtesat në nivel vendi;
- ✓ Llogaritja e deflatoreve për llogaritjen e treguesve të tjerë statistikorë në INSTAT;
- ✓ Të dhënat janë të disponueshme 50 ditë pas mbylljes së tremujorit në publikimin specifik "Indeksi i Kostos në Ndërtim", "Shqipëria në Shifra", "Vjetari statistikor", web: www.instat.gov.al.

Burimi i Informacionit

Informacioni mblidhet pranë ndërmarrjeve tregtare që kanë aktivitet kryesor tregtinë e materialeve të ndërtimit si dhe ndërmarrjet e ndërtimit që për aktivitet kryesor kanë ndërtimin e ndërtesave për banim.

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Anketë pranë Ndërmarrjeve Tregtare-Material Ndërtimi	2012	2013	2014	2015	2016

Moduli 3.02.01.06 Indeksi i Kushtimit në Ndërtim, Punimet Inxhinierike

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT aktualisht nuk llogarit IKN për punimet inxhinierike. Parashikohet që, në vitin 2012, të fillojë puna për grumbullimin e informacionit në mënyrë që të procedohet me përlllogaritjen e këtij treguesi.

Objektivat Strategjikë

Objektivi kryesor i INSTAT-it është llogaritja e IKN për punimet inxhinierike, në përputhje të plotë me rregulloren dhe metodologjinë e Eurostat-it. Të dhënat do të publikohen në nivel vendi.

Aktivitetet zbatuese

- Kryerja e vrojtimit tremujor mbi ndërmarrjet e ndërtimit që kryejnë punime inxhinierike;
- Mbledhja e informacionit nga ndërmarrjet e ndërtimit që kanë për aktivitet kryesor ndërtimin e rrugëve. Informacioni përfshin kryesisht mbledhjen e projekt-preventivave nga ndërmarrjet e ndërtimit të rrugëve dhe marrjen e manualit të analizës teknike për punimet e ndërtimit të rrugëve;
- Kryerja e një vrojtimi pilot nga INSTAT pranë një numri të kufizuar të ndërmarrjeve të ndërtimit të rrugëve;
- Përcaktimi i shportës së materialeve dhe zërave të punimeve dhe llogaritja e peshave të zërave;
- Llogaritja në periudha tremujore të indeksit, duke përdorur aplikacionin SQL.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Llogaritja e Indeksit tremujor të kostos në ndërtim për punimet inxhinierik;
- ✓ Publikimi tremujor i indeksit të kostos në ndërtim për punimet inxhinierike;
- ✓ Të dhënat janë të disponueshme 50 ditë pas mbylljes së tremujorit në publikimin specifik "Indeksi i Kushtimit në Punimet Inxhinierike", në 2013; web: www.instat.gov.al.

Burimi i Informacionit

Informacioni do të mblidhet pranë ndërmarrjeve që kanë aktivitet kryesor ndërtimin e rrugëve.

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Anketë pranë Ndërmarrjeve të Ndërtimit-Punime Inxhinierike (Rrugë)	-	2013	2014	2015	2016

Moduli 3.02.01.07 Lejet e ndërtimit të miratuara

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT grumbullon lejet e ndërtimit nëpërmjet Drejtorive të Statistikave në rrethe, në numër, sipërfaqe dhe vlerë; sipas llojit dhe sipas tipit të klientit, në nivel qarku dhe vendi.

Seria kohore e të dhënave tremujore fillon prej vitit 1993.

Objektivat strategjikë

Objektiv i këtij moduli në periudhën 2012-2016 është prodhimi i treguesve me cilësi të lartë dhe në kohë, duke respektuar Rregulloren e Eurostat-it mbi Statistikat Aftashkurtra. Përmirësimi i metodave të grumbullimit të të dhënave; shfrytëzimit me efikasitet të burimeve administrative; përmirësimi i treguesve.

Gjithashtu, zbatimi i klasifikimit evropian të ndërtimit me rigorozitet, rritja e bashkëpunimit me furnizuesit e të dhënave statistikore, janë objektiva të këtij moduli.

Aktivitetet zbatuese

- Grumbullimi në vazhdimësi i informacionit mbi lejet e ndërtimit nga zyrat e urbanistikës pranë komunave dhe bashkive.

Rezultatet e pritshme

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i aktiviteteve të parashikuara janë prodhimi i treguesve të mëposhtëm:

- ✓ Lejet e ndërtimit në numër, sipërfaqe, vlerë sipas llojeve të ndërtimit, në nivel rajonal dhe vendi;
- ✓ Lejet e ndërtimit sipas llojit dhe klientit;
- ✓ Lejet e ndërtimit në numër dhe sipërfaqe në nivel rajonal;

Të dhënat do të bëhen të disponueshme 60 ditë pas mbylljes së tremujorit në publikimin “Buletini Statistikor tremujor”, “Shqipëria në Shifra”, “Vjetari statistikor”, web: www.instat.gov.al.

Burimi i informacionit

Burimet administrative nga zyrat urbanistike të bashkive dhe komunave në të gjithë territorin e vendit, me anë të Drejtorive të Statistikave në rrethe.

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Të dhëna administrative pranë Komunave/ Bashkive (zyrat e urbanistikës)	2012	2013	2014	2015	2016

Tema 3.03 Energjia

Përshkrimi

INSTAT-i grumbullon të dhëna mujore dhe vjetore mbi sasinë e energjisë elektrike, gazit dhe naftës.

Gjithashtu, INSTAT-i prodhon Bilancin e Përgjithshëm të Energjisë dhe Bilancin e Energjisë Elektrike, bazuar në burimet administrative.

Prioritetet

Prioritet kryesor i INSTAT-it për përmbushjen e kësaj teme është përmirësimi i cilësisë dhe konsolidimit të të dhënave të energjisë.

Moduli 3.03.01.01 Statistikat strukturore të energjisë elektrike

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT grumbullon dhe publikon të dhëna mbi energjinë elektrike nga burime administrative dy herë në vit. Të dhënat i referohen prodhimit, shkëmbimit, konsumit të energjisë elektrike. Bilanci i Energjisë Elektrike është rezultati kryesor i këtyre të dhënave.

Objektiv strategjik

Në periudhën 2012-2016 objektiv strategjik është rritja e koordinimit me furnizuesit e të dhënave për përmirësimin e mëtejshëm cilësor dhe sasior të të dhënave të grumbulluara si dhe harmonizimi i variablave dhe definicioneve të të gjithë aktiviteteve të përfshirë në vrojtim me klasifikimet dhe definicionet e Eurostat-it.

Aktivitetet zbatuese

- Marrja dhe përpunimi i informacionit nga burimet administrative dhe publikimi i bilancit të energjisë elektrike në vazhdimësi.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Prodhimi i Bilancit të energjisë elektrike në publikimin specifik me periodicitet dy herë në vit "Bilanci i energjisë elektrike", "Vjetari statistikor", web: www.instat.gov.al.

Burimi informacionit

Burimi i informacionit janë Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës dhe Enti Rregullator i Energjisë.

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Treguesit mbi Energjinë nga burime administrative	2012	2013	2014	2015	2016

Moduli 3.03.01.02 Statistikat strukturore të energjisë

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT grumbullon të dhëna mbi prodhimin e naftës dhe gazit natyror nga burime administrative çdo vit. Bilanci i Përgjithshëm i Energjisë (përfshi edhe këtu energjinë elektrike) është rezultati kryesor i këtyre të dhënave.

Objektiv strategjik

Në periudhën 2012-2016 objektiv strategjik është:

Përmirësim i koordinimit me furnizuesit e të dhënave për përmirësimin e mëtejshëm cilësor dhe sasior të të dhënave të grumbulluara si dhe harmonizimi i variablave dhe definicioneve të të gjithë aktiviteteve të përfshirë në vërtetim me klasifikimet dhe definicionet e EUROSTAT-it.

Aktivitetet zbatuese

- Përpunimi i informacionit të marrë nga burimet administrative dhe publikimi i bilancit energjetik në vazhdimësi.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Prodhimi i Bilancit të përgjithshëm energjetik, në "Vjetari statistikor", web: www.instat.gov.al.

Burimi informacionit

Burimi i informacionit janë Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Treguesit mbi Energjinë nga burime administrative	2012	2013	2014	2015	2016

Moduli 3.03.02 Statistikat afatshkurtra të energjisë

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT grumbullon dhe publikon të dhëna mbi energjinë elektrike nga burime administrative në periudha mujore/tremujore. Të dhënat i referohen statistikave në volum mbi energjinë elektrike.

Gjithashtu INSTAT grumbullon të dhëna mbi prodhimin e naftës dhe gazit natyror në periudha tremujore. Statistikat në volum për produktet kryesore janë rezultati kryesor i këtyre të dhënave.

Objektiv strategjik

Në periudhën 2012-2016 objektiv strategjik është:

Përmirësim i koordinimit me furnizuesit e të dhënave për përmirësimin e mëtejshëm cilësor dhe sasior të të dhënave të grumbulluara si dhe harmonizimi i variablave dhe definicioneve të të gjithë aktiviteteve të përfshirë në vërtetim me klasifikimet dhe definicionet e Eurostat-it.

Aktivitetet zbatuese

- Përpunimi i informacionit të marrë nga burimet administrative dhe vërtetimet statistikore për produktet energjetike.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Prodhimi në vazhdimësi i statistikave mbi produktet energjetike në publikimin “Shqipëria në shifra”, “Vjetari statistikor”, web: www.instat.gov.al.

Burimi informacionit

Burimi i informacionit janë Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Treguesit mbi produktet energjetike nga burime administrative	2012	2013	2014	2015	2016

Tema 3.04 Transporti

Përshkrimi

Kjo temë përfshin aktivitetet që kryhen në:

- Transportin rrugor
- Transportin hekurudhor
- Transportin detar
- Transportin ajror

- Matjen e trafikut rrugor dhe hekurudhor
- Infrastrukturën dhe mjetet për çdo lloj transporti.

Statistikat e Transportit përfshijnë një sistem të gjerë informacioni mbi transportin e pasagjerëve dhe të mallrave. Infrastrukturën e linjave rrugore, hekurudhore etj si dhe mjetet për çdo lloj transporti në nivel kombëtar dhe rajonal. Gjithashtu, statistikat e transportit mbulojnë dhe matjen e trafikut rrugor dhe hekurudhor.

Prioritetet

Prodhimi i statistikave të konsoliduara dhe harmonizuara me kërkesat evropiane. Përmirësimi cilësor i statistikave të transportit për të gjitha llojet përfshirëse. Përfshirja e variablave të rinj dhe prodhimi i treguesve cilësorë, në përputhje me standardet evropiane..

Moduli 3.04.01.01 Sistemi i informacionit mbi statistikat e transportit

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT grumbullon dhe përpunon të dhënat administrative që merr nga MPPT dhe MB (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë) në periudha tremujore dhe vjetore. Treguesit vjetorë janë numri i mjeteve të transportit të mallrave dhe numri i mjeteve të transportit të pasagjerëve rrugorë, inventari i mjeteve hekurudhore dhe detare, gjatësia e rrjetit rrugor dhe hekurudhor. Ndërsa, në periudha tremujore merren të dhëna për transportin e pasagjerëve dhe mallrave në njësi fizike dhe për ton/km, volumet e ngarkim shkarkimit, numrin e aksidenteve dhe personave të aksidentuar në transportin rrugor.

Objektivi strategjik

Përmirësimi i cilësisë së prodhimit të treguesve afatshkurtër, me anë të kontrollit cilësor të të dhënave dhe shfrytëzimit me efikasitet të burimeve administrative.

Aktivitetet zbatuese

- Grumbullimi i të dhënave nga burime administrative sipas formularëve të përcaktuar në Programin e Statistikave Zyrtare, 2012-2014 dhe *metadata*-t e aktivitetit.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Treguesit në volum mbi infrastrukturën e rrjetit rrugor dhe hekurudhor;

- ✓ Numri i aksidenteve dhe numri i personave të aksidentuar;
- ✓ Inventari i mjeteve rrugore, për mallra dhe pasagjerë.
- ✓ Të dhënat janë të disponueshme për periudha tremujore në “Buletinin Statistikor”, dhe vjetore në “Vjetarin Statistikor”, “Shqipëria në Shifra” dhe në faqen elektronike www.instat.gov.al.

Burimi i informacionit

Burim Administrativ

- Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
- Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit)

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Treguesit mbi Transportin nga burime administrative	2012	2013	2014	2015	2016

Moduli 3.04.01.02 Aksidentet

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT grumbullon dhe përpunon të dhënat administrative që merr nga MB (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë) në periudha tremujore dhe vjetore mbi numrin e aksidenteve dhe personave të aksidentuar në transportin rrugor.

Objektivi strategjik

Në periudhën 2012-2016, objektivi strategjik i INSTAT është:

Përmirësimi i cilësisë së prodhimit të treguesve afatshkurtër, me anë të kontrollit cilësor të të dhënave dhe shfrytëzimit me efikasitet të burimeve administrative.

Aktivitetet zbatuese

- Grumbullimi i të dhënave nga burime administrative sipas formularëve të përcaktuar në Programin e Statistikave Zyrtare, 2012-2016 dhe *metadata*-t e aktivitetit.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Numri i aksidenteve dhe numri i personave të aksidentuar;
- ✓ Të dhënat janë të disponueshme për periudha tremujore në “Buletinin Statistikor”, dhe vjetore në “Vjetarin Statistikor”, “Shqipëria në Shifra” dhe në faqen elektronike www.instat.gov.al.

Burimi i informacionit

Burim Administrativ

- Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit)

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Treguesit mbi Transportin nga burime administrative	2012	2013	2014	2015	2016

Moduli 3.04.02 Statistika mbi transportin rrugor të pasagjerëve

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT aktualisht nuk kryen vrojtim kombëtar mbi lëvizjen e pasagjerëve dhe trafikun rrugor. Si rrjedhojë nuk prodhon aktualisht të dhëna mbi këta tregues.

Objektivi strategjik

Objektiv strategjik është organizimi në 2014 i një vrojtimi kombëtar mbi lëvizjen e pasagjerëve dhe trafikun rrugor në bashkëpunim me ministritë e linjës.

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Treguesit mbi Transportin nga vrojtim	-	-	2014	2015	2016

Moduli 3.04.03 Statistikat e transportit rrugor të mallrave

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT aktualisht nuk kryen vrojtim kombëtar mbi transportin rrugor të mallrave. Si rrjedhojë nuk prodhon aktualisht të dhëna mbi këta tregues.

Objektivi strategjik

Objektiv strategjik është organizimi në 2014 i një vrojtimi kombëtar mbi transportin rrugor të mallrave në bashkëpunim me ministritë e linjës.

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Treguesit mbi Transportin nga vrojtim	-	-	2014	2015	2016

Moduli 3.04.04 Statistikat e transportit hekurudhor

Përshkrimi i situatës aktuale

Statistikat e transportit hekurudhor sigurojnë të dhëna mbi volumin e mallrave të transportuara, numrin e pasagjerëve, aksidentet e ndodhura në rrjetin hekurudhor. INSTAT grumbullon dhe përpunon të dhënat administrative që merr nga Ministria Punëve Publike dhe Transportit.

Objektivi strategjik

Prodhimi i statistikave me cilësi dhe në kohë mbi transportin hekurudhor në mënyrë që të plotësojë rregullisht kërkesat e përdoruesve dhe të harmonizuara me rregulloren evropiane mbi transportin hekurudhor.

Aktivitetet zbatuese

- Grumbullim, kontroll dhe publikim i të dhënave administrative në periudha mujore dhe tremujore.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Treguesit statistikor mbi transportin hekurudhor në njësi fizike dhe për ton/km.
- ✓ Të dhënat publikohen tremujore në “Buletinin Statistikor” dhe vjetore në “Shqipëria në Shifra” dhe faqen elektronike www.instat.gov.al.

Burimi i Informacionit

Burim administrativ

Ministria Punëve Publike dhe Transportit (Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave)

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Treguesit mbi Transportin nga burime administrative	2012	2013	2014	2015	2016

Moduli 3.04.05 Statistikat e transportit detar

Përshkrimi i situatës aktuale

Statistikat e transportit detar sigurojnë të dhëna mbi volumin e ngarkim-shkarkimit të mallrave dhe pasagjerëve sipas porteve, hyrjet dhe daljet e anijeve me mallra të klasifikuara sipas Nomenklaturës Ndërkombëtare të Transportit të Mallrave (NSTR). INSTAT grumbullon dhe përpunon të dhënat administrative që merr nga Ministria Punëve Publike dhe Transportit. Treguesit kryesorë të grumbulluar janë për portet vendase.

Objektivi strategjik

Prodhimi i statistikave me cilësi dhe në kohë mbi transportin detar në mënyrë që të plotësojë rregullisht kërkesat e përdoruesve duke marrë parasysh dhe përditësimet e bazës ligjore, implementimi në nivel kombëtar i përmirësimeve të koncepteve metodologjike të harmonizuara me rregulloren evropiane mbi transportin detar.

Aktivitetet zbatuese

- Grumbullim, kontroll dhe publikim i të dhënave administrative në periudha mujore dhe tremujore;

Rezultatet e pritshme

- ✓ Treguesit statistikor mbi transportin detar në njësi fizike dhe për ton/km.
- ✓ Të dhënat publikohen për periudha tremujore në “Buletinin Statistikor” , vjetore në “Vjetarin Statistikor”, “Shqipëria në Shifra” dhe në faqen elektronike www.instat.gov.al.

Burimi i Informacionit

Ministria Punëve Publike dhe Transportit (Drejtoria e Përgjithshme e Porteve).

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Treguesit mbi Transportin nga burime administrative	2012	2013	2014	2015	2016

Moduli 3.04.06 Statistikat e transportit ajror

Përshkrimi i situatës aktuale

Statistikat e transportit ajror sigurojnë të dhëna mbi vëllimin e transportit të mallrave dhe numrin e pasagjerëve të këtij lloji transporti në seri kohore. INSTAT grumbullon dhe përpunon të dhënat administrative që merr nga MPPT për këtë fushë.

Objektivi strategjik

Prodhimi i statistikave me cilësi dhe në kohë mbi transportin ajror në mënyrë që të plotësojë rregullisht kërkesat e përdoruesve dhe të harmonizuara me rregulloren evropiane mbi transportin ajror.

Aktivitetet zbatuese

- Grumbullim, kontroll dhe publikimi i të dhënave administrative në periudha mujore dhe tremujore.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Treguesit statistikor mbi transportin ajror në njësi fizike, numri i kompanive të fluturimit dhe pronësia.
- ✓ Të dhënat publikohen për periudha tremujore në “Buletinin Statistikor”, vjetore në “Vjetarin Statistikor”, “Shqipëria në Shifra” dhe në faqen elektronike www.instat.gov.al.

Burimi i informacionit

Ministria Punëve Publike dhe Transportit.

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Treguesit mbi Transportin nga burime administrative	2012	2013	2014	2015	2016

Tema 3.05 Turizmi

Përshkrimi

INSTAT aktualisht trajton statistikat e turizmit në dy drejtime. Një drejtim është kapaciteti dhe frekuentimi i njësive akomoduese dhe ana tjetër janë hyrjet-daljet e shtetasve, të huaj apo shqiptare sipas pikave kufitare dhe sipas mjetit të udhëtimit; Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit dhe shtetit.

Të dhëna mbi kapacitetin dhe frekuentimin e njësive akomoduese (si numri i dhomave, shtretërve, klientëve, netë qëndrimi, punësimi, pagat etj, të dhëna të cilat merren nga vrojtimi ATN dhe vjetor ASN, përkatësisht në rubrikat specifike: Tregues specifike mbi hotelet janë përshkruar në Modulin 3.02.01.01 (Statistikat afatshkurtra të Ndërmarrjeve).

Objektivi i statistikave të turizmit është të publikojë informacion statistikor me cilësi mbi turizmin dhe te harmonizuar me standardet evropiane sipas direktivës se Këshillit Nr. 95/57/EC mbi mbledhjen e informacionit statistikor në fushën e turizmit.

Prioritetet

- Zhvillimi i statistikave të turizmit në përputhje me standardet evropiane dhe kërkesat e përdoruesve si në numër të treguesve, ashtu edhe në cilësi, bazuar

- në potencialin dhe rëndësinë e sektorit të turizmit për zhvillimin ekonomik të vendit;
- Sigurimi i informacionit mbi hyrje-daljet e shtetasve sipas rezidencës.

Moduli 3.05.01 Turizëm

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT mbledh përpunon dhe publikon informacion mbi statistikat e turizmit. Burimi i këtyre të dhënave është administrativ dhe vijnë nga MB-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë. Treguesit janë:

- Hyrje-daljet në kufi të shtetasve të huaj dhe shqiptarë sipas pikave kufitare
- Hyrje-daljet e shtetasve të huaj dhe shqiptarë sipas qëllimit të udhëtimit
- Hyrje-daljet e shtetasve të huaj dhe shqiptarë sipas qëllimit të udhëtimit;
- Përpunimi dhe publikimi i të dhënave specifike mbi hotelet dhe njësitë e tjera të akomodimit, bazuar në rezultatet nga vrojtimet statistikore.

Objektivi strategjik

Hartimi dhe publikimi i harmonizuar dhe me cilësi të lartë i statistikave të turizmit.

Aktivitetet zbatuese

- Grumbullim, kontroll dhe publikimi i të dhënave administrative në periudha mujore dhe tremujore.
- Përpunimi i të dhënave të grumbulluara nga vrojtimet statistikore tremujore dhe vjetore pranë ndërmarrjeve të klasifikuara nën aktivitetin Hotele.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Hyrje daljet në kufi të shtetasve të huaj dhe shqiptarë sipas pikave kufitare;
- ✓ Hyrje daljet e shtetasve të huaj dhe shqiptarë sipas qëllimit të udhëtimit dhe shtetit;
- ✓ Kapaciteti dhe frekuentimi i hoteleve sipas klientëve.
- ✓ Të dhënat publikohen për periudha tremujore në “Buletinin Statistikor”, vjetore në “Vjetarin Statistikor”, “Shqipëria në Shifra” dhe në faqen elektronike www.instat.gov.al.

Burim informacioni

Burim Administrativ

Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit).

Burim statistikor

Vrojtimi tremujor dhe vjetor pranë ndërmarrjeve të klasifikuara në Regjistrin e Ndërmarrjeve sipas klasifikimit ekonomik të aktiviteteve: Hotele ose Njësi të tjera akomodimi.

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Treguesit mbi Turizmin nga burime administrative	2012	2013	2014	2015	2016
Anketa Vjetore pranë Ndërmarrjeve	2011	2012	2013	2014	2015
Anketa Tremujore pranë ndërmarrjeve	2012	2013	2014	2015	2016

Tema 3.06 Regjistrat e Ndërmarrjeve

Përshkrimi

Objektivi i këtij moduli është të harmonizojë dhe të monitorojë cilësinë e regjistrave të ndërmarrjeve e njësive lokale, në përputhje me Rregulloren e EU mbi Regjistrat e Ndërmarrjeve (177/2008).

Regjistrat e njësive ekonomike, ndërmarrjeve dhe njësive lokale të tyre, kanë rëndësi si mjet për hartimin e statistikave të nevojshme për dhënien e indikatorëve afatshkurtër dhe të zhvillimeve strukturore ekonomike, për vrojtimet statistikore si dhe analiza demografike të popullsisë së ndërmarrjeve.

Prioritetet

Përgatitja e regjistrave statistikore të njësive ekonomike të përditësuar e cilësorë, sipas rekomandimeve të BE-së dhe kërkesave të brendshme.

Përmirësimi i cilësisë së vendndodhjes gjeografike nëpërmjet sistemit GIS nga përdorimi i GPS në çdo aktivitet statistikor.

Klasifikimi i aktivitetit ekonomik të ndërmarrjeve dhe njësive lokale me kodifikim të dyfishtë NACE Rev 1.1 dhe NACE Rev.2, sipas kërkesave të BE-së.

Moduli 3.06.01 Regjistrat e Ndërmarrjeve

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT, sipas rekomandimeve të BE-së, ka ndërtuar, mirëmban dhe është përgjegjës për tre regjistra statistikore: Regjistri i Njësive Ligjore, Regjistri i Ndërmarrjeve dhe Regjistri i Njësive lokale.

Regjistri i ndërmarrjeve përdoret si bazë për të realizuar vrojtimet me zgjedhje pranë tyre, kurse Regjistri i Njësive Lokale përdoret kryesisht për prodhimin e statistikave rajonale.

Një aplikim informatik është duke u përgatitur për përditësimin dhe menaxhimin e regjistrave të njësive ekonomike si dhe prodhimin e treguesve statistikorë prej tyre. Ky aplikim i shërben edhe sektorëve të tjerë brenda INSTAT-it për të konsultuar e përgatitur statistika që rrjedhin nga Regjistrat e Njësive Ekonomike.

Treguesit që prodhohen nga Regjistrat e Njësive Ekonomike, Ndërmarrjet e Njësitë lokale i përgjigjen kërkesave të BE-së si dhe kërkesave të brendshme.

Regjistri i Ndërmarrjeve përmban këta tregues:

- Tregues identifikues, Forma ligjore, Pronësia, Emri, Adresa, Komunikimi (Tel, Faks etj.).
- Tregues shtresorë, aktiviteti ekonomik kryesor, madhësia sipas të punësuarve, madhësia sipas xhiros, vendndodhja gjeografike.
- Ndryshimet demografike, data e krijimit, data e mbarimit.

Regjistri i Njësive Lokale përmban këta tregues:

- Tregues identifikues, emri, adresa, komunikimi (Tel, Faks etj.);
- Tregues shtresorë, aktiviteti ekonomik kryesor, madhësia sipas të punësuarve, vendndodhja gjeografike;
- Ndryshimet demografike, data e krijimit, data e mbarimit.

Objektivi Strategjik

Përgatitja e regjistrave statistikorë të njësive ekonomike të përditësuar e cilësorë, si dhe prodhimi në kohë e me cilësi i treguesve në përputhje me rekomandimet e BE-së si dhe kërkesave të brendshme.

Aktivitetet zbatuese

- Përdorimi me prioritet i të dhënave administrative si dhe nga anketat e INSTAT-it për përditësimin e regjistrave statistikorë të njësive ekonomike;
- Përdorimi i aparateve GPS në çdo aktivitet statistikor me qëllim përditësimin dhe përmirësimin e cilësisë së vendndodhjes gjeografike nëpërmjet sistemit GIS;
- Aplikimi i nomenklaturës së re ekonomike NACE Rev 2 në regjistrat e njësive ekonomike sipas kërkesave të BE-së;
- Kryerja e anketave specifike për përditësimin e regjistrave statistikorë të njësive ekonomike, ajo ekzistuese me periodicitet tremujor “Anketa e Ndërmarrjeve të Reja” si dhe futja në program e anketës së re vjetore “Anketa e Njësive Lokale”;
- Standardizimi i rubrikës për treguesit si pjesë e anketave të ndryshme dhe që shërben për përditësimin e regjistrave statistikor të njësive ekonomike.

- Përfundimi dhe vënia në përdorim i aplikimit informatik për përditësimin dhe menaxhimin e regjistrave të njësive ekonomike si dhe prodhimin e treguesve statistikore prej tyre.

Periodiciteti i aktiviteteve statistikore:

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Regjistri statistikor i ndërmarrjeve ekonomike jo-bujqësore, përditësimi	x	x	x	x	x
Regjistri statistikor i njësive lokale, përditësimi	x	x	x	x	x
Anketa pranë ndërmarrjeve të reja, 3 mujore	x	x	x	x	x
Anketa e Njësive Lokale, vjetore	x	x	x	x	x

Rezultatet e pritshme

- ✓ Regjistra statistikore të njësive ekonomike, të përditësuar e cilësorë, sipas rekomandimeve të BE-së dhe kërkesave të brendshme;
- ✓ Regjistra statistikore të njësive ekonomike, me kodifikim të dyfishtë të aktivitetit ekonomik, NACE Rev 1.1 dhe NACE Rev.2;
- ✓ Adresa të kodifikuara sipas koordinatave gjeografike për qytete e mëdha sipas sistemit GIS nga përdorimit i GPS në çdo aktivitet statistikor;
- ✓ Prodhimi dhe botimi në afat e cilësi të treguesve nga regjistrat e ndërmarrjeve sipas kërkesave të BE-së dhe ato të brendshme. Treguesit statistikore që prodhohen janë grupimet e ndërmarrjeve sipas formës ligjore, pronësisë, aktivitetit ekonomik, madhësisë sipas të punësuarve, madhësisë sipas të xhiros, vendndodhjes gjeografike.

Burimi i Informacionit

Burime Administrative

Qendra Kombëtare e Regjistrimit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Llogaritë vjetore të ndërmarrjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Burime Statistikore

Anketa e Ndërmarrjeve të Reja, Anketa e Njësive Lokale, Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve, Anketa Tremujore pranë Ndërmarrjeve, Anketa e Çmimeve të Prodhimit e të tjera.

Burime Njerëzore, Kosto

Personel	2012	2013	2014	2015	2016	Frekuenca	Periudha
Specialistë	5	6	6	6	6	vjetore	Janar-Dhjetor
Anketues	50	60	70	70	70	4herë / vit	Janar, Maj, Shtator, Nëntor
Kontrollor	1	1	1	1	1	vjetore	Janar-Dhjetor

FUSHA 4 – STATISTIKAT E BUJQËSISË, PYJEVE DHE PESHKIMIT

Tema: 4.01 Statistikat bujqësore

Përshkrimi

Statistikat e prodhimit bujqësor përfshijnë të dhënat e prodhimit bimor dhe blegtoral. Statistikat e prodhimit bimor mbulojnë drithërat, bimët industriale, të tjera bimë të arave, perimet, frutat, agrumet, ullirin dhe vreshtat. Të dhënat për kulturat kryesore dhe sekondare janë mbledhur, përpunuar dhe vlerësuar si në fushë të hapur, ashtu edhe në sera. Burime të dhënash për prodhimin bimor janë: vrojtimi vjetor bujqësor, vrojtimi gjashtëmuor si dhe vrojtimit e serave dhe të fermave të mëdha. Statistikat e prodhimit bimor janë sipërfaqja, rendimenti dhe prodhimi.

Statistikat e prodhimit blegtoral mbulojnë statistikën e blegtorisë si dhe mishit, qumështit dhe produkteve të shpendëve. Të dhënat janë grumbulluar për numrin e krerëve, produktivitetin blegtoral dhe prodhimin blegtoral në nivel prefekturë.

Pyetësi i vrojtimit vjetor është përmirësuar dhe sigurohen të dhëna për përdorimin e produkteve bujqësore, çmimet për këto produkte dhe shpenzimet në bujqësi. Vlerësimi i numrit të krerëve është bazuar në lëvizjen e blegtorisë për secilën kategori të gjedhëve, të leshtave dhe të dhirtave, dërrit, njëhundra të dhe shpendëve. Numri i krerëve i referohet gjendjes në fund të vitit. Statistikat e qumështit përfshijnë prodhimin e qumështit në fermë nga lopët, delet dhe dhitë. Të dhënat e qumështit merren sipas destinacionit të përdorimit. Këto të dhëna përdoren nga institucionet kombëtare, institucionet vendimmarrëse, shkencore dhe publiku i gjerë për bërjen e politikave, menaxhimin e risqeve, analizat e tregut dhe parashikimet e prodhimit.

Përpyetje të konsiderueshme janë bërë për të siguruar të dhëna cilësore dhe sasiore për statistikat e prodhimit bujqësor.

Fushat e aktiviteteve të mbuluara në këtë temë janë:

- Statistikat e prodhimeve nga bimët
- Blegtoria, mishi dhe vezët
- Statistika të qumështit dhe përpunimi i tij
- Bilanci prodhim - përdorim i produkteve bujqësore
- Statistika të vreshtarisë
- Statistikat e frutikulturës, agrume, ullinj etj

Prioritetet

- Regjistrimi i përgjithshëm i bujqësisë, i cili do të japë mundësinë e krijimit të regjistrave të veçantë për gjedhët, të leshtat dhe të dhirtat, derra, shpendët njëhundurakë. Kjo do të krijojë mundësinë e përmirësimit të treguesve statistikorë për blegtorinë;
- Implementimi i metodologjive të harmonizuara me rekomandimet e BE-së në mbledhjen me anë të vrojtimeve statistikore, përpunimin, dhe publikimin e statistikave të bujqësisë, blegtorisë, pyjeve dhe peshkimit në Shqipëri;
- Kryerja në kohë dhe me cilësi të gjitha fazave të punës të vrojtimeve. Kjo do të krijojë mundësinë për grumbullimin e të dhënave për prodhimin e mishit, tregtimin e kafshëve të gjalla, parashikimet e prodhimit, furnizimit me bilancet të aktivitetit të blegtorisë si dhe struktura e shpendëve dhe prodhimin e vezëve;
- Publikimi i të dhënave vjetore në nivel rajonal dhe kombëtar.

Moduli: 4.01.01 Statistikat e produkteve bimore

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT-i grumbullon nga MBUMK, të dhënat mbi sipërfaqen (numrin e rrënjëve), rendimentin, prodhimin për fermat private, fermat e mëdha dhe serat.

Statistikat e produkteve bimore nënkuptojnë grumbullimin, përpunimin dhe llogaritjen e indikatorëve: sipërfaqe e mbjellë, rendimenti dhe prodhimi i korrur. Këto statistika përfshijnë:

Bimët e arave: drithërat (grurë, misër, elb, thekër, tërshërë), perimet, pataten, fasulen, bimët industriale (luledielli, sojë dhe duhan) si dhe bimët foragjere (misër foragjer, jonxhë dhe të tjera foragjere njëvjeçare).

Kulturat drufrutore: në këtë grup përfshihen pemët frutore, agrumet, ullinjë dhe rrushi.

Të dhënat janë vjetore, sipas vitit kalendarik. Sipërfaqja është shprehur në *ha*, rendimenti në *kv/ha* dhe prodhimi në ton. Përjashtim bëjnë pemët frutore. Për pemëtoret në blloqe, të dhënat që disponohen janë në *ha* dhe në numër rrënjësh, ndërsa për pemët e shpërndara e dhëna është vetëm në numër rrënjësh. Pra, për statistikën e pemëve frutore përdorim numër rrënjësh në total, rendiment për numër rrënjësh dhe prodhimin në ton.

Objektivat Strategjikë

- Statistikat e prodhimit bimor do të vendosen mbi një bazë të re pas Regjistrimit të Përgjithshëm të Bujqësisë, i cili do të implementohet në Tetor të 2012. Me realizimin e këtij regjistrimi do të krijohet mundësia e krijimit të regjistrave të veçantë për bimët e arave, pemët frutore, vreshtat dhe ullirin, që do të jenë bazë për vërtetimet me zgjedhje, të veçanta sipas grup kulturave;
- Harmonizimi i instrumenteve metodologjike me standardet e BE-së;
- Grumbullimi dhe shfrytëzimi i të gjitha burimeve të të dhënave, si statistikore ashtu dhe administrative.
- Grumbullimi i të dhënave për rrushin sipas përdorimit; për tavolinë dhe prodhim verë do të jetë një ndër prioritetet tona në të ardhmen;
- Përdorimi i klasifikimeve kombëtare dhe ndërkombëtare për verën dhe prodhimin e rrushit;
- Harmonizimi i metodologjisë me standardet evropiane.

Aktivitetet zbatuese

INSTAT mbledh, përpunon dhe publikon statistikën vjetore mbi prodhimin e produkteve bujqësore. Popullata bazohet në njësitë ekonomike bujqësore (NJE) me aktivitet bujqësor që prodhojnë produkte bimore.

Klasifikimi i NJE është bërë sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE.

Të dhënat grumbullohen me:

- vërtetimi vjetor mbi sipërfaqen e korrur, prodhimin;
- vërtetimi i sipërfaqes së mbjellë;
- vërtetimi vjetor në fermat e mëdha dhe ndërmarrjet bujqësore;
- vërtetimi vjetor në serrat;
- vërtetimi shumëvjeçar në pemët frutore;

Grumbullimi i informacionit do të bëhet nëpërmjet intervistës së drejtpërdrejtë me anketues. Treguesit paraqiten sipas kulturave gjithsej, sipas tipologjisë së NJE. Si bazë e zgjedhje shërben regjistri i statistikor i fermës.

Të dhënat publikohen në botimin e veçantë Vjetari Statistikor i Bujqësisë, në Vjetarin Statistikor dhe faqen web të INSTAT :www.instat.gov.al.

Ndër të tjera, aktivitetet zbatuese do të jenë edhe:

- Kryerja e vrojtimeve të specializuara në vitin 2013 sipas grup kulturave: pemë frutore; ulli, vreshta, agrume, bimë të arave;
- Kryerja e vrojtimeve të veçanta në vitin 2013 për rrushin dhe verërat;
- Grumbullimi i të dhënave për kopshtet (*kitchen garden*).

Rezultatet e pritshme

- ✓ Tregues statistikorë si sipërfaqe, prodhim dhe rendiment për drithërat. Rezultate Paraprake dhe Finale. Periodicitet vjetor;
- ✓ Tregues statistikorë si sipërfaqe, prodhim dhe rendiment për bimët e tjera të mbjella në fushë. Rezultate Paraprake dhe Finale. Periodicitet vjetor;
- ✓ Tregues statistikorë si sipërfaqe, prodhim dhe rendiment për frutat, vreshtat, agrumet dhe ulliri. Rezultate Paraprake dhe Finale. Periodicitet vjetor.

Burimi Informacionit

- Njësitë ekonomike me aktivitet bujqësor, të të gjitha formave ligjore.

Moduli 4.01.02 Statistika të blegtorisë, mishit dhe vezëve

Përshkrimi i situatës aktuale

Të dhënat mbi blegtorinë grumbullohen nga vrojtimi vjetor i Ministrisë së Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Klasifikimi i aktiviteteve kombëtare për blegtorinë është bazuar tek NVE Rev.1.1

Qëllimi i këtij moduli është që të sigurojë të dhëna të harmonizuara rajonale, kombëtare në lidhje me numrin e krerëve të blegtorisë sipas llojeve: gjedhë, të imta, derra, shpendë. Prodhimi i mishit, tregtimi i kafshëve të gjalla, parashikimet e prodhimit, ndërtimi i bilanceve për numrin e krerëve dhe prodhimin e mishit si dhe struktura e shpendëve për vezë.

Grumbullimi i të dhënave kryhet nëpërmjet vrojtimeve me zgjedhje duke përdorur Sipërfaqen Kampion të Kufizuar (ASF). Kampioni i vrotimit është i ndërtuar në atë mënyrë që të jetë përfaqësuese për të gjithë vendin. Ai prezanton të gjitha variablat. Vlerësimi i numrit të krerëve është bazuar në lëvizjen e blegtorisë për secilën kategori të gjedhëve, të leshtave dhe të të dhirtave. Vlerësimi për prodhimin e mishit për secilën kategori është bazuar në përlogaritjet e bëra për lëvizjen e blegtorisë, pra në numrin e krerëve të skartuar dhe në peshën mesatare për krerët e therur. Të dhënat për therjet janë vjetore.

Të dhënat për numrin e pulave dhe prodhimin e vezëve janë vjetore. Bilancet e mishit dhe të vezëve nuk botohen.

Parashikimi për numrin e krerëve dhe prodhimet blegtorale bazohet në bilancin e numrit të krerëve të vrojtimit vjetor, si dhe vlerësimin e ekspertëve të MBUMK.

Objektivat Strategjikë

- Prodhimi në kohë e me cilësi i treguesve ekzistues të numrit të krerëve të blegtorisë, prodhimin e mishit dhe struktura e shpendëve në përputhje të plotë me metodologjinë e Eurostat-it.
- Zbatimi i treguesve të tjerë sipas kërkesave të BE-së.

Aktivitetet zbatuese

- Zbatimi i një programi të ri për vrojtimit në blegtori do të shoqërohet me përmirësimin e metodologjisë së vrojtimit.
- Përmirësimi i vazhdueshëm metodologjik, do të kryhet duke u mbështetur në manualët dhe rregulloret që Eurostat përditëson për këtë fushë statistikore;
- Zbatimi i Rregullores së BE-së nr 1165/2008 mbi vrojtimitin e strukturës së blegtorisë

Rezultatet e pritshme

- ✓ Struktura e numrit të krerëve në gjedhë;
- ✓ Struktura e numrit të krerëve në të imta (të leshta dhe të dhirta);
- ✓ Struktura e numrit të krerëve në derra;
- ✓ Struktura e numrit të krerëve të shpendëve dhe numri i pulave për kllaçitje (për prodhim për vezë);
- ✓ Prodhimi i mishit sipas llojeve të blegtorisë;
- ✓ Prodhimi i vezëve për konsum dhe për kllaçitje;

Burimi i Informacionit

Vrojtim dy herë në vit për numrin e krerëve të blegtorisë sipas llojeve .

Moduli 4.01.03 Statistikat e qumështit dhe të produkteve të qumështit

Përshkrimi i situatës aktuale

Të dhënat mbi statistikat e prodhimit të qumështit dhe të produkteve të tij grumbullohen nga vrojtimi vjetor i MBUMK. Vlerësimi i prodhimit të qumështit nga lopët është bërë duke u bazuar në numrin mesatar vjetor të tyre, që rezulton nga lëvizja e blegtorisë, dhe në rendimentin mesatar të qumështit për lopë të llogaritur

nga MBUMK. I njëjti arsyetim është ndjekur edhe për prodhimin e qumështit nga delet dhe dhitë, por me ndryshim se sipas metodologjisë, numri i krerëve i referohet gjendjes në fillim të vitit.

Objektivi Strategjik

Prodhimi në kohë e me cilësi i treguesve ekzistues të sasisë së prodhimit të qumështit sipas përmbajtjes së yndyrës dhe proteinave. Informacioni do të mblidhet për prodhimin sipas llojeve: qumësht nga lopët, delet dhe dhitë. Informacioni do të mblidhet dhe për konsumin, import-eksportet si dhe për produktet nga qumështi .

Aktivitetet zbatuese

- Zbatimi i një programi të ri për vrojtimit statistikore për qumështin dhe produktet nga qumështi. Kjo do të shoqërohet me përmirësimin e metodologjisë së vrojtimit statistikor.
- Përmirësimi i vazhdueshëm metodologjik, i cili do të kryhet duke u mbështetur në manualet dhe rregulloret që Eurostat përditëson për këtë fushë statistikore, si zbatimi i Direktivës 96/16/EC në vrojtimit statistikore për qumështin dhe produktet e tij.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Mbledhja e të dhënave për prodhimin e qumështit sipas yndyrës dhe përmbajtjes së proteinave. Të dhënat do të mblidhen për shitjet direkte, konsumin vetiak nga fermerët si dhe për produktet e qumështit: djathë, gjalpë, kos, gjizë.

Burimi i Informacionit

Burimi statistikor:

Vrojtim dy herë në vit për prodhimin e qumështit sipas llojeve të blegtorisë;

Burim administrativ:

Të dhëna shtesë nga burime administrative (nga MBUMK).

Tema 4.02 Strukturat bujqësore

Përshkrimi

Bazuar në të dhënat e mbledhura nëpërmjet vrojtimeve periodike dhe Censurit të Bujqësisë sintetizohen tregues me anën e të cilëve njihet struktura bujqësore në të gjitha degët e saj.

Strukturat bujqësore përfshijnë të gjitha llojet e organizimit të fermave bujqësore, blegtorale, mikse apo çdo lloj tjetër organizimi që përmbush në princip definicionin për të qenë njësi ekonomike bujqësore.

Fushat e aktiviteteve të mbuluara në këtë temë janë:

Regjistrimi i Përgjithshëm i Bujqësisë, vrojtimit periodike dhe të veçanta si dhe të dhënat administrative mbi njësitë ekonomike bujqësore të cilat përbëjnë aktivitetet bazë nëpërmjet të cilave do sigurohet materiali fillestar për të ndërtuar panoramën e strukturës së bujqësisë.

Objekt vrojtimi për strukturën e bujqësisë do jenë pa përjashtim të gjitha njësitë ekonomike bujqësore që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Prioritetet

Përditësimi i gjendjes pas çdo vrojtimi dhe përgjithësimi i rezultateve të arritura bazuar në kriteret metodike të rekomanduar nga Eurostat-i përbën prioritet ndër aktivitetet për strukturën e fermës në Shqipëri.

Moduli 4.02.01 Vrojtimit mbi strukturën e fermës

Përshkrimi i situatës aktuale

Vrojtime të posaçme mbi strukturën e fermës nuk janë realizuar që nga viti 1998, kohë në të cilën është bërë regjistrimi i fundit i përgjithshëm në bujqësi. Të dhëna të pjesshme mbi strukturën e fermës janë mbledhur çdo vit nga MBUMK nëpërmjet vrojtimit vjetor të bujqësisë.

Objektivi Strategjik

Pas Regjistrimit të Përgjithshëm të Bujqësisë, nga i cili do përfitohet Regjistri i Fermave Bujqësore, synohet të organizohen vrojtme të posaçme për strukturën e fermës një herë në 3 vjet, duke filluar në vitin e tretë pas regjistrimit. Të dhëna të limituara për strukturën e fermës do mblidhen e publikohen çdo vit duke i mbledhur nëpërmjet vrojtmeve vjetore e gjysmë vjetore të bujqësisë.

Aktivitetet zbatuese

- Ndërtimi dhe përditësimi i regjistrit të përgjithshëm të fermave me aktivitet bujqësorë në Shqipëri;
- Organizim i sistemit të vrojtmeve në bujqësi bazuar në këtë regjistër;

- Përpunimi i të dhënave dhe publikimi i rezultateve të përgjithësuara në botime dhe media, në shërbim të përdoruesve të statistikave bujqësore.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Panorama reale e strukturës së bujqësisë në Shqipëri është një ndër kriteret kryesore logjike për të orientuar vendimmarrjen në këtë fushë si nga nivelet e politikbërësve dhe nga ato ekzekutive, ashtu dhe nga institucionet ndërkombëtare me të cilët bashkëpunojmë si dhe bizneset e lidhura më bujqësinë.

Burimi i Informacionit

Vrojtimet statistikore periodike dhe të veçanta realizuar nga INSTAT.

Tema 4.03 Përdorimi dhe mbulimi i tokës

Përshkrimi

Statistikat e mbulimit dhe përdorimit të tokës janë të rëndësishme në implementimin dhe vlerësimin e politikave të përbashkëta bujqësore dhe mjedisore. Statistikat e përdorimit të tokës llogariten mbi bazën e kulturave kryesore në tokë të punueshme, livadhet dhe kullota si dhe sipërfaqen me pemëtari dhe kopshte.

Prioritetet

Të sigurohen të dhëna që mundësojnë analizat e ndërveprimeve midis bujqësisë, mjedisit dhe peizazhit. Përdorimi i këtyre të dhënave është i nevojshëm për prodhimin e disa indikatorëve agro-mjedisorë si erozioni i tokës, cilësia e tokës dhe diversiteti.

Moduli 4.03.01 Statistikat e përdorimit dhe mbulimit të tokës

Përshkrimi i situatës aktuale

Statistikat e mbulimit dhe përdorimit të tokës janë të rëndësishme në implementimin dhe vlerësimin e politikave të përbashkëta bujqësore dhe mjedisore. INSTAT-i përpunon dhe prodhon statistika për përdorimin e tokës mbi bazën e të dhënave të statistikore dhe administrative të grumbulluara nga MBUMK, MMPAU dhe MB.

Objektivi strategjik

Të sigurojë informacion të saktë:

- mbi madhësinë dhe përbërjen e sipërfaqes bujqësore të përdorur sipas kategorive të përdorimit të tokës (qark, rajon dhe total vendi), tipit të zotërimit dhe sipas njësive gjeografike;
- mbi madhësinë dhe përbërjen e prodhimit të serave dhe përdorimin e sipërfaqes së tokës së punëshme sipas strukturës së sipërfaqes së mbjellë;
- Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional me MBUMK, MMPAU, MB.

Aktivitetet zbatuese

- Vrojtme statistikore për:
 - Sipërfaqen e mbjellë;
 - Vrojtmet e serave.
- Përdorimi i burimeve administrative mbi bazën e formateve të nevojshme të përgatitura nga INSTAT-i;
- Përdorimi i klasifikimeve:
 - Nomenklatura e Aktiviteteve Ekonomike NVE Rev.2;
 - Klasifikimi i ndarjes territoriale NUTS 2 dhe NUTS 3;
 - Klasifikimi statistikor i kategorive të përdorimit të tokës.
- Publikimi i të dhënave në botime të veçanta për treguesit bujqësorë, si: “Shqipëria në Shifra”, “Vjetari Statistikor”, faqe elektronike zyrtare.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Publikimi i rezultateve për tokën bujqësore të përdorur, tokën e punëshme sipas kategorive, livadhet dhe kullotat si dhe tokën e zënë me pemëtore (pemë frutore, ullinj, agrume dhe vreshta)

Burimi i informacionit

- Njësitë ekonomike bujqësore (ferma dhe ndërmarrje bujqësore);
- Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
- Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
- Ministria e Brendshme.

Tema 4.04 Llogaritë e bujqësisë dhe çmimet

Përshkrimi

Llogaritë ekonomike të bujqësisë dhe statistikat e çmimeve bujqësore luajnë një rol kyç në projektimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave të përbashkëta bujqësore si dhe në vlerësimin e ndikimit të PBB-së, mbi gjendjen ekonomike të

bujqësisë në vend. Çmimet e prodhimeve bujqësore mblidhen rregullisht çdo muaj. Indeksi i çmimeve bujqësore tregon ecurinë e çmimeve sipas muajve dhe sezonit. INSTAT-i nuk llogarit indeksin e çmimeve bujqësore.

Prioritetet

Regjistrimi i Përgjithshëm i Bujqësisë do t'i mundësojë INSTAT-it krijimin e një baze të regjistrit të fermave bujqësore në përputhje me aktet ligjore të BE-së në lidhje me strukturën e fermës. Gjithashtu, ky regjistrim do të përmirësojë bazën për vrojtimit statistikore në bujqësi si dhe llogaritë ekonomike në bujqësi.

Grumbullimi i çmimeve nëpërmjet vrojtimit mujore do krijojë mundësinë e llogaritjes së indeksit të çmimeve bujqësore.

Moduli 4.04.01 Llogaritë ekonomike bujqësore dhe çmimet

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT-i mbledh, përpunon dhe publikon statistikën e llogarive ekonomike të bujqësisë bazuar në informacionin statistikor të marrë nga MBUMK. Kjo ministri ka qenë burimi kryesor, deri në vitin 2011, për mbledhjen e informacionit statistikor në bujqësi. Si bazë ligjore për vrojtimit në fermat bujqësore është përdorur ligji i statistikave zyrtare. Pyetësi i vrojtimit vjetor është përmirësuar dhe jep të dhëna për përdorimin e të gjitha produkteve bujqësore, çmimet për këto produkte dhe shpenzimet në bujqësi. Një vlerësimin për numrin e krerëve për çdo kategori të kafshëve është zhvilluar në fund të vitit 2011. Statistikat e qumështit përfshijnë prodhimin e qumështit të lopëve, deleve dhe dhive. Të dhënat për qumështin merren sipas destinacionit të përdorimit. Të dhëna grumbullohen dhe për nënproduktet nga qumështi dhe përpunimi i produkteve të tjera bujqësore. Vlerësimet për mbjelljet e reja në pemëtari për llogaritjen Formimit të Kapitalit Fix Bruto bëhen nga të dhënat statistikore dhe administrative të MBUMK-së.

Të dhënat statistikore kanë shërbyer si një burim kryesor për llogaritjen tremujore dhe vjetore të llogarive ekonomike në bujqësi. Llogaritjet ekonomike të bujqësisë janë mundësuar në sajë të zbatimit të koncepteve, parimeve dhe rregullave bazë për përpilimin e llogarive të përcaktuara në Manualin mbi Llogaritë Ekonomike të Bujqësisë EAA 1997, (Rev. 1.1). Klasifikimi i aktivitetit bujqësor është bërë në përputhje me Klasifikimin Evropian NACE Rev1.1, Seksioni A- Bujqësia, gjuetia dhe pyjet.

Objektivi Strategjik

- Përmirësimi i metodologjisë së vrojtimit vjetor duke kaluar nga vrojtimi me segmente i kryer deri tani nga MBUMK, në vrojtimin me listë i cili do të kryhet nga INSTAT-i mbas Regjistrimit të Përgjithshëm të Bujqësisë. Kjo do të krijojë mundësinë e rritjes së mostrës së vrojtimit dhe përmirësimin e statistikave të bujqësisë në sasi dhe cilësi;
- Llogaritja e indekseve mujore, tremujore dhe vjetore të *output*-it dhe *input*-it do të rrisë cilësinë e treguesve të llogarive vjetore, tremujore dhe rajonale.

Aktivitetet zbatuese

- Vrojtimi gjashtëmujor i serave, fermave të mëdha dhe vrojtimi vjetor në fermat bujqësore për prodhimet, shpenzimet, çmimet, numrin e krerëve, bazuar në rekomandime dhe manuale të BE-së;
- Përdorimi i të gjitha burimeve administrative të MBUMK-së dhe agjencive të tjera statistikore;
- Grumbullimi mujor i çmimeve bujqësore si dhe llogaritja e indeksit të çmimeve *output*-it dhe *input*-it duke zbatuar një program të ri për grumbullimin e të dhënave.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Llogaritë ekonomike bujqësore me periodicitet tremujor;
- ✓ Llogaritë ekonomike bujqësore me periodicitet –vjetor;
- ✓ Llogaritë ekonomike bujqësore në nivel rajonal;
- ✓ Indeksi i çmimeve të produkteve bujqësore;
- ✓ Indeksi i *input*-eve bujqësore;
- ✓ Çmime absolute të llogaritura.

Burimi i Informacionit

Njësitë ekonomike bujqësore dhe blegtorale; ndërmarrjet bujqësore dhe blegtorale.

Tema 4.05 Statistikat e Pylltarisë

Përshkrimi

Statistikat e pyjeve sigurojnë të dhëna të përgjithshme dhe specifike mbi pyjet, kullotat, livadhet, florën dhe faunën, speciet e mbrojtura dhe sipërfaqet e mbrojtura. Këto të dhëna janë vjetore në nivel kombëtar. Institucioni përgjegjës për të grumbulluar këto të dhëna është MMPAU. Të dhënat mbi statistikat e pyjeve janë të dhënat administrative kadastrale të fondit pyjor dhe kullotat në Shqipëri. Ato i

referohen si fondit pyjor shtetëror, ashtu dhe atyre komunale e private, strukturës së këtij fondi, formave të mbarështimit, investimet e realizuara në pyje, kundërvajtjet në pyje dhe kullota, rrjeti i zonave të mbrojtura, shfrytëzimi i pyjeve dhe produkteve kryesore të pyllit, të ardhurat nga aktivitetet kryesore e sekondare të pyjeve dhe kullotave, speciet e kërcënuara (flora dhe fauna), speciet e mbrojtura (flora dhe fauna) dhe të dhëna për zonat e mbrojtura sipas kategorive.

Fusha e mbulimit nga statistikat e Pylltarisë:

- Të gjitha aktivitetet dhe të dhëna të tjera lidhur me pyjet dhe kullotat në fondin pyjor si dhe produktet nga pyjet, pavarësisht nga pronësia apo mënyra e menaxhimit të tyre;
- Të dhënat vjetore të mbledhura për prodhimin dhe shitjen e lëndës drusore dhe asortimenteve lëndë e parë prej druri;
- Mbledhje të dhënash ekonomike për pylltarinë dhe shfrytëzimin e produkteve nga pyjet duke përdorur Llogaritë ekonomike të integruara në pyje dhe mjedis.
- Bilanci tregtar si dhe ai prodhim-përdorim i lëndës drusore rezultuar nga shfrytëzimi i pyjeve .

Prioritetet

Prioritet kyç për statistikat e pyjeve do të jetë zhvillimi i mëtejshëm i të dhënave të harmonizuara me kërkesat dhe standardet e BE-së. Ndër sipërmarrjet më të rëndësishme është hartimi për herë të parë në Shqipëri i Pyetësorit të përgjithshëm për pylltarinë.

Gjithashtu, prioritet për pylltarinë është prodhimi i saktë i të dhënave kyç, siç janë: të dhënat kadastrale të fondit balancues për pyjet dhe kullotat, investimet dhe kundërvajtjet në pyje, të ardhurat nga aktivitetet sekondare në pyje dhe kullota, të dhëna mbi speciet e rrezikuara dhe ato të të mbrojtura (flora dhe fauna) dhe të dhëna më të plota për zonat e mbrojtura.

Struktura dhe bilancet në pyje e kullota si dhe bilanci burim-përdorim i produkteve pyjore përbëjnë prioritet nder termat e tjerë të kësaj fushe.

Moduli 4.05.01 Statistikat te pylltarisë, gjuetisë dhe produkteve nga pyjet

Përshkrimi i situatës aktuale

Pyjet dhe kullotat përbëjnë gjysmën e fondit të tokës në Republikën e Shqipërisë. Instituti i Statistikave realizon statistikat e pylltarisë bazuar në të dhëna

administrative të grumbulluara nga MMPAU dhe të dhëna të tjera mbledhur nëpërmjet pyetësorit të strukturës së bujqësisë etj.

Të dhënat për fondin e tokës pyjore janë të karakterit kadastral dhe i referohen bilancit të përdorimit të tokës në fondin pyjor, bilancit të pronësisë mbi pyjet dhe kullotat si dhe sipërfaqeve me statusin e zonave të mbrojtura. Të dhënat për strukturën e pyjeve u referohen llojeve drusore, klasave të moshës dhe mënyrës së menaxhimit të grumbujve pyjor. Statistikat e pylltarisë mbulojnë tërësisht aktivitetet në këtë fushë, pavarësisht vendndodhjes, strukturës apo statusit të pronësisë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Të dhënat për kullotat ofrojnë informacion përveç madhësisë, edhe vendndodhjen dhe kohën e shfrytëzimit të tyre sipas stinëve.

Të dhënat për gjuetinë ofrojnë informacion mbi faunën në Shqipëri, intensitetin e shfrytëzimit të saj si dhe nivelin e kundërvajtjeve në këtë fushë.

Të dhënat për pyjet e kullotat komunale e private do të mblidhen edhe nëpërmjet kadastrave të komunave e bashkive, në kushtet e privatizimit të një pjese të pyjeve dhe kullotave në Shqipëri.

Deri më tani nuk prodhohen statistika për sa i përket bilancit të furnizimit me lëndë druri nga burimet vendase dhe importi, si dhe sa i takon strukturës së përdorimit të lëndës drusore në shkallë vendi.

Objektivi Strategjik

- T'u ofrohet përdoruesve informacion i saktë dhe koherent mbi pyjet dhe kullotat për t'i ndihmuar në vendimmarrje dhe menaxhim

Aktivitetet zbatuese

- Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave mbi pyjet dhe kullotat lidhur me:
 - Strukturën e fondit pyjor sipas pronësisë;
 - Strukturën e pyjeve sipas llojeve përbërës;
 - Fondin e kullotave në territorin pyjor, ndarë sipas pronësisë dhe sezonit të shfrytëzimit;
 - Strukturën e fondit të kullotave sipas kapaciteteve si tregues i cilësisë së tyre;
 - Shfrytëzimin e lëndës drusore në pyje, strukturuar sipas asortimenteve fillestare;
 - Të ardhurat e realizuara nga pyjet dhe kullotat në territorin pyjor;
 - Të ardhurat e realizuara nga gjuetia;
 - Të ardhurat e realizuara nga prodhimet e dyta në territorin pyjor;
 - Strukturat e investimeve në pyje dhe kullota sipas zërave në vlerë;
 - Të dhënat për Florën dhe Faunën në pyjet e Shqipërisë;
 - Kundërvajtjet në pyje dhe gjueti strukturuar sipas llojeve në vlerë;

- Llogaritë ekonomike të pylltarisë dhe gjuetisë;
 - Importin dhe eksportin e lëndës drusore dhe prodhimeve të dyta nga pyjet;
 - Bilancin e lëndës drusore në nivel vendi, sipas pyetësorit të përgjithshëm.
- Periodiciteti dhe frekuenca e publikimit të statistikave të pylltarisë janë vjetore.

- Publikimi i statistikave të pyjeve në faqen elektronike të INSTAT-it, në “Vjetari Statistikor” dhe pjesërisht në botimin “Shqipëria në shifra”.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Informacion i detajuar mbi pyjet, kullotat, gjuetinë dhe ekosistemet në nivel rajonal dhe kombëtar.

Burimi i Informacionit

Burim administrativ:

Të dhënat administrative të marra nga MMPAU, MBUMK, MBR dhe organet lokale të qeverisjes përbëjnë burimin kryesor informativ për statistikave të kësaj fushe.

Burim statistikor:

Vrojtime mbi strukturën e bujqësisë për tregues specifikë mbi përdorimin e pyjeve dhe kullotave ;

Tema 4.06 Statistikat e peshkimit

Përshkrimi

Qëllimi i kësaj teme është që të sigurojë të dhëna të harmonizuara rajonale, kombëtare në lidhje me aktivitetin e peshkimit, si:

- Statistikat e zënies së peshkut;
- Statistika për portet;
- Statistikat e akuakulturës.

Prioritetet

Grumbullimi i të dhënave për peshkimin detar do të merret nga libri i anijeve të peshkimit (*Logbook*), sipas Rregullores nr. 6, datë 13.2.2009 “Për përcaktimin e mënyrës së regjistrimit të informacioneve të nevojshme në lidhje me zëniet e peshkut” si përafrim i plotë i Rregullores së Komisionit (EEC) nr. 2807/83 (*Commission Regulation (EEC) No 2807/83 of 22 September 1983 laying down*

detailed rules for recording information on Member States' catches of fish (OJ L 276, 10.10.1983, p. 1).

Moduli 4.06.01 Peshkimi

Përshkrimi i situatës aktuale

Procesi i mbledhjes së të dhënave statistikore për peshkimin kryhet nga inspektorët e peshkimit në rrethe dhe grumbullohen në Drejtorinë e Politikave të Peshkimit. Inspektorët e Peshkimit në rrethe mbledhin të dhënat mbi zbarkimin e peshkut në porte, sasinë e peshkut të zënë për të gjitha kategoritë e peshkimit, si: në laguna, liqene, lumenj, si dhe prodhimin e qendrave të akuakulturës. Përveç këtyre të dhënave, inspektorët mbledhin dhe të dhënat në lidhje me kapacitetin aktiv të flotës së peshkimit, informimin mbi aktivitetin e çdo anijeje. Evidenca e prodhimit është e ndërtuar në bazë të kategorive ujore të secilit qark. Kjo evidencë plotësohet një herë në muaj në bazë të informacioneve të mbledhura nga subjektet e liçensuara të peshkimit.

Objektivi Strategjik

Objektivi kryesor është grumbullimi i të dhënave për peshkun sipas kategorive ujore. Të dhënat do të grumbullohen çdo tremujor.

Aktivitetet zbatuese

- Grumbullimi dhe përpunimi në Drejtorinë e Politikave të Peshkimit me programin Word Excel, dhe më pas nxjerrja e tabelave përfundimtare sipas specifikave si dhe grafikët përkatës;
- Mbledhja një herë në muaj e evidencave mbi çmimin mesatar të shitjes me shumicë për secilin lloj peshku.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Të dhëna teknike dhe social-ekonomike të mbledhura për përmirësimin e statistikave të peshkimit.

Burimi i Informacionit

MMPAU (Drejtoria e Politikave të Peshkimit).

Tema 4.07 Statistikat agromjedisore

Përshkrimi

Treguesit statistikorë në këtë fushë synojnë ti japin publikut informacion koherent mbi ndërveprimin midis aktiviteteve ekonomike të njeriut dhe mjedisit jetësor ku zhvillohen këto aktivitete.

Me treguesit agromjedisorë synohet të matet relativisht stresi që shkaktohet nga aktivitetet bujqësore e blegtorale në mjedisin ku ato zhvillohen.

Fushat e aktiviteteve të mbuluara në këtë temë janë:

- Treguesit e agromjedisit, të cilët mbulojnë informacionin e kërkuar për korrelacionin ndërmjet bujqësisë dhe mjedisit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;
- Mbledhja, përpunimi dhe publikimi i statistikave të rezultuara nga indikatorët e cituar për agromjedisin;
- Koordinim i punës me agjencitë statistikore dhe të gjithë subjektet e tjera mbajtëse të të dhënave të vlefshme për agromjedisin;

Prioritetet

Implementimi Rregullores CE №1185/2009 e Parlamentit Evropjan dhe vendimit të Këshillit të Evropës të datës 25 Nëntor 2009 lidhur me statistikat për Pesticidet.

Moduli 4.07.01 Statistikat agromjedisore

Përshkrimi i situatës aktuale

Mbledhja e të dhënave, përpunimi i të cilave lejon prodhimin e indikatorëve të që ofrojnë mundësinë të gjykohet presioni i disa aktiviteteve bujqësore e blegtorale në mjedis, përbën aktivitetin bazë në këtë modul.

Aktualisht, INSTAT-i nuk i prodhon këto statistika pasi nuk kanë qenë pjesë e Planit të Statistikave Zyrtare. Në kuadër të aktiviteteve përafruese me standardet e BE-së, statistikat në agromjedis janë indikator i rëndësishëm në nivel kombëtar dhe global.

Objektivi Strategjik

- Të ngrihet sistemi i gjurmimit dhe regjistrimit të të dhënave të vlefshme për statistikat agromjedisore;
- Të institucionalizojmë veprimet mes aktorëve të përfshirë duke i koordinuar ata në sistem.

Aktivitetet zbatuese

- Mbledhja e të dhënave të duhura për agromjedisin, duke filluar kështu prodhimin e tregueseve sintetike në shkallë eksperimentale gjatë dy viteve të para.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Statistika të përfutuara mbi agromjedisin konform standardeve të BE-së, duke qenë pjesë integrale e statistikave në nivel kombëtar e global.

Burimi i Informacionit

Ministria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Brendshme dhe Njësitë e qeverisjes vendore.

FUSHA 5 – STATISTIKAT *MULTI-DOMAIN*

Tema 5.03 Statistikat te Mjedisit

Përshkrimi

Fushat e aktiviteteve të mbuluara në këtë temë janë:

- Statistika mbi Mbetjet dhe Substancat e Rrezikshme;
- Statistikat mbi ujin sipas kërkesave të pyetësorit të OECD/Eurostat;
- Statistikat mbi mbetjet, substancat e rrezikshme, ujin dhe biodiversitetin.

Objektivi kryesor i kësaj teme është të krijohen statistika të kuptueshme dhe të përshtatshme.

Statistikat e Mjedisit ofrojnë informacion të përgjithshëm dhe specifik mbi mjedisin, këto të dhëna prodhohen në frekuencë vjetore në nivel kombëtar.

Të dhënat që mblidhen janë: të dhëna mbi ujërat e lumenjve, të dhëna për ujërat e liqeneve, të dhëna mbi ndotjen bakteriologjike të ujërave të deteve në plazhet e Shqipërisë, të dhëna mbi cilësinë e ajrit (SO₂, NO₂, O₃, LGS, PM₁₀, CO, Pb) në atmosferë, të dhëna mbi menaxhimin e tokës të zonave të kontaminuara (hot-spots), të dhëna mbi mbetjet e ngurta urbane dhe inerte, pesticidet e importuara.

Prioritetet

Përmirësimi rrënjësor i informacionit mjedisor nëpërmjet ngritjes dhe reformimit të sistemit të statistikave mjedisore, në harmoni me nevojat dhe

sistemin e organizimit të shtetit dhe ekonomisë shqiptare, përbën prioritetin kryesor në stadin aktual.

Gjithashtu, prioritetet për statistikat e mjedisit do të jetë zhvillimi dhe përmirësimi i mëtejshëm i të dhënave, për t'i përfruar me standardet dhe kërkesat e BE-së.

Përveç të dhënave të kërkuara, do të vazhdojnë përpjekjet për të ofruar të dhëna kryesore statistikore dhe mbledhje të të dhënave mbi ndotjen e ajrit, si: emetimet e gazrave nga GHG (Gazrat nga Efekti Serrë) të shprehur në 000/ton CO₂, të dhëna mbi cilësinë e ajrit (SO₂, NO₂, O₃, LGS, PM₁₀, CO, Pb në ajër), të dhëna mbi cilësinë dhe ndotjen e ujërave të lumenjve, liqeneve dhe detit në plazhet e Shqipërisë).

Moduli 5.03.02 Statistika mbi mbetjet dhe substancat e rrezikshme

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT-i publikon të dhëna të cilat mblidhen nga MPPT mbi mbetjet dhe substancat e rrezikshme.

Për mbetjet e ngurta urbane dhe inerte, të dhënat që grumbullohen janë për: Mbetjet Urbane (në 000 ton/vit); Mbetjet Urbane për banor (në ton/vit) dhe Mbetjet Inerte (në 000 ton/vit).

Objektivi Strategjik

- Prodhimi në kohë e me cilësi i treguesve të të dhënave mbi mbetjet, mbi menaxhimin e mbetjeve dhe riciklimin, në përputhje të plotë me metodologjinë e Eurostat-it;
- Implementimi i treguesve të tjerë sipas kërkesave të BE-së.

Aktivitetet zbatuese

- Prodhimi vjetor i statistikave mbi mbetjet, bazuar në të dhënat administrative të mbledhura;
- Implementimi i një programi të ri për mbledhjen e të dhënave mbi mbetjet, *landfill*-et si dhe sasi të mbetjeve të ricikluara. Implementimi i këtij programi do të shoqërohet edhe me përmirësime metodologjike të mbledhjes së të dhënave dhe do të kalojë nga të dhëna administrative në të dhëna me anketë;
- Përmirësimi i vazhdueshëm metodologjik, mbështetur në manualët dhe rregulloret që Eurostat përditëson për këtë fushë statistikore;

- Përdorimin e teknikave të avancuara të grumbullimit dhe editimit të të dhënave të cilat çojnë në rritjen e cilësisë së informacionit;

Rezultatet e pritshme

- ✓ Prodhimi i statistikave vjetore mbi mbetjet;
- ✓ Statistika mbi *landfill*-et dhe zonat me rrezikshmëri të lartë (numri i tyre në nivel bashkie);
- ✓ Riciklimi i mbetjeve dhe pikat e riciklimit;
- ✓ Erozioni;
- ✓ Të dhëna mbi biodiversitetin;

Burimi i Informacionit

Burim administrativ:

Të dhëna administrative nga agjencitë statistikore dhe institucionet e tjera publike.

Burim statistikor:

Vrojtime statistikore.

Moduli 5.03.03 Statistikat mbi ujin

Përshkrimi i situatës aktuale

Përsa i përket të dhënave të mbi ujërat e brendshme (tabelat 1 deri në 7 të pyetësorit të përbashkët OECD/Eurostat mbi gjendjen e mjedisit) dhe të dhënat mbi ujërat (tabelat 8 dhe 9 të pyetësorit të përbashkët OECD/Eurostat mbi gjendjen e mjedisit, INSTAT-i nuk disponon informacion.

Objektivi Strategjik

Përmirësimi i statistikave aktuale si dhe koordinimi i mbledhjes së të dhënave administrative mbi cilësinë e ujërave etj.

Prodhimi i treguesve të rinj për këtë fushë, sipas standardeve të Eurostat-it.

Aktivitetet zbatuese

- Prodhimi vjetor i statistikave mbi cilësinë e ujërave, bazuar në të dhënat administrative të mbledhura;
- Implementimi i një programi për koordinimin e mbledhjes së të dhënave administrative mbi cilësinë e ujërave. Implementimi i këtij programi do të shoqërohet edhe me përmirësime metodologjike të mbledhjes së të dhënave, duke krijuar një bashkëpunim më të mirë si dhe ngritur një sistem për mbledhjen e këtyre të dhënave;

- Përmirësimi i vazhdueshëm metodologjik mbështetur në manualet dhe rregulloret që Eurostat përditëson për këtë fushë statistikore;
- Prodhimi i statistikave të reja sipas kërkesave dhe rregullores së Eurostat-it.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Statistika mbi cilësinë e ujërave detarë;
- ✓ Statistika të reja mbi ujërat (përpunimi i ujërave të ndotur, etj)

Burimi i Informacionit

Të dhëna administrative nga MMPAU, MB, dhe MBUMK.

Tema 5.06 Shkenca, teknologjia dhe inovacioni

Përshkrimi

INSTAT aktualisht nuk prodhon statistika mbi shkencën, teknikën dhe inovacionin. Organizimi i vrojtimit statistikor do të kryhet në vitin 2012 në bashkëpunim me UNESCO dhe AKTI. Publikimi i këtyre të rezultateve do të mundësohet në 2013. Statistikat mbi shkencën, teknologjinë dhe inovacionin janë vitale në drejtim të matjes dhe kuptimit të zhvillimit bazuar në njohuritë, si dhe monitorimi i progresit dhe arritjet në këtë fushë në nivel kombëtar.

Kjo temë mbulon:

- Prodhimin e statistikave mbi inovacionin;
- Prodhimin e statistikave mbi shkencën dhe teknikën

Prioritetet

Prioritet në këtë fushë janë vlerësimi dhe njohja e situatës mbi zhvillimin e shkencës dhe teknikës, numrin e personave të angazhuar në këto fusha sipas aktiviteteve ekonomike në nivel vendi.

Moduli 5.06.01 Statistikat mbi shkencën dhe teknikën

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT nuk ka prodhuar deri tani statistika mbi shkencën dhe teknologjinë.

Objektivi strategjik

Grumbullimi, përpunimi dhe prodhimi i statistikave mbi shkencën dhe teknologjinë nëpërmjet vrojtimeve statistikore.

Aktivitetet zbatuese

- Organizimi i vrojtimeve vjetore mbi ndërmarrjet të konsideruara të mëdha, për të marrë informacion mbi numrin e të punësuarve të angazhuar në këtë fushë, nivelin arsimor, niveli i graduimit, shpenzimet e kryera nga ndërmarrja për zhvillimin e shkencës dhe teknikës. Ndërmarrjet do të selektohen nga Regjistri i Ndërmarrjeve aktive të rezultuara nga Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve Ekonomike. Viti referues do të jetë viti kalendarik.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Tregues statistikorë mbi nivelin e shkencës dhe teknikës, për aktivitetet ekonomike përfshirëse.

Burimi i informacionit

Vrojtim statistikor vjetor pranë ndërmarrjeve ekonomike.

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Vrojtim mbi treguesit e shkencës dhe teknikën	-	-	2014	2015	2016

Moduli 5.06.02 Inovacioni

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT nuk ka prodhuar deri tani statistika mbi inovacionin në teknologji.

Objektivi strategjik

Në periudhën 2012-2016, objektivi strategjik do të jetë:

Grumbullimi, përpunimi dhe prodhimi i statistikave mbi inovacionin në teknologji nëpërmjet vrojtimeve statistikore.

Aktivitetet zbatuese

- Organizimi i vrojtimeve vjetore mbi ndërmarrjet të konsideruara të mëdha, për të marrë informacion mbi numrin e të punësuarve të angazhuar në këtë fushë, nivelin arsimor, niveli i graduimit, shpenzimet e kryera nga ndërmarrja për zhvillimin e shkencës dhe teknikës. Ndërmarrjet do të

selektohen nga Regjistri i Ndërmarrjeve aktive të rezultuara nga ASN. Viti referues do të jetë viti kalendarik.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Tregues statistikorë mbi inovacionin në teknologji, për aktivitetet ekonomike përfshirëse.

Burimi i informacionit

Vrojtim statistikor vjetor pranë ndërmarrjeve ekonomike.

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Vrojtim mbi treguesit e inovacionit	-	-	x	x	x

Tema 5.07 Shoqëria e informacionit

Përshkrimi

Teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK) është përcaktuar si tërësia e mjeteve elektronike për të mbledhur, për të ruajtur, për të përpunuar dhe për të paraqitur informacionin për përdoruesit në mbështetje të aktiviteteve të tyre. Statistikat e Teknologjisë së informacionit dhe komunikimit janë shumë të rëndësishme për të matur dhe për të kuptuar ndikimet socio-ekonomike që sjell kjo teknologji. Ato informojnë politikbërësit dhe qytetarët për mënyrën se si individët dhe ndërmarrjet kanë përdorur TIK-un. TIK-u mbulon një gamë të gjerë të subjekteve (përdorimi të internetit, tregtia elektronike, siguria, besimi, lidhjet *wireless*, etj). Statistikat e TIK udhëhiqen nga Rregullorja e Parlamentit Evropian 808/2004 (EC).

Prioritetet

Për Statistikat e TIK prioritet është sigurimi i statistikave të plota në përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit nga ndërmarrjet.

Moduli 5.07.01 Statistikat e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)

Përshkrimi i situatës aktuale

Që prej vitit 2010, INSTAT mbledh, përpunon dhe bën të disponueshme për AKSHI-n statistikave vjetore të TIK për ndërmarrjet ekonomike jobujqësore. Të dhënat grumbullohen nëpërmjet vrojtimeve vjetore të Statistikave Strukturore të Ndërmarrjeve. Fusha e mbulimit e këtij vrojtimi janë aktivitetet që u përkasin

seksioneve nga B-Peshkimi deri P-Shërbime shtëpiake pranë familjeve dhe mjediseve të përbashkëta. Nuk përshihen në vrojtimit aktivitetet e seksioneve J-Ndërmjetësim Financiar, L-Administrim Publik, dhe Q-Organizma Ndërkombëtare. Seksionet M-Arsimi dhe N-Shëndetësi u përfshinë në vrojtimit ASN 2010, viti i referencës.

Objektivat strategjikë

Për Statistikat e TIK, objektivat strategjikë janë:

- Përmirësimi në cilësi, sasi dhe burime informacioni i statistikave mbi komunikacionin;
- Sigurimi i statistikave të plota në përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit nga ndërmarrjet;
- Ndërtimi, zhvillimi dhe përmirësimi i sasisë dhe cilësisë së treguesve të Statistikave e Teknologjisë së Informacionit dhe komunikimit pranë ndërmarrjeve;
- Përmirësimi i metodologjisë në mbështetje të plotësimit të kërkesave të përdoruesve të brendshëm dhe të jashtëm.

Aktivitetet zbatuese

Shfrytëzimi i të gjitha burimeve administrative për përmirësimin sasior dhe cilësor të treguesve statistikorë mbi komunikacionin.

Pyetëtori i hartuar për treguesit statistikor TIK pranë ndërmarrjeve do të jetë në formën e një moduli të veçantë që do të bashkëngjitet Anketës Strukturore Vjetore pranë ndërmarrjeve, viti referues 2011. Treguesit paraqiten për aktivitetet ekonomike gjithsej, sipas degëve dhe sipas madhësisë së ndërmarrjeve. Për përcaktimin e fushave të mbulimit do të përdoret Nomenklatura e Aktiviteve Ekonomike, NVE Rev.1.1. Të dhënat i përkasin periudhës vjetore kalendarike. Pyetjet dhe treguesit e prodhuar do të jenë në përputhje me kërkesat dhe standardet evropiane për këtë fushë.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Statistika cilësore mbi komunikacionin;
- ✓ Statistika të plota dhe të përmirësuara në përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit nga ndërmarrjet.

Burimi i informacionit

Të dhënat mblidhen direkt nga ndërmarrjet nëpërmjet një moduli të veçantë në pyetësin për Anketën Strukturore pranë Ndërmarrjeve.

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Anketa Vjetore pranë Ndërmarrjeve-TIK	2011	2012	2013	2014	2015

Moduli 5.07.01.02 Statistikat e Komunikacionit

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT prej 1993 grumbullon nëpërmjet burimeve administrative informacion mbi komunikacionin dhe numrin e pajtimtarëve të telefonisë fikse. Me zhvillimin e telefonisë celulare, INSTAT grumbullon informacion edhe mbi numrin e pajtimtarëve pranë këtyre kompanive.

Objektivat strategjikë

Për statistikat e komunikacionit, objektivat strategjikë në periudhën 2012-2016 do të jenë:

- Përmirësimi në cilësi, sasi dhe burime informacioni i statistikave mbi komunikacionin;
- Përmirësimi i metodologjisë në mbështetje të plotësimit të kërkesave të përdoruesve të brendshëm dhe të jashtëm.

Aktivitetet zbatuese

- Shfrytëzimi i të gjitha burimeve administrative për përmirësimin sasior dhe cilësor të treguesve statistikorë mbi komunikacionin.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Statistika cilësore dhe sasore mbi komunikacionin;

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Prodhimi i treguesve të Komunikacionit nga burime administrative	2012	2013	2014	2015	2016

Moduli 5.07.02 Statistikat e shërbimit postar

Përshkrimi i situatës aktuale

Statistikat në shërbimin postar sigurojnë të dhëna mbi sasinë e letrave dhe pakove të thjeshta dhe të porositura dhe kolipostën. INSTAT grumbullon dhe përpunon të dhënat administrative që merr nga Posta Shqiptare SH.A. Të dhënat

publikohen për periudha tremujore në “Buletinin Statistikor” dhe vjetore në “Vjetarin Statistikor”, “Shqipëria në Shifra” dhe në faqen elektronike www.instat.gov.al.

Objektivi strategjik

Objektivi i këtij moduli është të sigurojë statistika të harmonizuara mbi shërbimet postare. Prodhimi i statistikave me cilësi dhe në kohë mbi shërbimin postar në mënyrë që të plotësojë rregullisht kërkesat e përdoruesve duke marrë parasysh dhe përditësimet e bazës ligjore si dhe implementimi në nivel kombëtar i përmirësimeve të koncepteve metodologjike të harmonizuara me rregulloren evropiane mbi shërbimet postare.

Aktivitetet zbatuese

- Grumbullimi, kontrolli dhe publikimi i të dhënave administrative në periudha tremujore. Grumbullimi i informacionit në njësi fizike edhe nga operatorët e tjerë që veprojnë në fushën e shërbimit postar.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Treguesit statistikor mbi shërbimin postar në njësi fizike.
- ✓ Të dhënat publikohen për periudha tremujore në “Buletinin Statistikor”, vjetore në “Vjetarin Statistikor”, “Shqipëria në Shifra” dhe në faqen elektronike www.instat.gov.al.

Burimi i informacionit

Burimi Administrativ

Posta Shqiptare (Drejtoria e Marketing Programim, Statistikë Kosto)

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Prodhimi i treguesve të Postës nga burime administrative	2012	2013	2014	2015	2016

Tema 5.09 Llogaritë ekonomike në mjedis dhe ndryshimi i klimës

Përshkrimi

Llogaritë Ekonomike në Mjedis shërbejnë për mbledhjen e të dhënave mbi:

- Llogaritë Ekonomike në Mjedis;
- Llogaritë Fizike dhe Hibride për Mjedisin;

- Krijimin e *database*-it me të dhënat mbi mjedisin për burimet natyrore dhe produktet;
- Ndryshimin e klimës dhe aktivitete të tjera.

Prioritetet

- Mbledhja, përpunimi dhe prodhimi i statistikave të Llogarive Ekonomike në Mjedis;
- Disponimi i statistikave koherente, në përputhje me rekomandimet e BE-së.

Moduli 5.09.01 Llogaritë monetare në mjedis

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT-i nuk prodhon statistika për Llogaritë Ekonomike në Mjedis.

Objektivi Strategjik

- Mbledhja, përpunimi dhe prodhimi i statistikave të llogarive ekonomike në mjedis, duke filluar nga viti 2013.

Aktivitetet zbatuese

- Përpunimi i të dhënave administrative për prodhimin e statistikave të reja në fushën e llogarive ekonomike mjedisore..

Rezultatet e pritshme

- ✓ Statistika koherente, në përputhje me rekomandimet e BE-së.

Burimi i Informacionit

Të dhëna administrative.

Moduli 5.09.02 Llogaritë fizike dhe hibride për mjedisin

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT nuk prodhon statistika për Llogaritë Fizike dhe Hibride për Mjedisin.

Objektivi Strategjik

Mbledhja, përpunimi dhe prodhimi i statistikave të llogarive Fizike dhe Hibride në mjedis duke filluar nga viti 2013.

Aktivitetet zbatuese

- Përpunimi dhe publikimi i të dhënave statistikore për të dy modulet duke krijuar kështu statistika të reja në përputhje me rekomandimet e Eurostat-it.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Statistika korente, në përputhje me rekomandimet e BE-së.

Burimi i Informacionit

Të dhëna administrative.

FUSHA 6 – MBËSHTETJA E PRODHIMIT STATISTIKOR

Tema 6.01 Cilësia, vlerësimi, koordinimi statistikor dhe klasifikimet

Përshkrimi

Për koordinimin e statistikave në një gjuhë të përbashkët, për të lehtësuar prodhimin e tyre dhe bërjen e tyre sa më efçente, INSTAT-i zbaton klasifikimet evropiane dhe ndërkombëtare për kodifikimin e aktiviteteve ekonomike, produkteve dhe shërbimeve që derivojnë nga këto aktivitete, profesioneve dhe mallrave. Të gjitha vrojtimit që janë të përshkruara në termat e statistikave ekonomike kërkojnë klasifikim sistematik.

Në vite këto klasifikime janë rishikuar për disa arsye, si:

- Zhvillimet ekonomike botërore;
- Nevoja për krahasueshmëri më të mirë me klasifikimet kombëtare e ndërkombëtare.

Të gjitha rishikimet dhe ndryshimet e ndodhura në sistemin e klasifikimeve evropiane apo ndërkombëtare transferohen edhe në Shqipëri.

Për koordinimin e të gjitha klasifikimeve të përdorura në sektorë të ndryshëm, INSTAT-i ka ndërtuar një sistem të integruar të klasifikimeve sipas nivelit të përputhshmërisë me klasifikimet Evropiane dhe ndërkombëtare.

Prioritetet

- Implementimi i klasifikimeve të rishikuara të aktiviteteve dhe produkteve duke ndjekur rregullat dhe standardet e Eurostat-it;
- Ndjekja e rregullave për implementimin e këtyre klasifikimeve në vrojtimet ekonomike strukturore dhe afatshkurtra;
- Rishikimi i serive të të dhënave pas përdorimit të klasifikimit të rishikuar të aktiviteteve.

Moduli 6.01.02 .01 Klasifikimi aktiviteteve

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT-i aktualisht zbaton Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.1.1, për kodifikimin e aktiviteteve, e njehsuar me versionin evropian NACE Rev.1.1 dhe Nomenklaturën e Produkteve 2002 për kodifikimin e produkteve, e njehsuar me versionin CPA 2002.

Në vitin 2010 implementohet në Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve Klasifikimi i Aktiviteteve i rishikuar NACE Rev.2. Në vitin 2013 është planifikuar implementimi i këtij klasifikimi në vrojtimet ekonomike afatshkurtra dhe strukturore.

Objektivat Strategjikë

Në periudhën 2012-2016, objektiva strategjik të INSTAT për këtë fushë do të jenë:

- Zhvillimi, përditësimi dhe implementimi i një seti të harmonizuar të klasifikimeve statistikore qendrore në sistemin statistikor shqiptar, si Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike (NVE), Nomenklatura e Produkteve (NP), Nomenklatura e Profesioneve (ISCO 88), Nomenklatura e Mallrave (NM);
- Forcimi i marrëdhënieve ndërinstitucionale për përdorimin në mënyrë të unifikuar të këtyre klasifikimeve nga i gjithë sistemi statistikor;
- Implementimi i klasifikimeve të rishikuara nga të gjithë sektorët përfshirës dhe në të gjitha vrojtimet statistikore në përputhje me standardet evropiane;
- Zbatimi i klasifikimeve të rishikuara nga administrata publike dhe subjektet fizikë dhe juridikë.

Aktivitetet zbatuese

- Publikimi i Nomenklaturës së Aktiviteteve në shqip i NVE Rev.2;
- Zbatimi i klasifikimit NVE Rev.2 në vrojtimet ekonomike apo sociale që INSTAT-i do të ndërmarrë në vazhdimësi.

- Zbatimi i Nomenklaturës së Aktiviteteve Ekonomike të Rishikuar, NVE Rev 2 nga të gjitha burimet e tjera administrative, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR), ministritë dhe institucionet etj.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Statistika ekonomike apo sociale me klasifikimin e rishikuar NVE rev.2;
- ✓ Ndërmarrjet dhe subjektet fizikë apo juridikë të klasifikuar me klasifikimin e ri në regjistrat administrativë;
- ✓ Klasifikim i zbatuar nga agjencitë statistikore dhe administrata publike.

Moduli 6.01.02 .02 Klasifikimi produkteve

Përshkrimi i situatës aktuale

INSTAT-i aktualisht zbaton Nomenklaturën e dhe Nomenklaturën e Produkteve 1996 për kodifikimin e produkteve, e njehsuar me versionin CPA 1996.

Në vitin 2013/2014 është planifikuar implementimi i këtij klasifikimi në vrojtimet ekonomike afatshkurtra dhe strukturore.

Objektivat Strategjikë

Në periudhën 2012-2016, objektiva strategjik të INSTAT për këtë fushë do të jenë:

- Zhvillimi, përditësimi i klasifikimeve statistikore të produkteve të revizionuara në sistemin statistikor shqiptar, si Nomenklatura e Produkteve (NP) 2002 apo 2008;
- Implementimi i klasifikimeve të rishikuara nga të gjithë sektorët përfshirës dhe në të gjitha vrojtimit statistikore në përputhje me standardet evropiane;
- Zbatimi i klasifikimeve të rishikuara nga administrata publike dhe subjektet fizikë dhe juridikë.

Aktivitetet zbatuese

- Zbatimi i klasifikimit NP 2002 dhe /ose 2008 në vrojtimit ekonomike apo sociale që INSTAT-i do të ndërmarrë në vazhdimësi.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Statistika ekonomike apo sociale me klasifikimin e rishikuar NP 2002 dhe / ose 2008;

Moduli 6.01.03 Klasifikimet për tregtinë e mallrave (Dogana)

Përshkrimi i situatës aktuale

Për të pasur një instrument të vetëm, që do të mundësonte administrimin në të njëjtën kohë të tarifës doganore, të statistikave të tregtisë së jashtme dhe të politikave të tjera, që lidhen me mallrat dhe lëvizjen e tyre, Këshilli i Ministrave ka miratuar Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave, në zbatim të ligjit Nr. 9461, datë 21.12.2005 “Për Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave dhe Tarifën e Integruar Doganore”.

Nomenklatura e Kombinuar e Mallrave bazohet plotësisht në Nomenklaturën e Kombinuar të Bashkimit Evropian (CN). Përditësimet e kësaj nomenklature bëhen zakonisht çdo vit sipas përditësimeve të Nomenklaturës së Kombinuar të BE-së dhe duke u mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave.

Nomenklatura e shteteve bazohet në Rekomandimin nr.3 të UNECE dhe në kodin e vendeve, të paraqitur në elementet e Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim (ISO) 3166-1-alfa-2code, dhe të përditësuara çdo vit në bazë të rejtat nga ISO (dogana).

Objektivat Strategjikë

Në periudhën 2012-2016, objektiv do të jetë:

- Përditësimi i vazhdueshëm i Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

Aktivitetet zbatuese

- Zbatimi në vazhdimësi i Nomenklaturës së Mallrave, sipas viteve.

Rezultatet e pritshme

- ✓ Statistika të tregtisë së jashtme sipas klasifikimit të përditësuar të mallrave.

Aktivitetet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016
Zbatimi i NVE Rev.2	-	x	x	x	x
Zbatimi i NP-2008	-	x	x	x	x
Zbatimi i NM	x	x	x	x	x

Tema 6.11 Siguria e të dhënave dhe konfidencialiteti

Përshkrimi

Të dhënat në nivel individual si për bizneset, ashtu edhe të dhënat personale konsiderohen si rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligjin Nr. 9180, datë 05.02.2004 “Për Statistikat”, i ndryshuar, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Mbrojtja e të Dhënave Personale”. Neni15 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT-i është i natyrës konfidenciale dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit.

Në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e të dhënave nga aksesit i paautorizuar si dhe nga prishja fizike, të dhënat statistikore ruhen në *database*-t e serverëve të dedikuar. Aksesit në të këto *database* sigurohet përmes autentikimit dhe autorizimit në nivel sistemi operativ dhe roleve e përdoruesve në nivel *database*.

Prioritetet

Korniza aktuale ligjore garanton mbrojtjen e konfidencialitetit të të dhënave. Me qëllim integrimin e të dhënave administrative dhe të dhënave të anketave, është planifikuar ndërtimi i një magazine të dhënash e integruar me *metadata*-n e tyre.

Për përmirësimin e cilësisë së aksesit të të dhënave, INSTAT-i ka ndërtuar një Web dinamik. Lidhur me sigurinë, do të duhet të bëhen përpjekje maksimale për mbrojtjen nga sulmet e mundshme të *hackers*-ave dhe viruseve.

Moduli 6.11.01 Siguria dhe mbrojtja e të dhënave

Përshkrimi i situatës aktuale

Të dhënat në nivel individual si për bizneset ashtu edhe të dhënat personale konsiderohen si rreptësisht konfidenciale që përdoren vetëm për qëllime statistikore dhe kërkime shkencore në përputhje me Ligjin Nr. 9180, datë 05.02.2004 “Për Statistikat”, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Mbrojtja e të Dhënave Personale”. Në bashkëpunim me Komisionerin e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, INSTAT-i ka nënshkruar “Rregulloren etike për përpunimin e të dhënave personale nga punonjësit”

Në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e të dhënave nga aksesit i paautorizuar si dhe nga prishja fizike janë marrë masat e mëposhtme:

- Të dhënat statistikore ruhen në *database*-t e serverave të dedikuar. Këta servera kanë sistem operativ *Ëindoës Server 2008* dhe *database engine* *Microsoft Sql Server 2008*. Të dhënat bëhen anonime nëpërmjet përdorimit të algoritmeve të enkriptimit;

- Aksesit në *database* sigurohet përmes autentikimit dhe autorizimit në nivel sistemi operativ dhe roleve e përdoruesve në nivel *database*.

Me qëllim që të dhënat të mbrohen nga dëmtimet fizike që mund të vijnë si rrjedhojë e mosfunksionimit të *hardware*, INSTAT ka përpunuar procedurat adequate për kryerjen e *backup*-it të vazhdueshëm. Ky *backup* bëhet si në nivel serveri, ashtu edhe në nivel *database*, sistemit *e-mail* apo *file* që ruhen në server.

Në nivel LAN, përdoruesit aksesojnë burimet e sistemit (si *file*, printer etj) nëpërmjet autentikimit *username + password* që ofron *Windows domain*.

Mbrojtja nga viruset kryhet nëpërmjet sistemit antivirus të instaluar në server. Ky sistem përditëson në mënyrë të përhershme të gjithë kompjuterët klientë të përdoruesve.

Aksesit në internet është rregulluar përmes implementimit të *firewall* në nivel *hardware* dhe kjo siguron që asnjë nga përdoruesit të mos ketë akses direkt në Internet.

Objektivi Strategjik

Objektivi strategjik i INSTAT-it dhe agjencive të tjera statistikore është garantimi i konfidencialitetit të të dhënave që sigurohen nga individët dhe njësitë e tjera statistikore. Standardi i konfidencialitetit ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në besueshmërinë e siguresit të informacionit. Gjithashtu, ky standard përmbush një nga detyrimet e parashikuara në respekt të zbatimit të parimeve themelore të statistikave zyrtare.

Aktivitetet zbatuese

Përmirësimi dhe përditësimi i vazhdueshëm i teknologjisë në nivel *hardware* dhe *software* si në mbledhjen e të dhënave, ashtu edhe në dhënien e aksesit *remote* për kërkuesit e të dhënave statistikore, duke ruajtur ndërkohë konfidencialitetin dhe privatësinë. Përmirësim i rregullave të mbrojtjes së të dhënave dhe dokumentimi i plotë i procedurave.

Moduli 6.11.02 Koordinimi për konfidencialitetin statistikor

Përshkrimi i situatës aktuale

Instituti i Statistikave garanton konfidencialitetin e të dhënave në përputhje me Ligjin nr.9180, datë 5.2.2004 "Për Statistikat Zyrtare, neni 15. Ky nen përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT-i është i natyrës konfidenciale dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të tij.

Të gjithë punonjësit e sistemit statistikor janë të detyruar me ligj të mbrojnë sekretin e të dhënave individuale. Shkelja e parimit të konfidencialitetit përbën kundravajtje dhe dënohet me masë administrative dhe/ose gjobë.

Të drejtën për hyrje dhe përdorim të të dhënave konfidenciale i kanë personat, të cilët, gjatë kryerjes së detyrave, kontribuojnë në nxjerrjen e statistikave zyrtare. E drejta e hyrjes shtrihet në masën e cila të jetë e mjaftueshme për nxjerrjen e produktit statistikor të kërkuar.

Objektivi Strategjik

Përafrimi i kuadrit ligjor për përcaktimin e kufinjve për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale sipas standardeve të kërkuara evropiane.

FUSHA 8 – POLITIKA STRATEGJIKE DHE KOORDINIMI

Tema 8.04 Menaxhimi i bazës ligjore

Përshkrimi

Sistemi Kombëtar Statistikor e ushtron aktivitetin në përputhje me ligjin nr. 9180, datë 05.02.2004 “Për statistikat zyrtare” dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore të cilët rregullojnë funksionimin e INSTAT-it dhe agjencive të tjera statistikore. Sipas Raporteve Analitike të BE-së për Shqipërinë (2010, 2011) në kuadrin e përafrimit me *Acquis Communautaire*, si dhe Raportit Global të Vlerësimit të Sistemit Statistikor në Shqipëri (2010) hartuar nga ekspertët e Eurostat-it, “Ligji “Për statistikat zyrtare” është një bazë e sigurt ligjore për prodhimin e statistikave zyrtare në një vend i cili ndodhet drejt një shoqërie moderne demokratike informative dhe ekonomisë së tregut.” Ai është përgjithësisht në përputhje me parimet themelore për statistika zyrtare të Kombeve të Bashkuara, si dhe pjesërisht në përputhje me parimet e parashikuara në Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane. Sidoqoftë, në mënyrë që të garantohet pavarësia e plotë profesionale e INSTAT-it, si dhe për të përcaktuar më qartë pozicionin e tij si institucioni kryesor në vend prodhues i statistikave zyrtare dhe përgjegjës për monitorimin e funksionimit të Sistemit Kombëtar Statistikor, është rekomanduar rishikimi i këtij ligji kryesisht në:

- Përcaktimin e mandatit të Drejtorit të Përgjithshëm;
- Rikompozimin e Këshillit të Statistikave;
- Përcaktimin me ligj të përkufizimit të “Sistemit Kombëtar Statistikor”;
- Përcaktimin me ligj të INSTAT-it si institucionin përgjegjës për koordinimin e Sistemit Kombëtar Statistikor;
- Ngarkimin e agjencive statistikore të njoftojnë INSTAT-in për ngritjen e çdo baze të re me të dhëna administrative si dhe për ndryshimet e mundshme në ato ekzistuese;
- Miratimin e një dispozite ku të parashikohet zbatimi i principeve të parashikuara në Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane, miratuar nga Komisioni i Sistemit Statistikor Evropian me datë 28 Shtator 2011;
- Përshtatjen e parimit të konfidencialitetit statistikor me atë të mbrojtjes së të dhënave sipas ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Pas miratimit të mendimeve në ligj nga Kuvendi i Shqipërisë, INSTAT do të punojë për përgatitjen e akteve nënligjore në zbatim të tij.

Prioritetet

Në kuadrin e sfidave për përmbushjen e rekomandimeve të BE-së me synimin përafrimin e akteve ligjore me ato komunitare, INSTAT, në pozicionin e institucionit përgjegjës për monitorimin e veprimtarisë prodhuese të statistikave evropiane, do të fokusohet në përforsimin e bazës ligjore që rregullon funksionimin e Sistemit Kombëtar Statistikor në këto fusha:

- Miratimin e shtesave dhe ndryshimeve në Ligjin nr. 9180, datë 05.02.2004 “Për statistikat zyrtare”;
- Miratimin e VKM për rregullimin e funksionimit të Këshillit të Statistikave dhe Bordit Këshillimor Statistikor;
- Miratimin e VKM për kriteret e përzgjedhjes dhe vlerësimit të kandidatëve për Titullarin e INSTAT-it;
- Miratimin e Memorandumeve të Mirëkuptimit me agjencitë e reja statistikore të dala sipas këtij Programi, si dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera në interes të përmirësimit të burimeve statistikore;
- Nxjerrjen e rregulloreve përkatëse, të miratuara nga Këshilli i Statistikave, për tu zbatuar nga agjencitë statistikore sa i takon monitorimit të veprimtarisë së tyre, raportimeve periodike për ecurinë e Programit dhe problematikave të tjera që kanë lidhje me zbatimin e këtij dokumenti.

Moduli 8.04.02 Aspektet ligjore të konfidencialitetit

Përshkrimi i situatës aktuale

Ligji Nr.9180, datë 5.2.2004 “Për statistikat zyrtare” ka për objekt rregullimin e mënyrës së marrjes, organizimit, nxjerrjes dhe shpërndarjes së statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë. Neni 15 i këtij ligji përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT-i konsiderohet i natyrës konfidenciale. INSTAT-i dhe agjencitë statistikore marrin të gjitha masat e duhura teknike, organizative dhe të sigurimit për mbrojtjen nga çdo hyrje, zbulim ose përdorim i paligjshëm i të dhënave konfidenciale.

Objektivi Strategjik

Ruajtja e standardeve të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale përmes përditësimit të vazhdueshëm të kornizës ligjore, në përputhje me aktet kombëtare dhe *acquis communautaire*.

Aktivitetet zbatuese

Rishikimi i nenit 15 të Ligjit nr. 9180, datë 05.02.2004 “Për statistikat zyrtare” me qëllim përshtatjen e parimit të mbrojtjes së konfidencialitetit statistikor me atë të mbrojtjes së të dhënave personale, sipas ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, dhe dërgimi i propozimit në Kuvendin e Shqipërisë.

ANEKSI I

- Ligji nr. 9180, date 05.02.2004 “Për Statistikat Zyrtare”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8669, datë 26.10.2000 “Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave”, ndryshuar me Ligjin nr. 10084, datë 23.02.2009 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8669, datë 26.10.2000 “Për Regjistrimin e Përgjithshëm të Popullsisë dhe Banesave” dhe Aktin Normativ nr. 6, datë 30.09.2009 “Për një ndryshim në Ligjin nr. 8669, datë 26.10.2000 “Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë e banesave, të ndryshuar”;
- Ligji nr. 10201, datë 17.12.2009 “Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore”, përafuar pjesërisht me Rregulloren (KE) nr. 223/2009 E Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 11 mars 2009, “Për statistikat Evropiane” dhe që shfuqizon Rregulloren (KE, Euratom) nr. 1101/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për transmetimin e të dhënave që përbëjnë objekt të sekretit statistikor Zyrës Statistike të Komuniteteve Evropiane, Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 322/97 “Për Statistikat e Komunitetit”, si edhe Vendimin e Këshillit 89/382/KEE, Euratom “Për krijimin e Komitetit për Programet Statistike të Komuniteteve Evropiane”⁵ dhe Rregulloren (KE) Nr. 1893/2006 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 20 dhjetor 2006, “Për krijimin e klasifikimit statistikor të veprimtarive ekonomike *NACE Revision 2*” (që ndryshon Rregulloren e Këshillit (KEE) nr. 3037/90 si edhe disa Rregullore KE për fusha të caktuara statistikore.⁶;
- Ligji nr. 10202, datë 17.12.2009 “Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike jobujqësore”, përafuar pjesërisht me Rregulloren (KE) nr. 223/2009 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 11 mars 2009, “Për Statistikat e Komunitetit” dhe që shfuqizon Rregulloren (KE, Euratom) nr. 1101/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për transmetimin e të dhënave që përbëjnë objekt të sekretit statistikor Zyrës Statistike të Komuniteteve Evropiane, Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 322/97 për Statistikat e Komunitetit, si edhe Vendimin e Këshillit 89/382/KEE, Euratom për krijimin e Komitetit për Programet Statistike të Komuniteteve Evropiane⁷;
- Ligji nr 8957 datë 17.10.2002 “Për Ndërmarrjet e Vogla e të Mesme, SME”, ndryshuar me Ligjin nr 10042 datë 22.12.2008;

⁵ FZ L 87, 31.3.2009, fq. 164

⁶ FZ L393, 30.12.2006, fq.1

⁷FZ L 87, 31.3.2009, fq. 164

- Ligjin nr. 8269, dt. 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”⁸, i ndryshuar. Ligji për afron pjesërisht Statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qëndrore dhe Bankës Qendrore Evropiane⁹.
- Ligji Nr. 9936, datë 26 Qershor 2008 “Mbi menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i cili rregullon sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë, strukturën, parimet dhe bazat e procesit buxhetor, marrëdhëniet financiare ndërqeveritare dhe përgjegjësitë për zbatimin e legjislacionit buxhetor në tërësi;
- Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 10 Prill 1998, ndryshuar me dekret të Këshillit të Ministrave nr. 25, datë 10 Janar 2001, “Sistemi i klasifikimit ekonomik “Për aprovimin e planit kontabël të llogarive për qeverisjen lokale e qendrore dhe institucionet lokale shtetërore dhe njësi vartëse”;
- Udhëzimet e Zbatimit të Buxhetit Vjetor dhe udhëzimi i përhershëm nr.2, datë 06.02.2012, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”;
- Udhëzimi nr.26, datë 27.12.2007, “Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave nr.14, datë 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësi që varen prej tyre si dhe të njësi të menaxhimit /zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj””.
- VKM nr.640, datë 11.06.2009, “Për miratimin e letërpolitikave të qeverisë për kontrollin e brendshëm financiar publik”. Në aneksin 4 të këtij vendimi jepet perioda e tranzicionit në standardet ndërkombëtare IPSAS, zbatimi i të cilës është i lidhur ngushtë me nevojën e asistencës teknike për zbatimin e tij;
- VKM nr. 704, datë 16.11.2005 “Për miratimin e kritereve të përfaqësimit, të përzgjedhjes, emërimit e shkarkimit të anëtarëve dhe rregullat e funksionimit të këshillit të statistikave”, ndryshuar me VKM nr. 314, datë 24.05.2006;
- VKM nr. 399, datë 22.04.2009 “Për organizimin, funksionimin dhe përbërjen e Komisionit Qendror të Regjistrimit”, të ndryshuar;
- VKM nr. 1013, datë 17.03.2010 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit dhe për përbërjen e Komisionit Qendror të Regjistrimit të Përgjithshëm të Njësi Ekonomike Bujqësore”;

⁸ Fletore Zyrtare nr. 20, datë 07.01.1998, faqe 479

⁹ OJC no.115, date 09.05.2008, page 230-250

- VKM nr. 327 datë 18.07.1994 “Mbi Nomenklaturën e Aktiviteteve”.

Memorandume Mirëkuptimi ndërmjet INSTAT dhe Institucioneve të tjera:

- Memorandumi i Bashkëpunimit nr.342 prot., datë 6.6.2005 mes INSTAT dhe Ministrisë së Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Doganave);
- Memorandumi i Bashkëpunimit nr.343 prot., datë 6.6.2005 mes INSTAT dhe Ministrisë së Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Taksave);
- Memorandumi i Bashkëpunimit nr. 418 prot datë 12.05.2008 mes INSTAT dhe Bankës së Shqipërisë
- Memorandumi i Bashkëpunimit nr.141 prot datë 11.02.2009 mes INSTAT dhe Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
- Memorandumi i Bashkëpunimit nr. 604 prot datë 29.07.2009 mes INSTAT dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës
- Memorandumi i Bashkëpunimit nr.246 prot datë 13.03.20085 mes INSTAT dhe Inspektoriatit të Lartë të Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive